

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE

ANTOLOGJIA E SHOQËRISË CIVILE

Prishtinë, 2001

FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

Lektura, korektura, redaktura dhe
përkthimi shqip-anglisht
Editorial and Albanian-English translation
Avni SPAHIU

Realizimin dhe përgaditja për shtyp
Layout
Gani HALILI

U shtyp në shtypshkronjën
"DRITA press"- Prishtinë
Printed by
"DRITA press"- Prishtina

Përmbajtja

Parathënie	5
Shkëlzen Maliqi PSE KA DËSHTUAR REZISTENCA JOVIOLENTE NË KOSOVË	9
Agon Demjaha ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË ZHVILLIMIN E KOSOVËS SË ARDHSHE	55
Lulzim Peci FUQIZIMI I RINISË BALLKANIKE DHE INTEGRIMET EVRO-ATLANTIKE	63
Blerim Reka LIGJI SI THEMEL I SHOQËRISË CIVILE: RASTI I KOSOVË	69
Muhamet Mustafa SHOQËRIA CIVILE DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	81
Hivzi Islami RRJEDHAT DEMOGRAFIKE NË KOSOVË DHE SHOQËRIA CIVILE	95
Dukagjin Pupovci REFORMA E SISTEMIT TË ARSIMIT NË KOSOVË NJË RRUGË DREJT TË ARDHMES	113
Fadil Hysaj INTELEKTUALI KONVERTIT DHE KRIZA E IDENTITETIT KULTUROR	123
Daut Dauti MEDIAT NË KOSOVË	131
Luan Shllaku MJEDISI KOSOVAR	139
Ilir Dugolli PARTITË POLITIKE SI METAFORË E SHOQËRISË CIVILE	147
Hasnije Ilazi TË RINJTË DHE SHOQËRIA NË TRANZICION	159

Parathënie

Në delegacionin e Kosovës në Konferencën e Rambujesë, pos përfaqësuesëve të partive politike dhe të UÇK-së, kanë qenë edhe disa anëtarë, për të cilët është thënë se janë "përfaqësues të shoqërisë civile nga Kosova". Njëri prej tyre, madje, është privilegjuar që të jetë nënshkruesi i katërt i dokumentit. Pra, pos liderëve politikë dhe militarë të Kosovës, që kanë gëzuar prestigj dhe autoritet të caktuar në popull (disa prej tyre të vërtetë, disa të supozuar ose të shtirur), si një "subjekt" dhe "forcë e tretë" e Kosovës në Rambuje ishte paraqitur edhe "shoqëria civile", për të cilën rrallë kush kishte ide të qartë se çka përfaqëson dhe çka synon, si dhe cila është influenca reale e saj.

Kështu, Rambujeja kishte shënuar një lartësim të çuditshëm të shoqërisë civile në një shoqëri kryesisht tradicionale, ose në tranzicion, çfarë është shoqëria kosovare sot. Kosovari i thjeshtë përfaqësimin e shoqërisë civile në konferencën historike e kishte kuptuar si një imponim të Perëndimit. Në bisedat kolokviale "përfaqësuesit e shoqërisë civile" quheshin "të përzgjedhur të Perëndimit". Dhe, deri sa për përfaqësuesit e partive dhe të lëvizjeve politike kishte edhe komente ironike dhe kontestuese, të ngjyrosura nga përkatësia partiake dhe ideologjike, se "përfaqësimi i tyre është i dyshimtë", për "të përzgjedhurit të Perëndimit" komentet kanë qenë tjetërfare. Edhe kur thuhej se ata janë "përkthyes të dëshirave të Perëndimit", nuk kontestohesh fare fuqia imponuese e pakrahueshme e atyre që i kishin zgjedhur.

Një tjetër cilësim i përfaqësuesëve të shoqërisë civile në Rambuje ishte se ata janë të "pavarur". Etiketa të "pavarur" i referohej statusit të tyre brenda spektrit politik të Kosovës, ndërkaq që ata në të vërtetë janë konsideruar të varur nga

fondet dhe influenca perëndimore. Në këtë aspekt, një pjesë e opinionit kosovar shprehej me ironi, duke aluduar në paradoksin e "pavarësisë së varur". Përfaqësuesit e shoqërisë civile, në të vërtetë, kanë qenë drejtuesit e mediave të pavarura në Kosovë, me influencë respektabile, në shumë aspekte mbi nivelin e influencës të mediave të varura nga qendrat vendore të vendosjes.

Duke u nisur nga ky distinkcion i nivelit të paragjykimeve politike të kohës, do të mund të bënim dallimin në mes të shoqërisë kosovare në përgjithësi, nga njëra anë, dhe të shoqërisë civile, nga ana tjetër. Shoqëria civile aktualisht shikohet dhe vlerësohet si një farë perëndimore që, si e tillë, ende nuk i ka lëshuar rrënjët në Kosovë, por që në parim e ka lejekalimin, sepse Perëndimi konsiderohet aleat i Kosovës. Meqë kosovarët, pothuajse pa përjashtim, janë të orientuar drejt Perëndimit dhe synojnë të bëhen pjesë e tij, shoqëria civile konsiderohet si pjesë e ardhmërisë, e cila doemos duhet zhvilluar, nëse Kosova dëshiron arritjen e nivelit të zhvillimit shoqëror sipas standardeve të avancuara të demokracive perëndimore.

Sidoqoftë, termi shoqëria civile ka hyrë në fjalorin e përditshëm. Por, ai ende nuk është asimiluar dhe rrallë kush e di se cili është koncepti dhe cila përmbajtja e saj, jashtë të qenit një ideologjemë dhe vizion properëndimor.

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, i cili mbështetet nga Unioni Evropian dhe që për qëllim dhe detyrë ka ngritjen e vetëdijes dhe të formave organizative të shoqërisë civile, e ka parë të udhës që të kontribuojë në sqarimin e idesë dhe të praktikës së shoqërisë civile, duke u fokusuar, para së gjithash, në gjendjen dhe perspektivat e saj në Kosovë. Kemi menduar se kjo do të mund të ishte një temë për diskutim me interes, si për opinionin ashtu edhe për autorët nga Kosova, që në ndonjë mënyrë e kanë reflektuar, qoftë në rrafshin më teorik, qoftë në aspektet më praktike, çështjen e shoqërisë civile. Andaj, e pamë të udhës që t'u drejtohem disa intelektualëve, profesorëve dhe aktivistëve të spikatur, që të kontribuojnë në sqarimin e konceptit dhe të praktikës së shoqërisë civile në Kosovë. Ky libër është rezultat i kësaj përpjekjeje.

Në botim janë përbledhur artikujt e autorëve kosovarë që

janë sfiduar nga aktualiteti i temës dhe kanë bërë shkrime nga fushat e interesimeve dhe angazhimeve të tyre. Nuk kemi pretenduar që libri të jetë gjithpërfshirës dhe shterues. Publikimin e kemi koncipuar si përmbledhje refleksionesh mbi shoqërinë civile, duke respektuar pikpëmjet autoriale dhe qasjet, në të cilat janë integruar interesimet dhe përvojat e veçanta profesionale të tyre.

Jemi të vetëdijshëm se në botim mungojnë disa fusha dhe aspekte të rëndësishme të temës. Mirëpo, duke e kuptuar përpjekjen më shumë si një nxitje për reflektimin e mëtutjeshëm të gjendjes dhe të kahjeve të zhvillimit të shoqërisë civile, ia dorëzojmë librin opinionit ashtu siç është, si një ndërmarrje fillestare, me shpresë se vëllimi që e keni në dorë do të pasohet dhe pasurohet me vëllime dhe qasje të tjera. Shoqëria civile, në të vërtetë, është një dukuri me koncept të hapur, për të cilin zhvillohen diskutime të pafund edhe në vendet që konsiderohen se e kanë arritur shkallën më të lartë të zhvillimit dhe të aplikimit të saj.

FKSHC falënderon autorët dhe bashkëpunëtorët që kanë kontribuar në realizimin e këtij projekti, si dhe Unionin Evropian e kanë mundësuar përgatitjen dhe publikimin e tij.

Shkelzen Maliqi,
Editor

PSE KA DËSHTUAR REZISTENCA JOVIOLENTE NË KOSOVË

[Artikulli është pjesë e publikimit (kapitulli IX): New States, Old Problems, Innovative Solutions: The Case of the Successor States of the Former Yugoslavia e botuar në kuadër të "Rebuilding Fractured Communities serie, UNDP, MDGD, 2001 New York. Ribotohet me lejen e UNDP]

KOSOVA DHE SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË

Në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve 90 kriza e ish federatës jugosllave ka qenë fokusuar në çështjen e Kosovës.¹ Megjithatë, arsye e vërtetë e shpërbërjes së federatës nuk ishte Kosova. Shpërbërja e federatës ishte një proces kompleks, i bazuar në antagonizmat e trashëguar. Jugosllavia, që nga koha e krijimit të saj (1918), ishte një "shtet fragjil" për shkak të "kundërshtive midis pikëpamjeve serbe dhe kroate rreth Jugosllavisë"². Kosova në vitet '80 shërbeu si një "katalizator" dhe gjenerator i irredentizmit serb (Maliqi 1989: 69, 178).³

-
- 1) "Pa ekgzagjerime, mund të thuhet se Jugosllavia në të vërtetë është shkatërruar në Kosovë" – Pesic: 35. "Jugosllavia është shkatëruara faktikisht më 5 korrik 1990 pas shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës (...) Kuvendi federativ nuk ka mundur të funksionoj legalisht dhe plotëfuqishëm ngase njëri prej përbërësëve të tij konsitutiv, me të drejtën e vetos, është shpërbërë me dhunë. (...) Aneksioni i 5 korrikut andaj ka qenë, me efektet e tij, një lloj grusht shteti, pas të cilit Jugosllavia hyri në gjendje të kaosit." Maliqi 1997: 150; Maliqi 1998: 36.
 - 2) "Konceptimet e ndryshme të çështjes kombëtare serbe dhe kroate ishin lëva kryesore që i ka shtyrë të dy palët në pozicione ekstreme gjatë viteve kritike '90" Pesic: 28.
 - 3) Mbi qëllimet irredentiste luftarake serbe shih: Pesic: 58. Opinioni e njëjtë e ndanë edhe Mehmet Kraja: "Serbia shfrytëzoi Kosovën për ringjaljen e nacionalizmit të vet; cak nuk ishte Kosova, vetëm 'pengesa e parë' drejt cakut", Kraja: 150.

Edhe pse analizat parashikonin se lufta fillimisht do të shpërthente në Kosovë (THE KOSOVA REPORT, p. 42-43.), ajo filloi në Slloveni⁴, si një episodë, për t'u zgjeruar më pas në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Qëllim i luftërave nuk ishte mbrojtja e federatës, por realizimi i shtetit serbomadhi mbi platformën e të ashtuquajturit Memorandum i ASSHA (SANU, 1986)⁵. Luftërat kishin për qëllim zhvendosjen masive të popullatës dhe rikompozimin e "territoreve etnike" që konsideroheshin se u takojnë serbëve (RAT U HRVATSKOJ I BIH, p. 161-175; MALIQI, 1998 p. 128-132).

Kthesa e shpejtë e krizës nga margjina (Kosova) drejt qendrës (konflikti serbo-kroat) nuk u shkaktua vetëm me manovrat e regjimit serb. Kësaj i kontribuoi edhe kthesa që ndodhi në Kosovë. Lëvizja politike shqiptare zë fill në fund të viteve '90 nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, e vendosur në rezistencë joviolente, duke mos reaguuar me forcë kundër forcës. Synimi kryesor i lëvizjes shqiptare në Kosovë ka qenë pavarësia e Kosovës, por metodat e saj të veprimit kanë qenë të zgjedhura me mjaft kujdes dhe kërkonin mbështetje nga bashkësia ndërkombëtare. Përmbajtja e shqiptarëve nga dhuna ka mundësuar mbajtjen e gjendjes status quo, as të luftës as të paqes në Kosovë. (MALIQI, 1998, p. 185).

"Shoqëria paralele" kosovare ka funksionuar me sukses deri në Konferencën e Dejtonit, me të cilën u përfundua lufta në Bosnje. Kjo konferencë shkaktoi zhgënjim në Kosovë, për arsye se çështja kosovare u la anash. Qarqet militante në lëvizjen shqiptare kanë konsideruar se rezistenca joviolente ka pësuar mospjesëmarrje të plotë. Ata në ndërkohë kanë përgatitur kryengritjen, respektivisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e

4) Antagonizmi bosht jugosllav (serbo-kroat) ka patur edhe një akceleruues shtesë në separatizmin slloven, i cili e shtutëzoi krizën për "katapultimin" e Sllovenisë në pavarësi (26 qershor 1991). Ka ndërkaq dëshmi se vetë Serbia e kishte "përfshijtur" Slloveninë nga Jugosllavia; Mesic: 33.

5) "Memorandum i ASHAS (SANU)," Duga, Beograd, Qershor 1989; Vujaçiq e quan dokumentin "Manifesto i nacionalizmit serb". (Vujaçiq 1995:[cituar sipas versionit të tekstit në Internet]). Memorandumi i ASHAS pat shtruar në trajtën pothuajse ultimative solucionin e zgjidhjes për Jugosllavinë: o do bëhet shtet unitar nën hegjemoninë serbe, o serbët do të detyrohen që ta krijojnë shtetin e tyre etnik.: Magas, 199-200.

cila ka dalë në skenë në vitin 1997. Regjimi i Millosheviqit, i tronditur pas humbjes së zgjedhjeve lokale dhe demonstratave 100 ditëshe (nëntor 1996 – janar 1997), e ka pranuar sfidën e UÇK. Regjimi serb kështu ka patur më në fund një casus belli, por nuk është mjaftuar vetëm me aksionet kundër UÇK. Ai kishte vendosur të realizojë të ashtuquajturën “zgjidhje finale” të çështjes kosovare. Është aplikuar strategjia e “tokës së dje-gur” (represalje ndaj popullatës civile, shkatërrim e djegie të vendbanimeve) respektivisht skenarin e njëjtë si në luftërat e mëparshme në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë.⁶

Bashkësia ndërkombëtare, e cila ka marrë mësim nga gabimet e bëra për shkak të reagimeve të vonuara dhe pranimi të rezultateve “të akteve të kryera” dhe pasojave të të ashtuquajturit “pastrim etnik të territoreve”, në Kosovë ka vepruar më shpejtë dhe më vendosshmërisht, për të penguar një gjenocid të ri.⁷

ZHVILLIMI I REZISTENCËS CIVILE NË KOSOVË

Lëvizja shqiptare në Kosovë '90 është krijuar si reagim ndaj hegjemonizmit serb. Si dhe në pjesët tjera të Jugosllavisë edhe në Kosovë është bërë “homogjenizimi etnik” i plotë i disponimit politik të qytetarëve. Reagimi i parë masiv ka shpërthyer në nëntor të vitit 1988 kundër largimit të udhëheqësisë lokale.⁸ Shqiptarët e Kosovës pas këtyre demonstratave

6) Mbi përsëritjen e skenarit shih më detalisht: Magas 1999: 299

7) Pas dështimit të negociatave (Konferenca është mbajtur në Rambuje afër Parisit gjatë muajve shkurt-mars 1999) ngase delegacioni serb refuzoi që ta nënshkruajë marrëveshjen e propozuar, fuqitë perëndimore morrën vendimin për intervenim ndëshkues militar të NATO-s ndaj Jugosllavisë. Bombardimet e caqeve militare në RFJ forcat e Alencës Perëndimore i filluan më 24 mars 1999. Më 9 qershor RFJ kapitulloi në Kumanovë. Kontrollin mbi Kosovën e morrën forcat ndërkombëtare të KFOR-it (NATO + Rusia). Me Rezolutën 1244 të KS të OKB administrimi i Kosovës kaloi mbi Misionin Civil të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) dhe OSCE. Shih: The Kosovo Report: 320-330.

8) Të paktën dy qind mijë shqiptarë morrën pjesë në marshet protestuese, që derdheshin nga të gjitha vendbanimet drejt kryeqytetit, Prishtinës. Ata kërkonin anulimin e vendimit për ndërrimin e udhëheqësve të Kosovës (Azem Vllasi dhe Kaqusha Jashari ishin detyruar që të largohen nga postet e tyre); Maliqi 1990: 179; Clark 2000: 47.

fituan një vetëbesim kolektiv, në fazën fillestare të orientuar në mbrojtje të autonomisë së Kosovës.⁹ Në shkurt të vitin 1989 215 intelektualë shqiptarë nënshkruan një apel kundër ngushtimit të autonomisë së Kosovës (Clark 2000: 50; Maliqi 1990: 273; Kraja 1995: 159). Me 20 shkurt filloi greva e minatorëve të "Trepçës", e cila u shndërrua në një grevë të përgjithshme 7 ditëshe. Serbia u përgjigj me burgosjen e liderit komunist Azem Vllasit dhe udhëheqësisë së minierës Trepça, si dhe me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme (Maliqi 1998: 81-95; Clark 2000: 47-47). Qeveria federale me orientim pro perëndimor e Ante Markoviqit ishte e pafuqishme ose bënte kompromise duke besuar se Millosheviqi do të mund të ndalej me masa politike e ekonomike (pluralizmi dhe rregullimi i lirë i tregut).¹⁰ Rreth 400 intelektualë kosovarë janë burgosur në ditët e para të marsit. "Izolimi"¹¹ i tyre ka qenë një masë frikësimi para mbajtjes së mbledhjes të Kuvendit të KSA të Kosovës, me 26 mars 1989. Kuvendi është mbajtur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, dhe në të është imponuar ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës.¹²

Gjatë tërë vitin 1989 Kosova është mbajtur nën pushtetin e tiranisë. Përderisa në pjesët tjera të Jugosllavisë janë krijuar organizata dhe parti opozitare, në Kosovë ishin të ndaluara të gjitha tubimet publike. Vetëm në fund të vitit 1989 u mbajtën tubimet e para në Kosovë.¹³

9) Në analizat e mëvonshme do të pohohet se kjo "mbrojtje e autonomisë" ka qenë vetëm "fasadë" dhe "maskë" për qëllimin më radikal, përkatësisht për kërkimin e pavarësisë së Kosovës. Kraja: 150-153

10) Vetëm qeveria sllovene organizoi tubimin protestues (në Cankarjev dom) në të cilin është tërhequr vëmendja se pretendimet serbe çojnë drejtë shkatërrimit të Jugosllavisë. Magas 1993: 236-7; Kraja: 156

11) Ata, në të vërtetë, ishin burgosur dhe rrahur dhe keqtrajtuar brutalisht, pa respektimin e procedurave ligjore të hetuesisë dhe të të drejtës për mbrojtje. Clark 2000: 53; Maliqi 1990: 273.

12) Megjë ndërtesa e Kuvendit të Kosovës ishte e rrethuar me njësi të armatosura serbe, ky akt është quajtur "Kushtetutë e tankseve". Policia serbe intervenoi brutalisht kundër protestave të organizuara në Prishtinë dhe vendbanimet tjera në Kosovë. Kraja: 157; Clark: 72..

13) Më 9.12.1989 është themeluar dega kosovare e organizatës së parë opozitare në Jugosllavi - Shoqata për Iniciativë Demokratike Jugosllave (SHIDJ), disa ditë më vonë është krijuar Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ) – dhe më 23.12'89 është mbajtur kuvendi themelues i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK); Maliqi 1998: 15-42..

Pas ndërprerjes Kongresit të LKJ me 25 janar 1990, regjimi i Millosheviqit nëpërmjet liderëve kosovarë kukull u përpoq të provokojë kryengritjen në Kosovë, për të fituar ashtu alibin e shpalljes së gjendjes së luftës, me çka do të sigurohej kontrolli unitarist serb mbi proceset që shprienin drejt shpërbërjes së shpejtë të Federatës. Mirëpo, në atë periudhë kritike (fundi i janarit – mesi i shkurtit të vitit 1990), lëvizja shqiptare kaloi papritmas nga faza e kryengritjeve anarkike në fazën e vetëdisciplinimit.¹⁴ Këtë e ndihmojë rritja enorme e antarësisë së LDK-së dhe popullariteti të liderit të saj, dr. Ibrahim Rugovës.¹⁵ Pas apelit të drejtuar të dr. Rugovës në mbrëmjen e 2 shkurtit nëpërmjet televizionit lokal për ndërprerje të demonstratave, trazirat u ndalën që të nesërmen. Lëvizja burimore kosovare fitoi shpejt strukturën dhe hierarkinë. Forca shpirtërore e lëvizjes bazohej në besimin gati fanatik te demokracia dhe protestat paqësore, si metoda efikase e kundërvënies ndaj regjimit komunist dhe nacionalizmit serb (Maliqi 1998: 97-105). Revolucioni demokratik në Evropën Lindore, ku komunizmi po rrënohej si kullë prej letre, krijoj bindjen që edhe në Kosovë patjetër do të ndodhë kthesa demokratike. Në zgrip të luftës dhe kaosit, ideja e zgjedhjeve të lira i kishte pacifikuar ambicjet e shqiptarëve.

Nga ana tjetër, elita shtetërore dhe intelektuale serbe, e krijoi një koalicion të madh populist (Vujacic 1995; Magas 1993;

14) Forcat speciale policore kanë bërë masakra në Malishevë, Gllogovc and Zhur, duke hapur zjarr nga makinat e blinduara ndaj kalimtarëve të rastit ose kolonat e njerëzve që kanë protestuar qetë, ashiqare me qëllim që të provokohet reagimi spontan i njerëzve ose kryengritja, për të pasur kështu arsyen e fillimit të luftës (casus belli). Maliqi 1990: 267-274.

15) Liderët e LDK-së pohonin se deri në fund të janarit në këtë organizatë janë antarësuar 700 mijë veta. Kjo shifër është e ekzagjëruar, por është fakt se antarësimi i një numri kaq të madh në atë kohë është kuptuar "si një lloj referendumi". Edhe peticionin "Për demokraci – kundër dhunës", i organizuar në fillim të shkurtit 1990, për një javë e kanë nënshkruar më shumë se 400 mijë veta. Për LDK-në themeluesit e saj thonin se organizata "nuk ishte parti në kuptimin modern të fjalës por më shumë një lëvizje". Njëri nga themeluesit dhe ideologët, shkrimtari Mehmet Kraja, këtë periudhë e vlerëson si "dalje nga kaosi politik", ngase "LDK-ja e kishte zëvendësuar në bindjet e njerëzve strukturën e pushtetit" Kraja: 170-73.

Popov 1993), me idenë që para zgjedhjeve të lira të kufizohet ose të heqet plotësisht autonomia e Kosovës.¹⁶ Pasojë vrapi me kohën, ku shqiptarët angazhoheshin për demokraci ndërsa serbët për vendosjen e diktaturës shtetërore ose ushtarake, për t'i "shpëtuar" ashtu territoret "serbe". Edhe antikomunistët edhe demokratët liberalë në Serbi e pranuan formulën e Millosheviqit që për interesat nacionale serbe nuk është prioritet demokracia, por mbrojtja e interesave shtetërore dhe nacionale të serbëve në Jugosllavi.¹⁷

Në Kosovë beteja zhvillohej midis institucioneve kosovare të përgjysmuara dhe aparatit shtetëror serb të fuqishëm. Deri në qershor të vitit 1990 në Kosovë kanë funksionuar institucionet autonome¹⁸, por disponimin politik të masave e kontrollonte qendra e re e forcës, LDK dhe lideri i saj dr. Rugova. Karizma e LDK dhe e dr. Rugovës u bë kolosale, pas ftesës që i bëri Kongresi amerikan më 24 prill 1990 delegacionit kosovar 15 anëtarësh. Në dëshminë që u mbajt para Komisionit të Kongresit për të Drejtat e Njeriut, delegacioni kosovar u ballafaqua me delegacionin serb në krye të të cilit ishte Dobrica Qosiq. Lobi shqiptaro-amerikan arriti të sigurojë sigurim special shtetëror për dr. Rugovën¹⁹. Dr. Rugova në Kosovë u prezentua si "i zgjedhuri amerikan", të cilit i është siguruar përcjellja që u jepet vetëm shtetarëve të rangut më të lartë. Në

16) Nëse zgjedhjet e lira do të mbaheshin në kushtet kur Kosova ende gëzonte autonomi të lartë, Serbia rrezikonte humbjen faktike të kontrollit mbi Kosovën. Sërgja Popoviq, intelektual liberal dhe i orientuar kundër regjimit, e komenton me ironi këtë qëndrim të regjimit dhe të opozitës: "Habitem me intelektualët serbë të cilët kërkojnë që së pari të kryhet puna në Kosovë, e pastaj, kinse, ata do ta ndërtojnë demokracinë. Po si mund ta bësh demokracinë nëse e bënë punën ashtu siç e ke paramenduar. Me kë do ta bësh atë demokraci? Me ata që i ke vrarë atje?" Popovic: 128.

17) Ky mashtrim do të paguhet shtrenjtë jo vetëm me çmimin e luftërave dhe shkatërrimin e Jugosllavisë, por edhe me mbërthimin e vetë Serbisë në prangat e diktaturës së Millosheviqit. Perovic: 198-203..

18) Kuvendi, qeveria, shërbimet publike, etj.

19) Gjoja ngase ekstremistët serbë ishin kërcënuar se do të bënin atentat në Dr. Rugovën. Më vonë është pohuar se informatat për kërcënimin e kanë pasur burikin dhe janë përhapur nga vetë Dioguardi.

mediat kosovare kjo u interpretua si mbështetje e tërthortë e SHBA-ve për Rugovën dhe lëvizjen për Kosovën e pavarur.

Në fund të muajit qershor, institucionet legale autonome të Kosovës, respektivisht pjesa e tyre shqiptare, të nxitura nga disponimi i masave, do të përpiqen ta kthejnë situatën në favor të tyre dhe të përgatisin terrenin për shpalljen e Republikës së Kosovës. Kryetari i Kuvendit, i cili në atë mandat ishte serb u bënte obstrukcion përpjekjeve të delegatëve shqiptarë, duke e ndërprerë mbledhjen e Kuvendit më 25 qershor, pas një "incidenti verbal".²⁰ Me 2 korrik 117 delegatë të Kuvendit u mbledhën para godinës së Kuvendit, të cilën e ruante policia. Megjenëse u penguan të hyjnë në sallë, ata e mbajtën mbledhjen para portës, ku edhe u lexua Deklarata e Pavarësisë së Kosovës. Tri ditë më pas, Serbia u përgjigj me aprovimin e ligjit me të cilin i abrogoi "përkohësisht" të gjitha institucionet autonome të Kosovës. Pasi një seri ligjesh me të cilat institucionet publike dhe resurset ekonomike u bartën në pronësi të shtetit të Serbisë.²¹ Millosheviqi e realizoi "bashkimin e Serbisë"²². Në Kosovë regjimi i Millosheviqit ndërtoi në apartheid të veçantë, ku shqiptarët ishin të përjashtuar madje edhe nga institucionet kulturore dhe sportive²³.

20) Mbledhja e Kuvendit është ndërprerë kur delegati Ruzhdi Bakalli nga Gjakova deklaroi: "Kuvendi i Kosovës më 1945 ka marrë vendimin se Kosova si krahinë autonome i bashkohet Serbisë. Ku Kuvend prandaj ka të drejtë të marrë edhe vendimin që Kosova të shkëputet nga Serbia", *Rilindja*, Prishtina, 26 qershor 1990, 1.

21) Nekibe Kelmendi në artikullin: *Kosova under the Burden of the Serbian Discriminatory Laws: Facts and Evidence* jep pasqyrën e akteve ligjore që Serbia i kishte ndërmarrë – shih: Kelemendi 1993: [cituar sipas versionit në anglisht të studimit të publikuar në Internet]. Shih pokështu: The Kosovo Report: 301-318.

22) Në mitingjet populliste dhe nacionaliste slogani kryesor ishte: "Srbija iz tri dela - treba da postane cela". Serbia e ndarë në tresh duhet të bëhet unike.

23) Serbët, të cilët përbënin vetëm rreth 8% të popullsisë së Kosovës, e morrën kontrollin e plotë të administratës dhe ekonomisë. Në dy vitet pasuese 150 mijë shqiptarë janë përjashtuar nga puna. Maliqi 1998: 107.

Delegatët shqiptarë të Kuvendit të “shpërndarë” të Kosovës, të cilët i konsideronin masat e Beogradit jokushtetuese dhe jolegjitime, mbajtën me 7 shtator të vitit 1990 një mbledhje sekrete në qytezën e Kaçanikut, në të cilën u shpall Republika e Kosovës.²⁴ Nën kontrollin e shqiptarëve mbeti shtypi, prona private dhe tregtia e vogël, si dhe segmente të “shoqërisë së vetorganizuar”: sindikatat, shkollat, organizatat politike dhe humanitare, shoqatat profesionale, shoqatat e qytetarëve, segmentet ambulante të sistemit të shëndetësisë. Organet e shpërndara më parë me dhunë të vetadministrimit lokal, si dhe udhëheqësitë e ndërmarrjeve, edhe më tej prezentoheshin si “institucione legjitime kosovare”, por pa mundësinë që të realizojnë funksionet administrative dhe ekonomike. Qeveria në ekzil kishte më tepër një funksion simbolik, duke aprovuar ligje dhe rregullore që nuk mund të zbatoheshin.

Pushtetin real politik dhe moral mbi shqiptarët e mori LDK duke i drejtuar të ashtuquajtura “institucione paralele”, të shumtën të trashëguara nga koha e autonomisë.²⁵ Regjimi serb në një mënyrë, ia dorëzoi pushtetin mbi shoqërinë shqiptare LDK-së dhe Ibrahim Rugovës, për t’iu përkushtuar zgjidhjes së çështjes serbe në pjesët tjera të Jugosllavisë. Pacifikimi i përkohshëm i Kosovës i konvenonte Beogradit, sepse në atë kohë me të madhe po përgatitej për “mbrojtjen” e territoreve serbe në republikat tjera, respektivisht të një të tretës të popullit serb që jetonte jashtë republikës amë të Serbisë.

24) Pas shpalljes së Republikës anëtarët e Parlamentit dhe të Qeverisë janë larguar në Slloveni dhe Kroaci, ku kanë vazhduar punën si Kuvend dhe Qeveri në ekzil.

25) P.sh., sistemi shkollor në gjuhën shqipe nuk ishte krijuar rishtazi, por vazhdoi punën në përmasat dhe funksionet që i ka pasur më parë, kup-tohet me kondita tjera dhe jashtë objekteve shkollore, të cilat u uzurpuan nga autoritet serbe. Clark 2000: 96. Shih pokështu: Kostovicova 1997.

REZISTENCA JOVIOLENTE KOSOVARE SI LËVIZJE BURIMORE

Rezistenca joviolente dhe organizimi i "shoqërisë paralele" dhe "institucioneve paralele", si përgjigje ndaj represionit dhe si mënyrë e zgjidhjes së konflikteve ndërnacionale, përfaqësonte një përvojë mjaft specifike, të ndryshme nga ato që sollën konflikte dhe luftëra në pjesët tjera të Jugosllavisë. Në një periudhë të caktuar 1990-1997, kjo lëvizje burimore shqiptare u vlerësua prej shumë analistëve si unike në llojin e vet dhe u konsiderua si shembull që mund të shërbejë si model për pacifikimin e situatave konfliktuale. Në Kosovë, edhe pse të gjitha analizat flisnin për një luftë të pashmangshme dhe para atyre që shpërthyen në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, lëvizja kosovare vërtet kontribuoi shumë që lufta të shtyhej për një periudhë të caktuar. Qëllim i kësaj lëvizje ishte që në të vërtetë të shmangej lufta, por ajo këtu nuk pati sukses. Lufta, megjithatë, shpërtheu në vitin 1998. Arsyet e mospasjes mund të kërkojnë si te rrethanat e përgjithshme të pafavorshme, ashtu edhe te dobësitë e brendshme të vetë lëvizjes. Analiza e jonë e lëvizjes joviolente kosovare do të fokusohet te dy pyetje çelës:

A mund të gjenden në lëvizjen kosovare të rezistencës joviolente elemente për një model specifik të shmangies dhe zgjidhjes të konflikteve ndërnacionale, i cili si i tillë do të ishte valid edhe për situatat e tjera konfliktuale?

Pse kjo lëvizje burimore në fund dështoi?

Kur kemi të bëjmë me modelin, ai sipas vlerësimeve të shumë analistëve përfaqësonte një eksperiment unik social e politik në llojin e vet dhe si i tillë është jashtëzakonisht i vlefshëm për vëmendje dhe analiza. Mirëpo, edhe pse ai si rezistencë civile dhe lëvizje politike pragmatikisht u vlerësua në mënyrë pozitive, as vetë protagonistët e saj dhe as faktorët e jashtëm dhe analistët nuk i reflektuan në kohë të duhur potencialet dhe efektivitetin e saj real. Kontekstualisht, rezistenca joviolente vlerësohej në raport me krizën regjionale. Kosova dukej si një lloj "oazë mirësjelljeje" në raport me vatrat e tjera

të krizës në të cilat interesat e "papajtueshme" etnike përfunduan me gjakderdhje, me konflikte luftarake jashtëzakonisht të egra. Përgjigjja kosovare ndaj krizës, e cila në thelb kishte të njëjtin karakter radikal konfliktuoz "etnik", ishte në masë të madhe e idealizuar si në Kosovë, ashtu edhe nga faktorët e jashtëm. Ky idealizim bazohej në një lloj verbërimi me stabilitetin mashtrues të situatës kosovare. Në të vërtetë, paqja relative kosovare, si situatë e status quosë dhe baraspeshës së frikës, bazohej mbi premisa dhe kompromise mjaft të këqija dhe jo stabile.

Bashkësia ndërkombëtare edhe pse ishte e ndërgjegjshme për situatën e rëndë, nuk kishte mjete efikase për intervenim parandalues. Sanksionet ekonomike dhe politike, edhe në format e tyre më të ashpra dhe më të buta, nuk kishin ndonjë ndikim më efektiv mbi regjimin e Millosheviqit dhe, poashtu, disponimin e përgjithshëm politik në Serbi, sipas të cilit çështja e Kosovës ishte "çështje e brendshme" e Serbisë, respektivisht e Jugosllavisë, si shtet sovran. Bashkësia ndërkombëtare në këtë pikëpamje, në të vërtetë, në parim e mbështeste idenë e sovranitetit serb mbi Kosovën. Ajo e dënonte vetëm masat radikale represive dhe shkeljen masive të të drejtave dhe lirive të njritut në Kosovë. Rezistenca joviolente e shqiptarëve të Kosovës, edhe pse qëllimi i lëvizjes ishte pavarësia e Kosovës, krijonte iluzione e motivuar nga pragmatizmi politik se konflikti rreth sovranitetit dhe kontrollit të territorit mund të zgjidhet me kompromis, respektivisht që lëvizja kosovare do të arrinte ta shtyjë luftën përderisa Serbia të mos demokratizohej, respektivisht deri në rënien e regjimit luftënxitës të Millosheviqit. Premisa kryesore e politikës ndërkombëtare rreth çështjes së Kosovës ishte pra shtyrja e konfliktit.

Shtyrja e konfliktit ishte gjithashtu edhe premisa kryesore e lëvizjes shqiptare. Dr. Rugova dhe LDK në periudhën 1990-92 e ndoqën strategjinë e rezistencës që bazohej mbi parimet e luftës politike joviolente për realizimin e qëllimeve të shqiptarëve. Edhe pse lëvizja nuk ishte ndërtuar mbi një bindje më të thellë filozofike dhe nuk e kishte një artikulum sistematik teorik dhe politik, ajo megjithatë lënte përshtypjen e një lëvizjeje shoqërore me bazë të fuqishme, shumë të motivuar dhe të

organizuar, të cilën disa autorë e kanë vlerësuar si "mrekullia e Kosovës", lëvizje "unike në historinë politike"²⁶. Edhe Komisioni i Pavarur për Kosovën në raportin e tij konstaton: "LDK, nën udhëheqjen e Rugovës, ka krijuar një aparat paralel shtetëror historikisht unik" (The Kosovo report 200: 45).

Vlerësimet e lëvizjes shqiptare vërtet ishin mjaft euforike. Një avokat francez, aktivist për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pohonte se "populli që padyshim ishte më së shumti i shtypur në ish Jugosllavi e krijoi njeriun më të lirë." (Rugova 1994: 101) Një mendim të ngjashëm të lartë për rezistencën joviolente shqiptare e kanë shprehur asoherë edhe disa autorë serbë e sllovenë.²⁷ Studimet më të reja, si ajo e Howard Clarkut, e vlerësojnë mjaft pozitivisht fazën fillestare të rezistencës civile në Kosovë ("Shqiptarët e Kosovës janë organizuar në mënyrë impulsive gjatë viteve 1990-92"²⁸), por janë të rezervuar lidhur me fazat e mëvonshme, kur kjo lëvizje i tregoi dobësitë e veta të brendshme. Një mendim të ngjashëm e ndanë edhe Tim Judah, i cili për lëvizjen joviolente thotë: "Ishte një eksperiment i jashtëzakonshëm dhe dështoi" (Judah: 59).

Mossuksesi i eksperimentit kosovar gjithsesi mund të shpjegohet edhe me ndikimin e faktorëve të jashtëm. Tashmë e kemi përmendur mungesën e mundësive legale për intervenim

26) "Albanian opposition in Kosova... produced an independent and autonomous civil society under the very noses of the Yugoslav authorities - a counter-power unique in political history." (Opozita shqiptare në Kosovë... ka krijuar një shoqëri të pavarur dhe autonome para hundëve të autoriteteve jugosllave - një kundër forcë unike në historinë politike); Schwartz:127-131.

27) Shkrimtari serb me orientim kundër regjimit Mirko Kovaç shkruan: "shqiptarët janë politikisht populli më i pjekur në Jugosllavi". Filozofi slloven Slavoj Žižek e vlerësonte lart rezistencën shqiptare: [Shqiptarët] "janë popull evropian që shquhet për nga durimi, që shfrytëzon metoda gandiane në politikë, duke iu përgjigjur dhunës me jodhunë". *Borba*, 13 March 1992, Maliqi 1993:20.

28) Clark 1999: 1. Në librin e tij Howard Clark (2000), analizon në detale dobësitë e lëvizjes.

parandalues, si dhe premisën e bashkësisë ndërkombëtare të bazuar mbi shtyerjen e konfliktit gjithnjë derisa Serbia, respektivisht Jugosllavia, të mos të demokratizohet. Mirëpo, demokratizimi i Serbisë që nga fillimi i krizës ishte i lidhur nyje me çështjen kosovare. Problemi në njëfarë mënyre po shtrohej në formë të përmbysur. Nuk varej zgjidhja e çështjes kosovare nga demokratizimi i Serbisë, por përkundrazi, demokratizimi i Serbisë varej nga zgjidhja e çështjes kosovare. Regjimi i Millosheviqit erdhi në pushtet me hapjen dhe zgjidhjen me dhunë të çështjes së Kosovës, dhe ai po mbahej në pushtet nëpërmjet manipulimeve elektorale në Kosovë. Millosheviqi sundonte me Serbinë dhe Jugosllavinë nëpërmjet Kosovës dhe ai në Kosovë e mbante vazhdimisht si rezervë kërcënimin me luftë, si një mjet me të cilin do ta vazhdonte pushtetin e tij. Lufta në Kosovë edhe mund të shpjegohet si përgjigje e Millosheviqit ndaj krizës së pushtetit të tij në fund vitit 1996 dhe në fillim të vitit 1997.

Mirëpo, edhe pse Millosheviqi ishte gjithsesi fajtori kryesor për luftën në Kosovë, sepse e shkaktoi dhe e përshpejtoi në drejtim të "zgjidhjes finale", ai me siguri do të ballafaqohej me vështirësi më të mëdha për të hyrë në luftë sikur në ndërkohë të mos e kishte edhe kundërshtarin në anën tjetër, i cili jo vetëm se e pranoi sfidën e luftës, por edhe vetë e provokoi atë. Lëvizja shqiptare që më parë e kishte humbur homogjenitetin e mëparshëm dhe nivelin e lartë të organizimit dhe të vetëkontrollit. Doktrina dhe praxa e rezistencës joviolente ishte pra e tronditur seriozisht edhe në vetë lëvizjen shqiptare, në kuadër të së cilës, fillimisht si një rrymë margjinale por e vendosur në veprim, doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Shfaqja e UÇK në skenën publike me formacione të armatosura, sado që ato në fillim të kenë qenë të pakta në numër, ia ofroi Millosheviqit *cassus belli*-n e pritur.

REZISTENCA JOVIOLENTE E RUGOVËS

Ideja dhe lëvizja joviolente lidhen me liderin e lëvizjes, dr. Ibrahim Rugovën. Edhe pse njeri i pendës, respektivisht kritik letrar, dr. Rugova ishte gjithnjë koprrac në artikulin e pikëpamjeve të veta politike. Edhe "filozofia e joviolencës" që ai e promovonte, e cila e bëri të lavdishëm, nuk është artikuluar më qartas në artikuj dhe fjalime. Në thelb, politika e tij ishte më tepër pragmatike se sa e bazuar në një teori dhe filozofi. Pikëpamjet e tij për joviolencën si metodë e luftës politike mund të gjenden në një formë pak më sistematike në librin e Marie-Françoise Allain dhe Xavier Garmische: *"Ibrahim Rugova: La Question du Kosovo"*, i cili është në të vërtetë një libër bisedash që autorët francezë i kanë zhvilluar me Rugovën.²⁹

Nga përgjigjet e Rugovës fitohet përshtypja se "filozofia e joviolencës" e Rugovës është më parë një improvizim se një politikë teorikisht dhe praktikisht e menduar. Duke e konsideruar veten si "realist, dhe jo fantast" (Rugova 1994: 174), Rugova politikën e joviolencës e sheh si të vetmen alternativë që shqiptarët e Kosovës e kishin në rrethanat e dhëna shoqërore dhe raportin e forcave që mbretëronin në Jugosllavi. Rugova e vlerësonte situatën si dramatikisht të pafavorshme, sepse pohon se bëhet fjalë "një gjendje më të rëndë se sa gjendja e luftës" (1994: 57). Mbi Kosovën, pas abrogimit të autonomisë, u shfaq një "rrezik i madh nga pastrimi etnik" (1994: 117). Në rast lufte, konsideron ai, gjithsesi do të "bëheshin masakra" (1994: 117), "edhe më tragjike nga ato në Bosnjë edhe në Kroaci" (1994: 9 dhe 41). Rugova nuk e fsheh se ka frikë (1994: 169), respektivisht "që gjërat do të mund të dilnin jashtë kontrollit", ç'gjë ai e vlerësonte si një "hyrje në katastrofë" (1994: 95).

29) Ibrahim Rugova: *la Question du Kosovo*, Entretiens avec Marie-Françoise Allain et Xavier Galmiche, Fayard, Paris 1994. Botimi shqip: Ibrahim Rugova: *Çështja e Kosovës*, Dukagjini, Pejë 1994.

Në rrethana të tjera atij i dukej, dhe për këtë ai gjeti mbështetje te masat shqiptare me disponim realist, që përgjigjja më e mirë politike është vetëkontrolli: "vetëkontrolli na është imponuar për shkak të terrorit" (1994: 9 dhe 41), thotë ai në një përgjigje. "Qëllimi i politikës sonë është ta shmangim tragjedinë" (1994: 170), respektivisht pengimi i gjenocidit mbi shqiptarët e Kosovës (1994: 123).

Për t'u mos u fituar përshtypja e një defetizmi të plotë, të shkaktuar prej frikës nga epërsia e serbëve, Rugova në përgjigjet tjera ka theksuar edhe efektet pozitive dhe çliruese të mospërgjigjes me dhunë ndaj dhunës serbe. Ai theksonte "traditën e durimit" (1994: 128), si dhe "kulturën e solidaritetit" (1994: 62) te shqiptarët, si shpjegim për vetëkontrollin e lartë, si dhe ndjenjën e "autoritetit moral" dhe "fitore morale" të lëvizjes shqiptare (1994: 55). "Ata e kanë pushtetin, ne autoritetin" (1994: 101). Rugova konsideron se ajo fitore morale bazohet te liria e brendshme që e fituan shqiptarët: "Ne tani në Kosovë kemi një liri të brendshme. E kemi lirinë e shoqërisë shqiptare. Ne jemi të shtypur, por jemi të organizuar" (1994: 42). "Aktiviteti ynë nuk është i orientuar drejt luftës, por ka qëllim tjetër; ne kemi lirinë e brendshme, psikologjike, dhe këta janë hapat tanë të parë drejt realizimit, një ditë, të lirisë fizike dhe kolektive" (1994: 44). Ai është i ndërgjegjshëm se ky projekt është me rrezik dhe i pasigurt, të cilin shqiptarët "e paguajnë shtrenjtë", por është i bindur "se njerëzit mund të shpëtohen me metodat e qeverisjes demokratike" (1994: 109). Në rrethanat e asaj kohe për Rugovën qëllim kryesor ishte të shmangej lufta, por ai megjithatë shpresonte "që në një afat më të gjatë mund të korrëj edhe fitore" (1994: 42). Autorët francezë të librit e citojnë historianin dhe liderin opozitar serb, Ivan Gjuriqin, i cili ngjashëm me Rugovën konsideronte "se çdo ditë që kalon përfaqëson një fitore për shqiptarët" (1994: 149).

Në disa kontekste të tjera Rugova fliste në mënyrë të mjegulluar se "aspiratat shqiptare janë konkretizuar" ose madje që "në Kosovë funksionon vetëm sistemi ynë" (1994: 128).

Rugova, megjithatë, nuk kishte ide më të qarta se si do të mund të arrihej fitorja në një periudhë më të gjatë, sepse angazhohet jo vetëm për politikë joviolente por edhe për poli-

tikë pasive të pritjes, kundër çfarëdo aktivitetesh me rrezik potencial. Për këtë arsye ai konstaton saktë se "rezistenca shqiptare nuk është gandiste" (Rugova: 62), për të cilën e dinte se angazhohej për rezistencë aktive dhe demonstrata e protestave të vazhdueshme kundër regjimit represiv.³⁰ "Në këso kushtesh nuk mund të organizohen manifestime paqësore publike, sepse është bërë jashtëzakonisht e rrezikshme të dilet në rrugë", pohon Rugova (1994: 169). Sado që situata ishte "tmerrësisht e padurueshme" (1994: 124), vetë fakti "i rrezikut për vdekje" e imponon strategjinë e pritjes (1994: 142), "sepse ajo është rruga e vetme, pa alternativë" (1994: 141).

Strategjia e pritjes e Rugovës megjithatë nuk është krejtësisht e papërmbajtje. Ajo bazohet në bindjen se Kosova gjendet në një lloj mbikëqyrjeje dhe në mbrojtjen e bashkësisë ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i Rugovës dhe i LDK ishte ndërkombëtarizimi i çështjes kosovare. Çështjen kosovare "duhet afirmuar në planin ndërkombëtar" (1994: 128). Rugova ka gati një "besim të pakufishëm tek institucionet ndërkombëtare" (Rugova: 58), edhe pse ndonjëherë shpreh ndonjë dozë dyshimi, tradicionale ndër shqiptarët, se "Evropa është e shurdhër" ndaj faktit që Kosova është shndërruar "në një burg dhe kamp përqëndrimi të madh" (1994: 60). Mirëpo, ai besonte te mbështetja dhe ndikimi pozitiv të Shtetet e Bashkuara, si fuqi udhëheqëse botërore, si dhe tek ideja që SHBA-t dhe faktorët ndërkombëtarë herdokur do të detyrohen ta "shpërblejnë politikën e jo violencës dhe të paqes" (1994: 178).

Kur është fjala, ndërkaq, për vizionin e zgjidhjes politike për Kosovën, Rugova ka patur ide mjaft të reduktuara dhe të përgjithësuara, të cilat i përsëriste fjalëpërfjalë çdo javë në

30) H. Clark pohon se rugovizmi nuk ka të bëjë asgjë me gandizmin, dhe madje as me pacifizmin në kuptimin e mirëfillt të fjalës: "Për më tepër është keqinterpretim nëse ai [Rugova] quhet pacifist. Mbi të gjitha ai është një pragmatist. Ai e ka ndjekur politikën paqësore në kuptimin e përgjithshme të fjalës, por në një fazë si dukët e kishte favorizuar krijimin e sistemit të mbrojtjes të Kosovës, dhe më vonë ka punuar në favor të intervenimit të NATO-s. Pokështu, ai nuk ka qenë gandist. Strategjia gandiane e joviolencës është aktive, insistuese në vetëbesimin, programin konstruktiv dhe rezistencën civile, ngase filozofia personale e Gandit burimin e kishte në dialogun mbi të Vërtetën." Clark 2000: 6.

konferencat me gazetarë që mbaheshin të premteve në ora 11, në selinë e LDK-së. "Nacionalizmi demokratik" (1994: 179) i tij bazohej mbi idenë e "Kosovës si një shtet neutral, të hapur ndaj Serbisë dhe Shqipërisë, si dhe Malit të Zi dhe Maqedonisë" (1994: 47 dhe 180). Kosova e pavarur, si një shtet i hapur, do të krijohej "nëpërmjet protektoratit ndërkom-bëtar", për të cilin ai konsideronte se ekzistojnë "baza juridike" (1994: 171, 172).

Dr. Rugova gati asnjëherë nuk i ka shpjeguar këto ide të tij. Ideologu dhe veprimtari kryesor në parti ishte nënkryetari i LDK-së, Fehmi Agani, profesor i sociologjisë. Ai edhe në vetë partinë konsiderohej për njërin nga bashkëpunëtorëve të ngushtë të qarqeve me ndikim të nomenklaturës së mëparshme komuniste (Kraja: 220-2). Agani, ndërkaq, ishte një faktor mjaft i pavarur dhe, ndryshe nga Rugova, që ndalej te frazat dhe premtimet e thata, zhvillonte një politikë ditore aktive dhe i përcaktonte drejtimet ideore dhe praktike strategjike të veprimit politik të LDK-së dhe të lëvizjes shqiptare.³¹

Dr. Rugova po ashtu kishte një vizion tepër rudimentar të Ballkanit, si të një "bashkësie të popujve të vegjël dhe të barabartë" (1994: 48), po edhe për shqiptarët në Kosovë besonte "që kanë kulturë shtetformuese" dhe një "forcë të brendshme të madhe" (1994: 186; 87). Rugova, nga ana tjetër pohonte, dhe këtë si një mbështetje për opcionin e tij, "që serbët janë në të vërtetë të ndërgjegjshëm se Kosovën nuk mund ta mbajnë edhe më tej me forcë" (1994: 94).

Idetë që u parashtuan këtu nuk janë, thjesht, një përmbledhje e thjeshtëzuar e konceptit të Rugovës të rezistencës joviolente. Në esencë, idetë e tij mund të përmbliidhen vërtet pa dëmtime thelbësore në tri faqe, të cilat ai vazhdimisht dhe sërish i ka përsëritur. Megjithatë, kjo varfëri e ideve dhe argumenteve nuk ka ndikuar shumë te populloriteti dhe ndikimi i tij. Në fuqizimin e funksionit të tij prej liderit të pakontestueshëm dhe, për një kohë, të pazëvendësueshëm, kanë ndikuar shumë faktorë të tjerë, dhe jo aftësitë e tij personale dhe thellësia dhe fuqia e mendimit, aq më pak shkathtësia e tij

31) Mbi rëndësinë e F.Aganit shih më tutje në artikull.

udhëheqëse ose politike. Rëndësinë më të madhe për pozicionin e tij politik dhe autoritetin në masa e kishte mbështetje që Rugova e mori, që nga momenti i daljes në skenën politike, nga faktorët ndërkombëtarë, në radhë të parë nga SHBA dhe fuqitë evropiane. Kjo mbështetje e kishte rritur deri në maksimum karizmën e tij brenda vendit.

Mirëpo, korelacioni i karizmës dhe ndikimit ishte në të vërtetë dykahësh. Në kontaktet me shtetarët, diplomatët, ekspertët dhe gazetarët e huaj, Rugova impresiononte me idetë e tij të matura rreth zgjidhjes politike dhe demokratike të çështjes kosovare. Mirëpo, mbështetja që e gëzonte në botë ishte e kushtëzuar nga mënyra me të cilën ai e kontrollonte Kosovën. Politika botërore, e cila ishte e papërgatitur me krizën jugosllave dhe nuk kishte përgjigje adekuate ndaj saj, dëshironte paqe në Kosovë, me çdo kusht. Ndryshe nga luftat në Kroaci dhe Bosnje, të cilat konsideroheshin luftëra "të brendshme" dhe lokale, që nuk kanë reprekusione ndërkombëtare më të fuqishme (pastrimi etnik në Bosnje për bashkësinë ndërkombëtare ishte para së gjithash një problem moral dhe jo gjeostrategjik³²), një luftë e mundshme në Kosovë, si dhe në Maqedoni, është parë në dritën e të ashtuquajturit "efekti i dominos", respektivisht të zgjerimit vargor në një luftë të rrezikshme regionale, e pastaj edhe më të gjerë evropiane, e cila do ta rrezikonte paqen dhe stabilitetin botëror. Për këtë arsye presidenti amerikan George Bush në vitin 1991 e shpalli doktrinën e famshme të "vijës së kuqe" të rrezikimit të interesave vitale nacionale të SHBA-ve dhe Paktit NATO, nëse lufta do të zgjerohej në jug të Jugosllavisë, respektivisht në Maqedoni dhe në Kosovë.³³

32) Ky opinion është suportuar haptazi, në shumë artikuj, nga Henry Kissinger.

33) Presidenti amerikan George Bush më 24.12. 1992 i kishte dërguar regjimit të Beogradit të ashtuquajturin "Christmas warning" ("Paralajmërim i Krishtlindjeve"), në të cilin thuhet: 'In the event of conflict in Kosovo caused by Serbian action, the US will be prepared to employ military force against Serbians in Kosovo and Serbia proper.' "Në rast të konfliktit eventual në Kosovë të shkaktuar nga akcionet serbe, SHBA-të do të janë të gatshme të përdorin forcën militare kundër serbëve në Serbi dhe në Kosovë"- Judah: 73; The Kosovo report: 56

Politika e Rugovës e joviolencës dhe e pritjes, respektivisht e moshyrjes në kurrfarë rreziqesh, u konvenonte të gjithëve. Jo vetëm Aleancës Perëndimore, por edhe Serbisë e cila në kohën që zhvillonte luftërat në Kroaci dhe Bosnje nuk dëshironte të kishte të hapur edhe një "front jugor", shumë më delikat. Lufta, në atë periudhë, nuk u konvenonte as shqiptarëve në Shqipërinë amë, e cila si shtet po kalonte nëpër një krizë të thellë, as shqiptarëve në Kosovë, të cilët kishin mbetur edhe pa format rundimentare të sistemit të mbrojtjes. Edhe pse shumë bashkëbisedues vendorë dhe të huaj të Rugovës e vërenin, siç do të shprehej më vonë Tim Judah, se ai është "budalla i jashtëzakonshëm" ("He is extraordinarily dull", Judah: 61), në rrethana të dhëna kjo thjesht nuk ishte thelbësore, ose konsiderohej për një mimikri dhe hipokrizi të llojit të vet.

KARAKTERI SIMBIOTIK I LËVIZJES SHQIPTARE

Lëvizja civile e rezistencës në Kosovë i kishte anët e veta të forta, të cilat e mundësuan në një nivel të lartë vetëorganizimin dhe vetëdisciplinimin impresiv, por edhe dobësitë, të cilat do të dalin gradualisht në pah dhe do të shkaktojnë thyerjen e rezistencës joviolente dhe krijimin e një situatë konfuze që më vonë do të kalojë në gjendje lufte. Kjo tezë ndoshta mund të formulohet edhe në formë paradoksi, respektivisht se dobësia kryesore e lëvizjes ishte pikërisht aty ku dukej edhe fuqia e saj, te mënyra e organizimit dhe udhëheqjes së saj. Por, analiza e mëtejme do të tregojë se nuk kemi të bëjmë me një paradoks, por me një situatë specifike historike dhe shoqërore, në të cilën ishte e mundshme që udhëheqja jashtëzakonisht e dobët dhe në thelb improvizimet të shartohen te lëvizja e fuqishme shoqërore dhe nacionale, e cila me elementet e veta qenësore ishte që më parë e strukturuar dhe organizuar, ashtu që nuk nevojitej ndonjë përpjekje e madhe për të ndërtuar shoqërinë paralele dhe strukturat paralele, përkundër masave represive dhe aneksioniste të Serbisë.

Në gati të gjitha analizat e proceseve shoqërore e politike në Kosovë në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 në

të cilat flitet për krijimin e "dy sistemeve të institucioneve paralele"³⁴ në Kosovë, injorohet ose madje edhe harrohet fakti i rëndësishëm se të ashtuquajturat "institucionet paralele" në Kosovë kanë ekzistuar që më parë si institucione të autonomisë kosovare jashtëzakonisht të fuqishme.³⁵ Kosova, në të vërtetë, që nga viti 1968, e në disa segmente edhe shumë më herët, që nga viti 1945, ishte një shoqëri e organizuar ku kanë vepruar në vazhdimësi shumë institucione autonome. Kosova në vitin 1989 kishte gati dy decaenue përvojë shtetërore, sepse automomia kosovare i kishte të gjitha strukturat shtetërore si dhe republikat jugosllave të tjera. Serbia në korrik të vitit 1990 i mori të gjitha funksionet shtetërore që më parë i kontrollonin vetë kosovarët, para së gjithash shqiptarët, por ajo nuk ka mundur t'i anulojë të gjitha institucionet autonome të shoqërisë së organizuar më parë. Serbia u përcaktua për shuarjen selektive para se gjithash të funksioneve klasike shtetërore të Kosovës (qeveria, mbrojtja territoriale, policia, planifikimi ekonomik etj.), jo pse nuk dëshironte më shumë, por për arsye se nuk kishte potenciale të mjaftueshme ushtarake dhe represive që përnjëherësh t'i ngulfas të gjitha institucionet kosovare. Ajo, në të vërtetë, është përpjekur të ndalojë ose qenësisht ta reduktojë sistemin shkollor shqiptar³⁶, mirëpo kur shqiptarët vendosën që sistemi si tërësi ta vazhdojë punën dhe jashtë objekteve arsimore të okupuara, Serbia nuk dispononte me resurse të mjaftueshme represive për të penguar rreth 400.000 nxënës, studentë dhe arsimtarë të vazhdojnë punën në "institucionet paralele", të cilat në të vërtetë ekzistonin që më parë si institucione të

34) Sipas sociologut serb Dusan Janjiq, Zeri:15.

35) H. Clark konkludon se kemi të bëjmë me dy lloje të institucioneve paralele: të parat ngriten përmes "transferit të organeve të mëparshme autonome në organe të Republikës së Kosovës të vetëshpallur", dhe të tjerat nga "konstruksionet e sistemeve të reja" Në këtë libër jipet përshkrimi më i detalizuar i këtyre institucioneve paralele: Clark 2000: 95-117.

36) Fjala është për një sistem të plotë të pavarur, që nga institucionet parashkollore, ato të shkollave fillore dhe të mesme, deri te universiteti dhe institutet pedagogjike dhe botuese: Kostovicova 1997; Clark 2000: 95-100; Maliqi 1998:113-119.

autonomisë kosovare. Rasti i njëjtë ishte edhe me mediat, një pjesë të institucioneve shëndetësore, të organizatave kulturore e sportive. Vetëm format pluraliste të organizimit politik dhe sindikalist ishin risi.

Arsye e dytë pse Serbia nuk shkoi me represion total dhe pamundësimin e punës së institucioneve paralele ishin luftërat që po zhvilloheshin në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Beogradi nuk e dëshironte hapjen e parakoshme të "frontit jugor" në Kosovë. Sepse, po të ishte represioni i Serbisë i përgjithshëm, ai do të provokonte një përgjigje tjetër të shqiptarëve. Në atë rast ata nuk do të kishin iluzione për shanset e tyre që të mbrohen me joviolençë.

Më në fund, arsye e tretë ishte pozita ndërkombëtare gjithnjë më e keqe e Beogradit. Edhe pse Millosheviqi udhëhiqte një politikë arrogante ndaj botës, ai megjithatë e dinte që është nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të organizatave të shumta qeveritare e joqeveritare, të cilat e dënonin Serbinë për shkak të shkeljeve masive të të drejtave njerëzore të shqiptarëve.³⁷ Represioni relativisht "selektiv" në disa raste kishte edhe funksion propagandistik. Kështu fjala vjen Serbia i vendosi nën kontrollin e saj mediat elektronike strategjikisht më të rëndësishme, por e lejonte publikimin e lirë të medias së shtypur dhe të librave në gjuhën shqipe pa ndonjë censurë të ashpër, për të pasur ashtu para botës një arsyetim që shqiptarët e kanë të drejtën e shprehjes së lirë, por që ata e abuzojnë atë të drejtë për qëllime separatiste. Makinaria propagandistike serbe, edhe ajo e regjimit edhe ajo opozitare, pohonte që në Kosovë nuk bëhet fjalë për shkeljen e të drejtave njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve, por për masa që duhet të pengojnë ambiciet separatiste të "lëvizjes shqiptaromadhe".³⁸

37) Përmbledhja e reagimeve ndërkombëtare mbi shkeljen e të drejtave të njeriut jipet në The Kosovo Report: 301-318 (Annex I, "Documentation on Human Rights Violations")

38) Në esencë edhe T. Judah mbron opinionin e tillë, por me një paanshmëri ose konotacion lehtësisht pro-shqiptar, kur thotë se Kosova nuk është "rast i shkeljeve të të drejtave të njeriut" siç prezentohej në shumë forume ndërkombëtare, por "një luftë fundamentale midis dy popujve për kontrollin e një pjese të njëjtë të territorit", Judah: 84.

Teza që "institucionet paralele kosovare" ishin në thelb institucionet legale të autonomisë së mëparshme, dhe që lidhshipi i ri në njëfarë mënyre ka parazituar në to, mund të ilustruhet me dëshmi të qarta që ekzistojnë dhe që flasin se institucionet e autonomisë në të vërtetë kanë lozur një rol çelës në vetë organizimin në kushtet e reja represive dhe që ato, e jo LDK dhe Rugova, kanë mundur realizimin e atyre proceseve politike në periudhën 1990-1992, nga të cilat janë krijuar "institucionet paralele kosovare".

Ideologët dhe udhëheqësit në hije të atij procesi ishin disa nga liderët politik kyç të ish "nomenklaturës komuniste" kosovare. Edhe pse ata në opinionin kosovar në atë kohë akuzoheshin si "autonomistë" dhe liderë jugosllavë, ata i kanë konceptuar dhe bërë lëvizjet e themelimit legalist të shtetësisë kosovare. Në librin e njërit ndër themeluesit e LDK, Mehmet Krajës, "*Vitet e humbura*", të botuar në vitin 1995, qartazi pohohet se Ibrahim Rugova dhe udhëheqësia e LDK-së nuk kanë marrë asnjë nga vendimet vendimtare që kanë ndikuar thelbësisht në krijimin e institucioneve dhe të pushtetit "paralel" në Kosovë. Kraja pohon se "LDK nuk ka vepruar në mënyrë të pavarur, por kanë ekzistuar disa qendra të tjera që i kanë marrë vendimet"³⁹. Kryesia e LDK-së, pohon Kraja, ndër- sa atij duhet besuar sepse në atë kohë ishte anëtar i saj, nuk ka ditur që po përgatitet "*Deklarata e Pavarësisë*" (2 korrik 1990), nuk ka ditur as për shpalljen e Republikës së Kosovës në Kaçanik (7 shtator 1990), nuk e ka miratuar grevën e përgjithshme të 3 shtatorit të vitit 1990, ka patur një rol relativisht marginal në rikonstruktimin e qeverisë kosovare në ekzil (verë e vitit 1991), si dhe pjesërisht për shpalljen e referendumit për pavarësi (23 shtator 1991) dhe të zgjedhjeve "paralele" kosovare të mbajtura më 24 maj 1992.⁴⁰

39) LDK-ja ishte informuar për këtë pas marrjes së vendimit. Kraja: 230.

40) M. Kraja shtron pyetjen se kush qëndron pas këtyre vendimeve dhe pas- taj jep përgjigje, pa i përmendur emrat, se janë ish liderët e autonomisë ata që kontrollojnë procesin, duke u shprehur me shqetësim për faktin se varësit e sistemit të vjetër monist janë të implikuar në marrjen e vendimeve kaq të rëndësishme dhe me pasoja largvajtëse për Kosovën. Njëfarëdore ai shpreh dyshimin se kjo ka të bëjë me një skanar ose kom- plot, ku janë të involvuara edhe shërbimet sekrete serbe. Kraja: 231-232.

Në prapavijën e krijimit të institucioneve paralele kosovare në të vërtetë zhvillohej një konflikt midis legalistëve dhe anti-legalistëve. Legalistët konsideronin që pavarësia e Kosovës mund të ndërtohet mbi bazat e pozitës së fuqishme që Kosova e kishte në federatën jugosllave. Kushtetuta e vitit 1974 i jepte Kosovës statusin e anëtares së barabartë të federatës. Edhe pse për nga emërtimi nuk ishte republikë, ajo i kishte të gjitha funksionet e republikës si dhe të drejtën e përfaësimit dhe të vetos në nivelin e federatës. Antilegalistët, përkundrazi, konsideronin se shqiptarët e Kosovës, si një pjesë e popullit shqiptarë të ndarë me dhunë, nuk duhen të lidhen me trashëgiminë e federatës jugosllave, por që ata kanë të drejtën burimore për vetëvendosje kombëtare. Solucioni legalist, sipas tyre, mund të shpiente drejt mbetjes të Kosovës në suazat e një Jugosllavie ose Serbie të re, ndërsa konsumimi i të drejtës burimore për vetëvendosje shpie pandërmjetshëm drejt pavarësisë së Kosovës dhe bashkimit të mundshëm dhe të dëshirueshëm të Kosovës me Shqipërinë.⁴¹

Figurë politike kyçe që ka ndërmjetësuar në përpilimin e strategjisë dhe në marrjen e vendimeve nuk ishte Ibrahim Rugova, si kryetar i LDK-së, por nënkryetari i kësaj partie dr. Fehmi Agani. Ai ishte njëri ndër ideologët intelektual të kërkesës për njohjen e statusit të republikës për Kosovën (Demonstratat e vitit 1968), i cili edhe më vonë ka mbajtur kontakte të afërta me grupin e liderëve komunistë, të cilët kanë udhëhequr një politikë realiste dhe kanë pranuar formulën kompromise të Titos të statusit dysor të Kosovës (njësi e barabartë e federatës, dhe njëkohësisht, në përbërje të Serbisë), të cilit ish-in larguar nga skena politike në vitin 1981

41) Ky konflikt nuk ka qenë i artikuluar qartë në periudhën për të cilën flitet. Konflikti zhvillohej në prapaskenë dhe është bërë deridiku më problematik vetëm kur legalistët i kishin kryer punët më të rëndësishme (Deklarata e pavarësisë, shpallja e republikës etj.), dhe kur rryma kundërshare kishte vendosur që thjesht t'i përvetësojë këto veprime si të arritura të vetat. Grupi i tretë, më radikal, ai rreth LPRK-së ilegale, akuzonte të dy grupet që vepronin legalisht në Kosovë për dakordimin e tyre me kufijtë ekzistues, përkatësisht për pajtimin me copëtimin e trojeve shqiptare, si një solucion që ata e shihnin si të rrezikshëm për zgjedhjen e çështjes shqiptare si një tërësi të pandashme. Shih M.Kelmendi 1998: 153-166.

(Mahmut Bakalli, Gazmend Zajmi, Pajazit Nushi, etj.). Përderisa dr. Rugova luante rolin e një lideri të madh, i cili u identifikua me misionin e tij historik, dr. Agani bënte një politikë pragmatiste dhe udhëhiqte me pjesën aktive të politikës legaliste, duke i pajtuar tensionet midis strukturave udhëheqëse të lëvizjes, si dhe ideologëve joformalë (M. Bakalli, G. Zajmi, etj.) dhe qendrave të vendosjes (Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës).

Mirëpo, edhe pse pjesa aktive e politikës u formulua dhe u realizua nga qarqe politikanësh me përvojë, si dhe nga liderë politikë ambiciozë më të rinj (Veton Surroi, Blerim Shala), pas zgjedhjeve kosovare të mbajtura në maj 1992, që koïnciduan me shpërthimin e luftës në Bosnjë, LDK dhe lideri i saj dr. Rugova e morën nën kontrollin e tyre lëvizjen burimore, duke u angazhuar për përmajtje të plotë nga rezistenca aktive dhe në ruajtjen e funksioneve vitale tashmë ekzistuese dhe të strukturave paralele. Moment vendimtar për zhvendosjen e qendrës së fuqisë ishte kontrolli i fondeve që filluan të mblidheshin në diasporën kosovare në vendet perëndimore, si dhe në vetë Kosovën. Për të mbijetuar strukturat paralele në Kosovë, para se gjithash sistemi shkollor, nevojitej një derdhje e vazhdueshme e parave për pagat e personelit dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore. LDK dhe qeveria në ekzil, në krye të së cilës ishte Bujar Bukoshi, bashkëpunor i ngushtë i Ibrahim Rugovës që nga viti 1990, (i cili më vonë ra në konflikt me të)⁴², e shfrytëzuan fondin nacional për të siguruar pozita dominante në sistemin paralel dhe për krijimin e një monopoli të veçantë, posaçërisht mbi informacionet. Edhe pse në Kosovë botoheshin edhe disa javore të pavarura, LDK e kontrollonte opinionin publik, nëpërmjet gazetës së vetme ditore ("*Bujku*", i cili e zëvendësoi "*Rilindjen*" e ndaluar) dhe agjencisë QIK (Qendra Informative e Kosovës).⁴³

42) Konflikti është bërë i hapur në fund të vitit 1995, përkatësisht pas marrëveshjes së Dejtonit, kur Bukoshi i është bashkuar kritikuesëve të Rugovës që e akuzonin atë për udhëheqjen tejet pasive dhe imbolizuese.

43) Edhe pse QIK-u pretendonte rolin e agjencisë shtetërore, në impresum-in e buletinit ditor të saj, që distribuhohej në gjuhen shqipe dhe anglisht, ishte vendosur logoja e LDK-së, gjë që e prezentonte atë si organ partiak të LDK-së.

AUTORITARIZMI I DR. RUGOVËS

Lëvizja kosovare pa dyshim i ka kontribuar shmangies së tensioneve të drejtpërdrejta ndërnacionale dhe shpërthimit të konfliktit. Liderët kosovarë madje vazhdimisht kanë theksuar publikisht se ata janë në konflikt me aparatin shtetëror serb dhe regjimin, e jo me popullin serb. Politika serbe e apartheidit dhe krijimi i institucioneve paralele shqiptare ka krijuar një distancë fizike dhe komunikative midis dy komuniteteve. Serbët i kanë kontrolluar institucionet kryesore dhe simbolikisht i kanë okupuar objektet reprezentative dhe qendrat e qyteteve, ndërsa shqiptarët ishin dëbuar nga institucionet dhe tërhequr në margjina, në paralagjet dhe pjesët e vendbanimeve ku përbënin shumicën dhe ku ndiheshin më të sigurt. Jeta kulturore po ashtu është zhvendosur nga institucionet në skenën underground. Ekspozitat organizoheshin në restorante, shfaqjet teatrore në hapësira të improvizuara... Reduktimi i kontakteve fizike midis dy komuniteteve i ka reduktuar qenësisht edhe kontaktet e drejtpërdrejta dhe incidentet midis njerëzve të rëndomtë. Kjo vërtet krijonte iluzionin që konflikti nuk ishte ndërnacional, se nuk bëhej fjalë për një konflikt midis qytetarëve nacionalitetesh të ndryshme, por që midis tyre ka hyrë administrata dhe policia serbe, e cila e mbante atë distancë artificialisht dhe me mjete represive. Ndonjëhere, madje edhe nga pala shqiptare argumentohej se represioni shtetëror nuk është i drejtuar vetëm mbi shqiptarët, por edhe mbi serbët që dëshironin të kenë kontakte normale me fqinjët e tyre, shqiptarët.

Megjithatë, distanca që u krijua midis dy komuniteteve nuk ishte aq e pasherr siç theksonte ndonjëherë, më tepër për qëllime propagandistike, lidershipi shqiptar. Edhe pse, vërtet nuk kishte konflikte dhe incidente të drejtpërdrejta, ndarja ishte tektonike, jo vetëm midis popullatës shqiptare dhe regjimit serb. Popullata serbe e ka mbështetur në mënyrë aktive regjimin, madje me përqindje shumë më të madhe nga mbështetja që kishte regjimi në Serbi, ndërsa shqiptarët gati të gjithë ishin për Rugovën dhe LDK-në, dhe jo vetëm kundër regjimit serb dhe policisë serbe, por edhe kundër serbëve të

Kosovës, të cilët i pranonin privilegjet e apartheidit. Lëvizja shqiptare as që përpiquej ta zvogëlonte distancën midis dy komuniteteve. Ajo vendosi të bojkotojë institucionet serbe, si dhe të bojkotojë gati të gjitha lidhjet me popullatën lokale serbe, përveç atyre elementare që ishin të domosdoshme për sigurimin e ekzistencës.

Fakti që serbët gati njëzëri ishin për Millosheviqin, si "shpëtimtar të serbëve të Kosovës", ndërsa shqiptarët për Rugovën, si "shpëtimtar" të shqiptarëve, ka krijuar në Kosovë marrëdhënie ndërnacionale të një vartësie gati të plotë nga autoriteti i "prijësit" të kombit. Dy komunitetet i konsideronin prijësit e tyre si zotëra, dhe raporti i tyre ndaj krizës e përcaktonte karakterin e marrëdhënieve si të një status quo-je anomalike, ku prijësi serb e kontrollonte situatën duke u mbështetur në forcë, ndërsa prijësi shqiptar nga komuniteti i tij kërkonte të jetë pasiv, i durueshëm dhe joviolent.

Një formë e tillë e status quo-s anomalike gjithsesi i konvenonte më tepër palës së privilegjuar se asaj që objektivisht ishte humbëse. Millosheviqi ka manipuluar me serbët e Kosovës duke ua dhënë pushtetin konkret dhe privilegjet, ndërsa Rugova vartësve të tij u ofronte vetëm premtime boshe se do të bëhet më mirë. Për këtë arsye autoriteti i Rugovës ishte shumë më i brishtë se ai i Millosheviqit, dhe mund të pritej që ai gradualisht do të tretej dhe shuhej, meqenëse të gjithë shqiptarët nuk pajtoheshin me idenë që deri në pakufi mund të durohen represioni dhe poshtërimi i vazhdueshëm.

Mirëpo, lëvizja kosovare e rezistencës joviolente nuk dobësohej vetëm për shkak të pozicionit objektiv anomalik të autoritetit të Rugovës, por edhe për shkak të dobësive subjektive, personale dhe të vet karakterit të lidërshiptit të Rugovës.

Një ndër arsyt kryesore të degjenerimit të lëvizjes pacifiste shqiptare duhet kërkuar në ndarjen strukturore të pozitës lidëriste të dr. Rugovës, si instancës të vetme autoritare të saj. Pas marrjes së 99% të votave në zgjedhjet presidenciale të vitit 1992, Rugova fitoi një pushtet kolosal dhe pozitë të pazëvendësueshme në lëvizje. Megjithëse në paraqitjet e tij krijonte përshtypjen e një politikani modest dhe të butë, ai në esencë krijoi një sistem autoritar të pushtetit personal, të bazuar në një variant të kultit të një individi. Ai u shndërrua

në instancë të veçuar të lëvizjes, në qendër të saj të vendosjes, nga e cila vareshin strukturat partiake dhe strukturat e tjera "paralele" të shoqërisë kosovare. Mehmet Kraja dobësinë themelore të lëvizjes/partisë e sheh te fakti që "LDK u identifikua me Rugovën" (Kraja: 208). Rugova u shndërrua në një instancë të vetëmjaftueshme, duke injoruar gati plotësisht udhëheqësinë e LDK-së në marrjen (respektivisht më parë në "mosmarrjen") e vendimeve politike. Rugova i bllokoi të gjitha nismat politike që mund ta dinamizonin lëvizjen, posaçërisht ato që mund ta rrezikonin pozitën e tij të autoritetit më të lartë dhe të vetëm. Ai, psh., e ka pamundësuar konstituimin e Parlamentit të Kosovës të zgjedhur në maj të vitit 1992. Në të vërtetë, mu në fillim, më 23 qershor të vitit 1992, ishte caktuar mbledhja konstitutive e parlamentit, por mbajtjen e saj e pengoi policia serbe. Pas kësaj, të gjitha përpjekjet dhe presionet për ta konstituuar parlamentin dhe për ta filluar punën, me çka do të rumbullakësohej sistemi paralel, i ka bllokuar Rugova.⁴⁴ Partia vetë, me monopolin e saj, u shndërrua në peng të Rugovës. Themeluesi i saj, Kraja, e quan atë "parti lideriste të karizmës së Rugovës" (Kraja: 209), dhe aty e sheh një nga shkaqet kryesore të "erozionit të brendshëm" jo vetëm të partisë, por të tërë lëvizjes (Kraja: 212).

Struktura kryesisht autoritare e shoqërisë shqiptare në Kosovë, si dhe vakuumi institucional, i kanë shkuar në favor të monopolizimit të lëvizjes. Edhe sistemi komunist e kishte krijuar të ashtuquajturin mentalitet të pasivitetit, i cili i ngulfatte jo vetëm nismat individuale politike, por e ka pasivizuar edhe vullnetin kolektiv. Vendimet politike nuk merren në bazë të konsensusit shoqëror ose të konsultimit të pikëpamjeve të ndryshme në kuadër të lëvizjes. Vendimet i merr elita politike, respektivisht më parë vetë prijësi. Midis kolektivit dhe prijësit është krijuar raporti si midis bariut dhe kopesë, ku prijësi\bariu

44) Më 1996, kur mandati delagatëve të Kuvendit po skadonte pa e mbajtur asnjë sesion, Rugova me dekret presidencial shpalli vazhdimin e mandatit të tyre për dy vjet shtesë. Kuvendi edhe më tej mbeti fikSION, por me këtë gjest Rugova rikonfirmoi pozitën e tij të autoritetit suprem. Fehmi Agani konfirmonte pozitën e tij të pazëvendësueshme: "Konvokimi ose moskonvokimi i mbledhjes së Kuvendit varet nga vendimi i Rugovës dhe bënë pjesë në përgjegjësitë e tij", Petrovic: 180.

jo vetëm që përfaqëson, por edhe e artikulon vullnetin kolektiv. Prijësi/bariu është e vetmja instancë dinamike e lëvizjes, ndërsa populli i vete pas, duke njohur tek ai vullnetin e vet.

Monopoli LDK-së gradualisht u reduktua në monopol të Rugovës, i cili në vend të strukturave partiake dhe strukturave të tjera institucionale nisi të krijojë dhe favorizojë institucionin e Këshillit Presidencial të Kosovës, duke caktuar si këshilltarë miqtë e tij më të afërt ose bashkëmendimtarët dhe të dëgjueshmit, të cilëve ua kishte deleguar drejtimin e sektorëve të shoqërisë paralele, në funksion të zgjatjes të sundimit të tij autoritar. Në esencë, Rugova këshillohej me një rreth njerëzish gjithnjë e më të ngushtë, të cilët nëpërmjet mediave të kontrolluara e ushqenin kultin e tij të individit, duke sulmuar si armiq dhe tradhtarë të gjithë ata që shtrinin pikëpamje të ndryshme ose e kritikonin publikisht politikën e tij gjithnjë e më pasive. Rugova kurrë nuk është përgjigjur personalisht ndaj atyre sulmeve⁴⁵, për të lënë përshtypjen e një politikani të butë që u shmanget konflikteve dhe grindjeve. Ai për larjen e hesapeve e shfrytëzonte falangën e tij mediale dhe partiake.⁴⁶

PËRÇARJA IDEOLOGJIKE E LËVIZJES

Lëvizja kosovare nuk u shfaq si një lëvizje e re sociale, por doli nga matrica e mentalitetit të trashëguar të komunitetit dhe konflikteve ideore që kanë ekzistuar që më parë në atë komunitet. Shoqëria shqiptare në Kosovë nuk ishte homogjene. Ajo që më parë ishte ideologjiksht e shtresëzuar. Homogjeniteti në raport me jashtë, të cilin e imponoi agresioni serb dhe nevoja që komuniteti të mbrohet nga ai agresion, nuk ka arrit-

45) Për rivalet e tij Rugova nuk deklarohet fare. "Unë nuk polemizoj me ta" thotë ai në hyrjen e intervistës dhe me ironi konkludon: "Ju lutëm, na shpëtoni dhe na çlironi, nëse keni ndonjë zgjidhje tjetër", Rugova: 142.

46) Ekskomunikimet politike kanë qenë detyrë e QIK-ut dhe e gazetës së vetme ditore "Bujku", ndërkaq që për punët e pista, njollosjen, insinuatat dhe anatemat ndaj oponentëve është kujdesur shtojca e magazinës "Kosovara", "Horri".

ur t'i shkatërrojë matricat johomogjene të shtresëzimit të brendshëm social dhe ideologjik të shoqërisë shqiptare në Kosovë. Lëvizja nga jashtë dukej unike, mirëpo brenda saj zhvillohej një luftë për primat midis grupeve me pikëpamje të ndryshme ideologjike.

Njëren nga arsyet pse dr. Rugova e marginalizoi partinë dhe e favorizoi grupin joformal të këshilltarëve duhet kërkuar te konflikti i brendshëm ideologjik, i cili ekzistonte që nga fillimi edhe në forcën udhëheqëse të lëvizjes, LDK-në. LDK-ja në esencë ishte më tepër një lëvizje se sa një parti. Brenda LDK-së vepronin grupe me tendenca të ndryshme, të cilat në pikëpamje ideologjike ishin më afër të majtës klasike, për më tepër komuniste, qendrës ose të djathtës populliste. Vetë Rugova, si idhtar i "nacionalizmit demokratik" (1994: 179), anonte drejt popullizmit dhe një antikomunizmi skematik dhe, në esencë, të djathtës ekstreme. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë demokracinë e kuptonin si një skemë inverse të "luftës klasore" komuniste. Ai dhe këshilltarët e tij të ngushtë (psh. dr. Sabri Hamiti, poashtu me vokacion shkrimtar dhe kritik letrar) për këtë arsye shumë herët ranë në konflikt me pjesëtarët e të ashtuquajturave grupe marksiste-leniniste, respektivisht leniniste, që nga vitet '60, kur u burgos dhe u dënua për herë të parë Adem Demaçi, përbënin bërthamën aktive të lëvizjes së nëndheshme çlirimtare shqiptare në Kosovë. Pas demonstratave të vitit 1981, kjo lëvizje vazhdimisht rekrutonte forca të reja, meqenëse disa mijëra "nacionalistë" dhe "irredentistë", siç i quanin në atë kohë, u burgosën dhe u dënuan me dënime të gjata burgu. Ata ish të burgosur në vitet 1989 dhe 1990, pas rënies së komunizmit dhe pas krijimit të shpejtë të elitës së re politike në Kosovë, kishin "dalë mode" dhe ishin në një lloj konfuzioni (Maliqi 1998: 21-3). Një pjesë e këtyre ish të burgosurve mbeten mjaft skeptikë edhe ndaj pluralizmit edhe ndaj kursit realist të forcave të reja politike në Kosovë, posaçërisht ndaj idesë së rezistencës joviolente, duke vazhduar të veprojnë, sidoqoftë, në ilegalitet. Grupi më i fuqishëm ishte LPRK (Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës), e cila në vitin 1993 u na në dy fraksione: LPK (Lëvizja Popullore e Kosovës) dhe LKÇK (Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës; Judah: 115-20).

Në vitin 1990, një pjesë e anëtarëve të këtyre grupeve majtiste-nacionaliste ilegale iu bashkua partive të posafor-muara, para së gjithash LDK-së. Meqenëse LDK-ja praktikisht e përfaqësonte gjithë popullin shqiptar, ata konsideronin se duhet të jenë me popullin dhe se me veprimin brenda LDK-së, si një parti e legalizuar dhe e regjistruar, mund t'i realizojnë qëllimet për të cilat kishin luftuar në ilegalitet. Te një pjesë e këtyre anëtarëve të bashkuar, që heret ishte formuluar ideja se Rugova, Agani, dhe liderët e tjerë të LDK-së janë vetëm përko-hësisht në krye të lëvizjes dhe SE më vonë mund të zëvendë-sohen nga ata që janë flijuar më shumë, që kanë bërë më shumë dhe për këtë arsye kanë më shumë merita për eman-cipimin politik dhe lëvizjen çlirimtare të shqiptarëve. Disa nga ata konsideronin se shumë shpejtë do të harxhohej iluzioni për çlirimin e Kosovës me rrugë demokratike dhe joviolente dhe për këtë arsye e përgatisnin terrenin për marrjen e pozitave udhëheqëse në lëvizje, kur të ndodhte kthesa. Disa prej tyre as nuk i fshehnin ambiciet për "pushtimin e kalasë së lëvizjes përbrenda", nëpërmjet infiltrimit në anëtarësinë dhe strukturat udhëheqëse të LDK-së.⁴⁷

Këto grupe, vërtet, meqenëse ishin më mirë të organizuara dhe të strukturuara paralelisht, në mënyrë sektariane, në Kuvendin e LDK-së të mbajtur në vitin 1994 arritën të fitojnë shumicën dërmuese në Këshillin e Përgjithshëm dhe në Kryesinë e LDK-së. Nga kryesia në atë kohë u largua dr. Fehmi Agani dhe liderë të tjerë më të moderuar (p.sh. Edita Tahiri). Dr. Rugova, i frikësuar nga përçarja dhe dominimi i ish të bur-gosurëve, respektivisht, të "franksionit të kuq" në lëvizje, e pengoi goditjen e brendshme të "revolucionarëve". Ai me dekret bëri kthesë dhe në kryesi e ktheu "grupin e Aganit". Majtistët, duke u frikësuar nga pasojat e çarjes së hershme, u kënaqën me kompromisin dhe kontrollin mbi Këshillin Qendror të LDK-së, si dhe me ndarjen e pushtetit në kryesi. Ishte kjo, ndërkaq, një fitore e Pirros për ta, meqenëse Rugova pas kësaj e kishte edhe një arsye më tepër për injorimin e

47) Ky formulim është përmendur në publikimin programatik të LPRK-së "Pararoja" më 1990; Kraja: 207..

udhëheqësive partiake, edhe të Këshillit Qendror edhe të Kryesisë, në dobi të pushtetit personal për të cilin më askujt nuk i jepte llogari.

Përçarja përfundimtare me të majtët brenda partisë ndodhi në Kuvendin e ardhshëm të Partisë, në shkurt të vitit 1998, mu para fillimit të luftës. Mirëpo, për disidentët e majtë në atë kohë ishte tepër vonë për ta marrë pushtetin në LDK përbrenda. Ata iu bashkuan UÇK-së si njëri prej krahëve politikë të saj.

KONTESTIMI I RUGOVËS DHE I REZISTENCËS JOVIOLENTE

Strategjia e Rugovës e rezistencës joviolente ishte e pranuar gjerësisht nga masat deri në demonstratat studentore të vitit 1997 dhe me fillimin e luftës në mars të vitit 1998, kur ndodhi edhe përçarja e hapur e lëvizjes. Rugova, ndërkaq, kishte mjaft kritikë të ashpër që nga fillimi, por ata kishin mundësi tepër të vogla për ta ndryshuar disponimin politik të masave. Kritiku i parë i Rugovës dhe i LDK-së ishte akademik Rexhep Qosja, i cili në vitet '80 gëzonte reputacionin e "babait të nacionalizmit shqiptar". Qosja, kur u themelua LDK-ja, është parë si kryetar i saj. Themeluesit fillimisht atij ia kanë ofruar pozitën e liderit, mirëpo, ai këtë ofertë e ka refuzuar. Qosja më vonë është arsytuar se nuk ishte i kënaqur me programin konfuz dhe qëllimet e themelimit të LDK-së, por një supozim më i besueshëm është ai që thotë se në atë kohë Qosja nuk e ka vlerësuar mirë situatën dhe disponimin e masave. Qosja, ndërkaq, ishte një nga ideologët kryesorë të zgjidhjes së çështjes shqiptare si një tërësi, dhe jo në formë të segmentuar. Meqenëse LDK-ja në periudhën e parë angazhohej për një "autonomi reale" (siç ishte e shkruar në programin e parë të Partisë, për të qenë i pranueshëm për pushtetin jugosllav), që në të vërtetë nënkuptonte angazhimin për Kosovën republikë, si një njësi federale në kuadër të Jugosllavisë, Qosja që nga fillimi e ka sulmuar ashpër LDK-në dhe Rugovën për shkak të qëllimeve të parashtruara në nivel tepër të ulët dhe lëshimin e shansit historik që përsëri të hapej çështja shqiptare "si tërësi" (Qosja 1998: 185). Qosja dhe një grup bashkëmendimtarësh

të tij themeluan Forumin e Intelktualëve Shqiptarë (FISH), i cili ishte kundër partizimit të lëvizjes shqiptare, dhe posaçërisht, kundër monopolit të LDK-së. Në një situatë historike unike dhe nën regjimin e okupimit serb, Rugova dhe liderët e tjerë e luajnë lojën e demokracisë dhe pluralizmit, në vend që të krijojnë një front unik dhe udhëheqësi unike. Qosja argumentonte për "krijimin e Këshillit Nacional, i cili do ta organizonte popullin" dhe do të angazhohej kundër copëtimit të mëtejshëm të territoreve shqiptare, respektivisht "ndarjes tragjike të popullit shqiptar" (Qosja 1994: 13-24). Pas mospjekjes së projektit për krijimin e këshillit nacional⁴⁸, Qosja ka filluar një fushatë edhe më të ashpër kundër LDK-së dhe Rugovës, duke i akuzuar që politika e tyre "është bërë një stoli demokratike e regjimit të Millosheviqit", respektivisht që fjala është për "kolaboracion me Serbinë" dhe "për tradhti kombëtare" (Petrovic: 109).

Adem Demaçi, Mandela kosovar, i cili në burgjet jugosllave i ka kaluar 28 vjet, po ashtu është bërë një kritik i rreptë i Rugovës dhe LDK-së. Pas daljes së Demaçit nga burgu, në verë të vitit 1990, LDK tashmë dominonte në skenën politike dhe e kishte liderin karizmatik, Rugovën. Demaçi, edhe pse gëzonte një autoritet të lartë moral dhe politik, mbeti anash.⁴⁹ Demaçi dhe Rugova nuk kanë bashkëpunuar ngushtë, por në fillim as nuk kanë qenë në armiqësi të hapur. Demaçi e ka filluar fushatën kundër Rugovës dhe LDK-së pasi ka parë që lëvizja u bastardhua, posaçërisht pas përpjekjes së pa suksesshme të marrjes së "kështjellës përbenda" nga fraksioni i ish të burgosurëve, në vitin 1994, dhe posaçërisht pasi që konferenca e Dejtonit e la anash plotësisht çështjen kosovare. Si Qosja, edhe Demaçi konsideronte që organizimi i lëvizjes shqiptare në Kosovë "nuk është adekuat me rrethanat" (Petrovic: 262), që burokratizimi dhe jo invencja e saj është pasojë e udhëheqjes jashtëzakonisht të dobët. Sipas tij, në krye të lëvizjes u

48) LDK-ja dhe Rugova pas negociatave që kanë zgjidhur disa muaj janë pajtuar, më 1991, që të krijohet Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare, ku Rugova e kishte fjalën e fundit, duke mos u pajtuar me krijimin e Këshillit Kombëtar. Kraja: 223-229.

49) Demaçi u zgjodh kryetar i KMLDNJ.

gjet "intelengjencia e rrejshme, e cila nuk është e gatshme të flijohet" (Petrovic: 268), respektivisht "liderët që janë amatorë në politikë" (Petrovic: 267). "Defekti i sistemit është – në kokë", pohonte Demaçi duke akuzuar Rugovën të jetë bërë "diktator dhe uzurpues i funksioneve" (Petrovic: 272), dhe që nuk lejon të zhvillohet "as L nga lëvizja" (Petrovic: 268), respektivisht që udhëheqësia e tij ka krijuar situatën të cilën Tim Judah më vonë do ta përshkruajë si "simbiozë groteske midis Beogradit dhe Prishtinës" (Judah: 74), sepse LDK dhe Rugova "e kanë pacifikuar në mënyrë efektive krahinën, që ishte mu ajo që dëshiron zyrtarët (serbë)" (Judah: 84).

Në vend të rezistencës pasive, Demaçi angazhohej për një rezistencë aktive të tipit gandist, e cila nënkuptonte një presion të vazhdueshëm mbi regjimin serb dhe gatishmërinë për flijim për realizimin e qëllimeve (Judah: 270-71). Demaçi ka konsideruar që rezistenca aktive nuk do të thotë edhe opcion lufte, por diçka që ai e quante "as luftë, as kapitullim". Mirëpo, problemi i Demaçit dhe i Qosjes qëndronte në faktin që angazhimi i tyre për rezistencë aktive ishte më tepër teorik se praktik. Greva e urisë që organizua në qershor të vitit 1993, në mbrojtje të mediave shqiptare, ishte e vetmja formë aktive e rezistencës që e ka zbatuar Demaçi. LDK-ja përgjigjej me konstatimet që kritikët vetëm flasin dhe as ata nuk bëjnë asgjë, ndërsa pohonin që problemi nuk qëndron te ngathtësia e liderëve, por edhe te "vetëmashtrimi dhe narkoza" (Judah: 269) e masave, të cilat ishin udhëhequr në mënyrë të gabueshme dhe ishin bërë edhe vetë të ngathta dhe kishin shkaktuar një atrofi të përgjithshme dhe një bllokadë të lëvizjes.

Bardhyl Mahmuti, njëri ndër zëdhënësit e LPK-së, më vonë edhe i UÇK-së kështu do ta shpjegonte fenomenin e bllokadës: "Rugova ka aplikuar një politikë totalitare me qëllim të pengimit të çfarëdo lloj rezistence ndaj serbëve. Ai ka krijuar iluzionin që bashkësia ndërkombëtare do ta zgjidhë krizën dhe që pavarësia do të vijë si një dhuratë. LPK gjithnjë është përpjekur t'i bindë njerëzit që ky iluzion është i rrezikshëm dhe që askush nuk do të vijë dhe të na çlirojë, dhe ne do të detyrohemi të pagujmë çmimin për të. Mirëpo, mesazhi ynë ka depërtuar shumë ngadalë. Ne nuk kemi patur media, ndërsa ai ka patur televizionin, gazetatat ditore, gazetatat javore që jepnin të njëjtin mesazh" (Judah: 126).

Mahmuti flet edhe për faktin që "LDK-ja ka kontrolluar imagjinatën e njerëzve" dhe që është dashur të ndodhte marrëveshja e Dejtonit, në të cilën Kosova është lënë krejtësisht anash dhe është harruar, për t'u krijuar hapësira për një politikë të ndryshme, për një politikë të rezistencës aktive (Judah: 126).

ÇKA E SOLLI KONFLIKTIN DHE MOSSUKSESIN E LËVIZJES GRASSROOTS?

Rymat radikale në lëvizjen shqiptare që në fillim ishin tepër skeptike ndaj rezistencës joviolente. Ato konsideronin që Kosova mund të çlirohet vetëm me rezistencë aktive, që nënkuptonte edhe rezistencën e armatosur dhe kryengritjen. Grupet më radikale, posaçërisht ato në Evropën Perëndimore (LPK, LKÇK), filluan me përgatitjet për kryengritje (Hamzaj: 19-22). Në ato përgatitje ishte e përfshirë edhe qeveria kosovare në ekzil, e cila dispononte me fonde të konsiderueshme të mbledhura nga diaspora shqiptare dhe e cila ra në konflikt të hapur me Rugovën dhe me LDK-në.

Në nëntor të vitit 1995 u mbajt në Dejtון Konferenca Paqësore për Bosnjën dhe Hercegovinën. Pritjet e kosovarëve që në të do të shqyrtohej edhe çështja kosovare nuk u realizua. Kosova as që është përmendur në dokumentet e kësaj konference. Politika e rezistencës joviolente që nga ai çast filloi në mënyrë të përshpejtuar ta humbasë kredibilitetin. Kundërshtarët e Rugovës, psh. Qosja, flisnin publikisht që Dejtoni ka shënuar "fundin e iluzioneve që bashkësia ndërkombëtare do t'i dëgjonte kërkesat e Kosovës për pavarësi" (Clark 2000: 123).

Rugova dhe LDK vazhduan me politikën e mosveprimit dhe paralizën e lëvizjes, duke llogaritur edhe më tej te internacionalizimi dhe ndihma e bashkësisë ndërkombëtare.⁵⁰

50) "(Rugova) appeared to have gone into a form of political paralysis. He drove around Prishtina in his presidential Audi and simply did nothing." (Rugova) dukej se kishte rënë në një trajtë të paralizës politike. Ai endej me Audin e tij presidencial nëpër Prishtin pa vepruar thjesht asgjë. Judah: 138

Mirëpo, pas Dejtonit dukej se bashkësia ndërkombëtare në njëfarë mënyre e kishte rehabilituar edhe Millosheviqin dhe regjimin e tij, sepse ai kishte marrë rolin e garantit për realizimin e marrëveshjes për Bosnjën. Vetëm SHBA-të kishin rezerva më të hapura ndaj Serbisë, respektivisht regjimi i Millosheviqit, duke insistuar në vazhdimin e të ashtuquajturit mur të jashtëm të sanksioneve për Beogradin, përderisa të mos zgjidhet çështja kosovare.

Faktorët ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe KB, në thelb as që kishin instrumente gjegjëse dhe efikase as për tejkalimin e tensioneve ndëretnike në Kosovë dhe as për pengimin e një konflikti të hapur të mundshëm. Jugosllavia, respektivisht Serbia, ishte plotësisht jokooperative, po edhe e përjashtuar nga organizatat ndërkombëtare. Monitorimi i vazhdueshëm i krizës, para se gjithash së shkeljes të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe raportet e shumta kritike dhe notat e drejtuara qeverisë në Beograd nga institucione dhe asociacione ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nuk kishin gati kurrfarë ndikimi mbi politikën e Beogradit. Në të vërtetë, që nga maji i vitit 1993, kur në Uashington u nënshkrua marrëveshja e Fuqive të Mëdha⁵¹ rreth parimeve të zgjidhjes të krizës jugosllave, me të cilën ranë dakor që Bosnja dhe Hercegovina duhet të mbetet Union, që integriteti i ish IRJ Maqedonisë nuk guxon të rrezikohet dhe që Kosova duhet të kthejë një shkallë të lartë autonomie në kuadër të RF Jugosllavisë, regjimi i Millosheviqit privimin e vet nga politika irrendentiste ndaj pjesës serbe të Bosnjës e kompensoi me ndërprerjen e të gjitha formave institucionale të kontrollit ndërkombëtar të situatës në Kosovë, për të cilat kishte rënë dakord më parë. Beogradi i ndërpreu negociatat për Kosovën në kuadër të një grupi të posaçëm për Kosovën pranë Konferencës Paqësore të Gjenevës për Jugosllavinë, dhe poashtu i tërhoqi akreditivat për Misionin e Përhershëm të OEBS-it në Kosovë. Duke iu referuar parimit të moscenimit të

51) Në këtë kohë ishte krijuar Grupi i Kontaktit, si një mekanizëm ndërkombëtar ad hoc, i cili do të luan rol të madh në përfundimin e luftës në Bosnje dhe intervenimin në Kosovë.

kufijve të brendshëm në ish Jugosllavinë, për çka këmbëngulte edhe Grupi i Kontaktit i Fuqive të Mëdha, Beogradi që nga maji i vitit 1993 Kosovën e trajtonte ekskluzivisht si një "çështje të brendshme të Republikës së Serbisë".

Lëvizja kosovare mbeti në njëfarë mënyre e vetmuar dhe e braktisur, respektivisht ishte kapluar nga politika e inercionit. Rolin e ndërmjetësuesit për zgjidhjen e problemeve konkrete, siç ishte çështja e normalizimit të punës të sistemit shkollor, për të cilat qeveria në Beograd tregonte gatishmëri për të biseduar e morën mbi vete organizatat humanitare joqeveritare. Me 1 shtator 1996, organizata humanitare e Vatikanit Shën Egjидio, pas negociatave sekrete të zhvilluara midis përfaqësuesve të qeverisë serbe dhe ekipit negociator kosovar, në krye të të cilit ishte Fehmi Agani e arriti marrëveshjen për normalizimin e punës së shkollave. Marrëveshjen e nënshkruan ndaras S. Millosheviq dhe I. Rugova. Në atë moment dukej se është gjetur një model për tejkalimin e tensioneve me qasjen hap pas hapi, i cili nga njëra anë do t'i ofronte disa satisfakcione konkrete për lëvizjen shqiptare dhe njëkohësisht do ta siguronte kooperativitetin e regjimit serb. Mirëpo, problemi me këtë marrëveshje qëndronte te fakti se ajo mbeti e bllokuar në fazën e implementimit, sepse dy palët nuk arritën të bien dakord rreth masave konkrete dhe dinamikës së realizimit. Në vend që ta ndihmojë politikën e Rugovës, ajo shkoi në dëm të saj, sepse i zgjoi shpresat që nuk mund të realizoheshin. Në mënyrë të posaçme ishin të zhgënjyer studentët e Universitetit të Prishtinës, të cilët punonin në kushte më të rënda. Studentët, në dhjetor të vitit 1996 ia shkruan një petition Rugovës, për të cilin kishin mbledhur rreth 500 nënshkrime, me të cilin Rugovës dhe LDK-së i jepnin një afat ultimativ prej dymujsh për realizimin e marrëveshjes, respektivisht që studentëve t'u ktheheshin objektet e okupuara të fakulteteve dhe të mundësohej liria e plotë e punës për universitetin shqiptarë. Një vit më vonë, me 1 tetor të vitit 1997, Unioni i Studentëve nuk ishte më i gatshëm t'i dëgjoj premtimet boshe të Rugovës dhe të bashkëpunëtorve të tij. Kontrollin mbi Unionin e Studentëve e morën rrymat radikale në lëvizjen shqiptare, të cilat e akuzonin Rugovën për tradhti, kolaboracion me regjimin serb. Me 1 tetor të vitit 1997 studentët dhe arsimtarët

organizuan demonstrata paqësore, të cilat policia serbe i pengoi me përdorimin e forcës. Kjo ngjarje shënoi fundin e karizmës së pakontestueshme të Rugovës dhe ndikimit mbi masa. Në fund të nëntorit të po atij viti, në varrimin e një viktime të represionit serb, UÇK-ja, deri në atë kohë misterioze, u shfaq publikisht për herë të parë në një tubim në regionin kosovar tradicionalisht kryengritës, në Drenicë, ku UÇK u prit me duartrokitje frenetike dhe me miratim. Rugova dhe LDK-ja nuk kishin përgjigje dhe një strategji gjegjëse për kundërvënje efikase kësaj kryengritjeje të brendshme. Në shkurt të vitit 1998, disa javë para masakrës mbi civilët që policia e kreu në fshatrat e Drenicës, Likoshan, Qirez dhe Prekaz, me ç'rast Serbia faktikisht hyri në luftë, LDK-ja u shpërbë në krahun militant dhe në atë pacifist.

UÇK, në të vërtetë nuk u çua në kryengritje vetëm kundër pushtetit serb në Kosovë, por njëkohësisht përfaqësonte edhe një kryengritje kundër "regjimit të brendshëm" dhe pushtetit paralel që ishte organizuar nën udhëheqjen e dr. Rugovës dhe LDK-së. Kjo do të thotë që lëvizja kosovare së pari ishte kontestuar dhe rrezikuar përbrenda, që pastaj të sulmohej dhe praktikisht të shkatërrohej nga regjimi serb. Në luftë, lëvizja e rezistencës civile praktikisht kishte mbetur pa kokë dhe e çorientuar, duke mos kuptuar dhe duke mos pranuar si realitet faktin që UÇK-ja ishte një përgjigje alternative, shqiptare ndaj krizës. Dr. Rugova kur nuk e ka pranuar UÇK-në si një forcë autentike të rezistencës, duke pohuar se fjala është për një "komplot serb", respektivisht për "mercenarë me të cilët dirigjon policia sekrete serbe".

Analiza jonë ka treguar që dr. Rugova dhe LDK-ja në masë të madhe i kanë kontribuar imobilizimit dhe atrofisë të lëvizjes të rezistencës civile, respektivisht ndjenjës së shterpësisë së plotë dhe pa persektivës të zgjidhjes paqësore dhe demokratike të krizës kosovare. Suksesi i kësaj lëvizjeje të madhe dhe unike është varur nga ajo sa ishte e përgatitur dhe e aftësuar të kontrollojë situatat e krizës që kanë mundur ta shkaktonin luftën. Deri në vitin 1997 në atë lëvizje kanë ekzistuar mekanizma të caktuar për kontrollimin e zhvendosjes së disponimit të masave drejt kryengritjes së hapur. Në fund të vitit 1997 një gjë e tillë nuk ishte më e mundur jo vetëm për

shkak të provokimeve serbe, të cilat kanë qenë të pranishme edhe më parë, por edhe për shkak të vetëverbërimit dhe miopisë të udhëheqjes të lëvizjes së rezistencës civile. Në atë kohë, në të vërtetë, dolën në shesh dobësitë organizative dhe udhëheqëse të lëvizjes, i cili kishte vënë një qëllim tepër të lartë (pavarësinë e Kosovës), pa asnjë instrument serioz për realizimin e tij, dhe e cila duke dashur ta shmangë luftën me "strategjinë" të ngathtësisë, pritjes dhe mosveprimit, në njëfarë mënyre i topiti dhe i paaftësoi edhe sistemet vetjake të alarmit për rrezikun e luftës. Dobësia themelore e lëvizjes kosovare të rezistencës civile konsistonte me faktin që ajo, duke marrë mbi vete funksionin e brigadës zjarrfikëse, kishte harruar t'i mbush rezervuarët e ujit për shuarjen e zjarrit edhe në vetë stacionin e zjarrfikëse ku ajo bënte kujdestari.

Zgjidhja e krizës është dashur prandaj të kaloi në kompetenca të bashkësisë ndërkombëtare. Ajo, në mars të vitit 1998, reagoi më vendosshmërisht, duke u përpjekur ta pengoi luftën dhe të arrij një marrëveshje politike bazuar në parimet për të cilat kishin rënë dakord në kuadër të Grupit të Kontaktit në maj të vitit 1993. Fuqitë e Mëdha, SHBA, EU dhe Rusia ia kanë imponuar Beogradit pranimin e procesit negociator, duke u kërcënuar se në të kundërtën do ta përdornin forcën kundër palës më të fuqishme dhe më agresive në konflikt. Lëvizja kosovare e rezistencës joviolente përjetoi thyerje të plotë në pranverë të vitit 1998. Regjimi serb e kuptonte vetëm gjuhën e forcës. Megjithatë, rezistenca shumëvjeçare civile dhe joviolente nuk ishte krejtësisht e kotë. Ajo i ka dhënë argumentet politike dhe morale për faktorët ndërkombëtarë të involvuar në zgjidhjen e krizës për arsyetimin e intervenimit ushtarak kundër politikës serbe agresive dhe gjenocidiale.

KONKLUZION

Lufta dhe intervenimi i NATO-s vuri në lëvizje një debat të gjerë ndërkombëtar mbi çështjet më vitale mbi atë që kolokvialisht quhet 'rendi i ri botëror'. Si do të duhej të reagoje bashkësia ndërkombëtare ndaj konflikteve dhe krizave siç ishte kjo e Kosovës? Në Kosovë, jetat e miliona njerëzve qenë rrezikuar nga "agresioni i brendshëm". Shteti që konsideronte veten sovran sipas ligjit ndërkombëtar, e definoi atë sovranitet si ligj të shumicës etnike, të serbëve, përkundër faktit se struktura e popullatës është multietnike. Shqiptarët në Kosovë përbëjnë gati 90% të popullatës dhe gëzojnë një autonomi të gjerë politike. Shqiptarët nuk i fshihni aspiratat e tyre për vetëvendosje dhe pavarësi nga Serbia, mbi parimet e njëjta të të drejtave etnike, në të cilat insistonin serbët. Shteti serb përdori forcën ushtarake për ta suspenduar autonominë politike të Kosovës, pastaj provoi që fizikisht t'i eliminojë një pjesë të "qytetarëve" të tij. Serbët ishin të interesuar në territor, për Kosovën si "tokë e tyre e shenjtë", por jo për një marrëveshje dhe bashkëjetesë me shqiptarë.

Për shqiptarët e Kosovës, Jugosllavia si federatë, e cila ua garantonte të drejtat e tyre të veçanta politike, nacionale, kulturore dhe religjioze, që e pranuar si një e keqe më e vogël, sado që në mesin e tyre ishte një lëvizje e fortë që mendonte se për Kosovën më mirë të jetë në një bashkësi, jo me popujt sllavë, posaçërisht jo me serbët, por me Shqipërinë. Për shqiptarët e Kosovës ishte e paimagjinueshme mbetja e tyre në Serbi, si shtet etnik serb, nën kushtet e represionit qëllimi përfundimtar i të cilit ishte gjenocidi. Konflikti ndëretnik kosovar zhvillohej në kushtet e të ashtuquajturës "situatë ekzistenciale kufitare", si një luftë për të drejta ekskluzivisht etnike mbi një territor. Si dhe në pjesët tjera të ish federatës jugosllave, kushtet themelore për një kompromis etnik dhe politik mungonin.

Lëvizja kosovare e rezistencës joviolente u lind në matricën e ekskluzivizmave etnik dhe fragmentizimit të Jugosllavisë. Sado që ajo zgjodhi metodat e joviolencës, ajo nuk ishte "pacifiste" në termin strikt të fjalës. Ajo kishte të bëjë me çlir-

im dhe ishte lëvizje për ngritjen e shtetit. Situatat e tilla zakonisht përfundojnë në kryengritje dhe në konflikte të armatosura. Në fund, Kosova nuk mundi t'i shmanget kryengritjes për çlirim dhe luftës. Sidoqoftë, në shkallën e konfliktit të vullnetit të popullit dhe kundërvënies së agresionit të anës superiore, lëvizja kosovare e rezistencës joviolente mbase pat krijuar model sjelljeje që është valid për situata tjera krize që janë të ngjashme. Para së gjithash, e pamundësoi bartjen e konfliktit, sado që përkohësisht, nga premiset e luftës në premiset politike dhe demokratike. Në vend të një konflikti të hapur ajo demonstroi mundësi për një kryengritje "paqësore" dhe joviolente, vazhdoi dhe organizoi bojkotin ndaj masave represive të një shteti "sovrani", me të cilat ajo haptazi tregoi kufijtë e sovranitetit dhe karakterin diskriminues të atij shteti. Lëvizja kosovare ka qenë më shumë se sa vetëm mosbindje qytetare, ngase në të njëjtën kohë ajo punonte në organizimin e shoqërisë paralele dhe shtetit virtuel paralel, i cili – sado që u quajt "farsë" dhe "shtet fantom" (Judah:), megjithatë afirmoi – si një lloj të referendumit të vazhdueshëm – vullnetin e vazhdueshëm e qytetarëve të Kosovës për vetëpërcaktim. Gati dy milionë njerëz kërkuar respekt për vullnetin e tyre dhe demonstruan se nuk ka fuqi që mund ta nënshtrojë vullnetin e tyre. Njerëzit mund të dëbohen dhe vriten, gjë që e bënte Serbia, mirëpo, vullneti i tyre nuk mund të ndryshohet, e as dëshira e tyre për drejtësi dhe liri.

Me një fjalë tjetër, lëvizja shqiptare, e cila e dinte se ushtarakisht është inferiore, kishte vendosur instiktivisht që të ekonomizojë me resurset dhe potencialet e veta, duke e bërë transparente tiraninë dhe agresionin e Serbisë. E detyruar të ndërtojë një lloj qeverisjeje koloniale dhe sistem apartheidi, Serbia humbi kredibilitetin e një shteti modern që nuk i diskriminon qytetarët e vet. Kësisoj, bojkoti i përgjithshëm shqiptar, po ashtu pengoi edhe një eksploatim kolonial të resurseve ekonomike të Kosovës nga ana e Serbisë. Mbajtja e Kosovës nën kontroll, Serbisë i kushtonte shumë, e cila pa dyshim i kontribuoi në dobësimin e resurseve të saja ekonomike, të cilat tashmë ishin seriozisht të dëmtuara pas luftave në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë dhe, nga sanksionet ekonomike të bashkësisë ndërkombëtare. Regjimi serb

dhe elita ishin të vetëdijshëm se koha punonte për shqiptarët, kjo është arsyeja pse në momentin kritik, kur erdh deri te përçarja në lëvizjen shqiptare, ajo përqafoi opcionin e rrezikshëm të luftës, ashtu që mund të lironte veten nga barra e kontrollit të shqiptarëve të mosbindur apo edhe përgjithësisht nga barra e Kosovës, sepse Kosova ishte bërë tepër e shtrenjtë për Serbinë. Regjimi serb nuk e kufizoi veten vetëm në zmbarsjen e UÇK-së, por luftoi kundër civilëve. Në verën e vitit 1998, ishte e qartë se opcioni i Serbisë ishte të dëbojë dhe të shkatërrojë, të ushtrojë gjenocid ndaj shqiptarëve, që ishin të ndëshkuar për shkak të vullnetit të tyre për vetëvendosje dhe pavarësi.

Natyrisht se ekziston një pikëpamje e konsenzusit midis faktorëve ndërkombëtar dhe shteteve të shumta anëtare të KB, që në të ashtuquajturat situata "kufitare", të përshkruara në Kapitullin VII të Kartës së KB si gjenocid, intervenimi i bashkësisë ndërkombëtare është i dëshirueshëm, nëse jo edhe i pashmangshëm. Në Kosovë intervenimi i parë humanitar ndërkombëtar ishte precedencë. Lëvizja kosovare joviolente fitoi me këtë një satisfakcion të vonuar, sepse me vite angazhohej për vendosjen e një protektorati të KB si një zgjidhje e mundshme e përkohshme në rastin drastik të konfliktit të vullneteve rreth të drejtës për vetëvendosje të popujve të rrezikuar. Intervenimi nuk i ka zvogëluar vetëm tensionet midis shqiptarëve dhe serbëve, por edhe tensionet në rajon, i cili tash është në fazën e stabilizimit, të garantuar nga prezenca e forcave ndërkombëtare në Unionin e Bosnjës, në Kosovë dhe, si preventivë në IRJ Maqedoni. Intervenimi në Kosovë, në njëfarë mënyre, po ashtu e ka ndihmuar ndërrimin e regjimit dhe fillimin e proceseve demokratike në vetë Serbinë.

Megjithatë, intervenimi në Kosovë emde nuk është "kapitalizuar" në të drejtën ndërkombëtare, si model për zgjidhjen e konflikteve ndëretnike. Në Kosovë ka qenë i aplikuar një ad hoc instrument i intervenimit, i bazuar më shumë në sigurinë momentale dhe interesat politik i një numri të shteteve të Aliances Perëndimore, në mesin e të cilëve nuk ekziston konsensus i plotë rreth qëllimit dhe modelit të intervenimit. Sistemi ndërkombëtar i mbrojtjes nuk është i përsosur dhe komplet. Kjo po ashtu reflektohet në statusin relativisht josta-

bil të KB, si një organizatë e cila do të duhej të ishte përgjegjëse më së shumti për sigurinë, stabilitetin dhe kooperimin global.

Në rastin e Kosovës, KB, praktikisht mu në ditën kur është nënshkruar marrëveshja paqësore në Kumanovë, ka qenë e informuar se duhet të dërgojë misionin e vet paqeruajtës (UNMIK), funksioni i të cilit nuk është vetëm ruajtja e paqes por edhe ndërtimi i paqes dhe administrimi aktiv i territorit në periudhën transitore. Ky është, nëse nuk është më i zgjeruari, atëherë me siguri që është misioni më i vështirë i KB, që ndonjëherë e kanë patur gjatë historisë. UNMIK-u ka funksione të cilat misionet e mëparshme të KB nuk i kanë patur – para së gjithash funksionin e një protektori, modeli i të cilit është dashur që të improvizohet me nguti mbi themelet e një mandati të kufizuar, e që në vete ka shumë kompromise, të dalë nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit.

UNMIK-u është mekanizëm kompleks, që duhet të kooperojë me misionin e OESB-së dhe KFOR-in, me qëllim që të ndërtojë institucionet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, në konstruksionin dhe mirëmbajtjen e të cilit lëvizja kosovare ka qenë e angazhuar gjatë viteve 1990-të. Dhe siç ka qenë esencialisht e kufizuar lëvizja kosovare nga aspiratat e papajtueshme dhe konfliktet e bashkësive etnike, as UNMIK-u nuk mund t'iu shmanget nga këto dhe të pajtojë serbët dhe shqiptarët etnikë dhe interesat e shtetit që janë në konflikt. Sikur në Unionin e Bosnjës, faktori i huaj intervenues është i detyruar të administrojë situatën e ndarjes eksteme dhe të mosbesimit midis bashkësive etnike, që insistojnë në të drejtat e tyre territoriale, dhe në fund, në të drejtat e pakufizuara të vetëvendosjes. Faktori i tretë, dmth., fuqia neutrale, me siguri krijon më shumë mundësi për të kontrolluar krizën se sa po të ishte situatë e tillë kur njëra palë etnike dominon ndaj tjetrës, më të dobët, gjë që i parapriu luftës. Mu ashtu sikur në Qipro për një kohë të gjatë nuk është gjetur modeli për zgjidhjen e konfliktit të atjeshëm ndëretnik, ashtu edhe në Kosovë nuk mund të pritet një zgjidhje e shpejtë dhe e lehtë.

Megjithatë, pozita më aktive e KB dhe të faktorëve të tjerë ndërkombëtarë në Kosovë, krahasuar me intervenimet e mëhershme kur qëllimi ishte të ndahen palët në konflikt dhe

për të krijuar kushte për dialog dhe negociata, mund të ketë efekte pozitive jo vetëm në kuptimin e parandalimit të konflikteve të reja, por po ashtu edhe në krijimin e parakushteve për zgjidhjen e krizës dhe për të krijuar model të ri të stabilitetit. Sidoqoftë, nuk mund të presim që misioni i KB në Kosovë që thjesht të eliminojë matricat elementare të konfliktin ndëretnik, që do të thotë, që ai mund të luajë rolin e një pale pajtuese dhe të promovuesit e një lloji të ri të bashkësisë multietnike, ku bashkësitë e ndryshme etnike do të mund të jetonin në harmoni. Ky është vetëm iluzion i intervenzionistëve dhe misionarëve, kryesisht me efekte kontraproduktive, siç dëshmon përvoja nga Bosnja, e cila gjithnjë dëshpron misionarët sepse në zgjedhjet e saj fitues përherë janë partitë nacionaliste.

Për misionin e KB në Kosovë, sikur në Bosnjë, kujtoj se rruga më produktive është varianti i skepticizmit dhe qëndrimi pragmatik ndaj çështjes së aspiratave të konfrontuara. Pozicionin më aktiv të protektoratit KB do të duhej ta shfrytëzonte për ndërtimin e parakushteve sistimore politike, sociale dhe ekonomike për demokratizimin e njëmendtë të Kosovës dhe regjionit. Vërtet, ky rol më aktiv do të jetë dukshëm më i lehtë nëse në ndërkohë palët në konflikt arrijnë ndonjë marrëveshje, ose nëse Fuqitë e Mëdha apo Këshilli i Sigurimit ia del të zgjidhë nyjen gordiane mbi çështjen e sovranitetit në Kosovë, e formuluar si kompromis në Rezolutën 1244: Kosova formalisht është lënë nën sovranitetin e Jugosllavisë, por në praktikë të gjitha funksionin e sovranitetit iu janë dhënë UNMIK-ut. Në ndërkohë, nëse RF e Jugosllavisë shpërbëhet, pas referendumit për pavarësi në Mal të Zi, Këshilli i Sigurimit i KB duhet të tërheq konsekuenca logjike, që UNMIK-u të jetë i vetmi sovran i përkohshëm në Kosovë, dhe se nuk ka instancë shtetërore, subjekt i të të drejtës ndërkombëtare, dhe anëtare e KB, që të mund të aspironte sovranitetin mbi Kosovën. Çështja e Kosovës në atë rast do të duhej të zgjidhej mbi parimin e të drejtës themelore për vetëvendosje të një territori që është nën protektoratit e bashkësisë ndërkombëtare.

[Artikulli është pjesë e publikimit (kapitulli IX): *New States, Old Problems, Innovative Solutions: The Case of the Successor States of the Former Yugoslavia* e botuar në kuadër të "Rebuilding Fractured Communities" serie, UNDP, MDGD, 2001 New York. Ribotohet me lejen e UNDP]

Burimet e cituara

Agani - Fehmi Agani, *Pavarësia: gjasa dhe shpresa*, Dukagjini, Pejë, 1999.

Borba - *Borba*, 13 mart 1992.

Clark 1999 - Howard Clarc "Prospects for peace in Kosova" , in *The Nonviolent Activist*, January / February 1999; quoted from the Internet Web site.

Clark 2000 - Howard Clarc, *Civil Resistance in Kosova*, Pluto Press, London 2000.

Hamzaj - Bardh Hamzaj, *Rrëfimi për luftën dhe lirinë: Dialog me komandantin Ramush Haradinaj*, Zëri, Prishtinë 1999

Judah - Tim Judah, *Kosova, War and Revenge*, Yale University Press, New Haven and London, 2000

Kelmendi 1998 - Muhamed Kelmendi, *Realiteti dhe perspektivat e çështjes kombëtare*, Albin, Tirana, 1998

Kelmendi 1993 - Nekibe Kelmendi, *Kosova under the Burden of the Serbian deicriminatory Laws: Facts and Evidence* - KMLDNJ, Pristhina, 1993.

Kostovicova - Denisa Kostovicova, *Parallel Worlds: Response of Kosova Albanians to Loss of Autonomy in Serbia*, 1986-1996, Keele European Research Centre, 1997.

Kraja - Mehmet Kraja, *Vitet e humbura*, Tirana 1995

Magas 1993, Branka Magas, *The Destruction of Yugoslavia*, Verso London, 1993

Magas 1999 - *Rat u Hrvatskoj i Bosni i Herecegovini 1991-1995*, edited by Branka magas and Ivo Zanic, Dani, Zagreb - Sarajevo, 1999,

Maliqi 1989 - Sh.Maliqi, "Kosova kao katalizator jugoslovsne krize", in: *Zbornik Kosova-Srbija-Jugoslavija*, edited by. S. Gaber, T.Kuzmanic, KRT, Ljubljana 1989

Maliqi 1997 - Sh.Maliqi, "The Albanian Movement in Kosova,

in *Yugoslavia and After: A Study in Fragmentation, Desapair and Rebirth*, edited by David A.Dyker and Ivan Vejvoda, Longman, London and New York 1997

Maliqi 1993 - Sh.Maliqi, *Albansko gandhijevstvo na Kosovu*, Zalozba Wieser, Celovec-Salzburg, 1993

Maliqi 1990 - Sh.Maliqi, *Nyja e Kosovës: As Vllasi as Milosheviqi*, Lubljana, Krt, 1990

Maliqi 1998 - Sh.Maliqi, *Separate Worlds: Reflections and Analyses 1989-1998*, Dukahjini & MM, Prishtina 1998

Mesic - Stjepan Mesic, "Put u rat" in *Rat u Hrvatskoj i Bosni i Herecegovini 1991-1995*, ed. by B.Magas & I.Zanic, Dani, Zagreb - Sarajevo, 1999

Perovic - Latinka Perovic, *Ljudi, dogadjaji i knjige*, Helsinski odbor za ljudska prav u Srbiji, Beograd, 2000.

Pesic - Vesna Pesic, "Rat za nacionalne drzave", in *Srpska strana rata: trauma i katarza u istorijskom pamcenju* / edited by N. Popov, Beograd 1996

Petrovic 1995 - M.Petrovic, *Pitao sam Albance...*, Beograd, B92, 1995

Popovic 1997 - Nebojsa Popov, *Srpski populizam*, Republika, 1997

Popovic 2000 - Srdja Popovic, *Put u varvarstvo*, Helsinski odbor za ljudska prava u Srbiji, Beograd 2000.

Qosja 1998- R.Qosja, "Çështja shqiptare dhe shpërbërja e Jugosllavisë", in *Çështja kombëtare dhe vetëdija kritike*, FISH, Prishtinë 1998

Qosja 1994 - Rexhep Qosja, *Çështja shqiptare: Historia dhe Politika*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 1994

Qosja 1998 - Rexhep Qosja, *Strategjia e bashkimit shqiptar*, Toena, Tirana, 1998.

Rilindja - *Rilindja*, Pristina, 26 juna 1990

Rugova 1994 - Ibrahim Rugova: *Çështja e Kosovës: bisedë me*

Marie-Francoise Allain & Xavier Galmiche., Dukagjini Pejë
1994

Schwartz - Stephen Schwartz, *Kosova: Background to a war*,
Anthem Press, London 2000

The Kosova report - *The Kosova Report: Conflict, International
Response, Lessons Learned* - The Independent International
Commission on Kosova, Oxford University Press, 2000

Vujacic - Veljko Vujacic, Serbian Nationalism, Slobodan
Milosevic and the Origins of the Yugoslav War / *The Harriman
Review*, Vol.8, No.4, December 1995

Zeri, 17.12.1993..

ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË ZHVILLIMIN E KOSOVËS SË ARDHSHME

Hyrje

Që nga përfundimi i bombardimit dhe hyrjes së trupave të KFOR-it, Kosova de facto paraqet një protektorat të hapur ndërkombëtar. Derisa pasojat e luftës së Kosovës do të ndihen për një kohë të gjatë brenda vetë Kosovës, në rajonin e Ballkanit dhe madje më gjerë, mendohet gjithashtu se konflikti i Kosovës do të shënojë krijimin e "një Evrope" si shoqëri ndërkombëtare civile, në të cilën politika ndërkombëtare nuk do të jetë e ndërtuar në kuptim të luftës, por në kuptim të paqes, prosperitetit, bashkëpunimit rajonal dhe demokracisë. Në këtë kontekst, bashkësia ndërkombëtare e ka bërë të qartë që nga fillimi se vetëm një shoqëri e gjallë dhe diverse civile në Kosovë paraqet një parakusht dhe mund të garantojë krijimin e një demokracie pluraliste dhe pjesëmarrëse në vend. Pos kësaj, promovimi i shoqërisë civile duhet të jetë pjesë qendrore e çfarëdo politike zhvillimore në Kosovë, nga që është gati e pamundshme të bëhen ndryshime pa angazhimin e popullit në fjalë. Për më tepër, duhet vënë në pah se shoqëria civile në Kosovë ka nevojë të definohet në kuptim më të gjerë që përfshinë një spektër të gjerë të aktorëve, nga sindikatat, deri tek organizatat e bujqve dhe te gruas, OJQ-të vendore, grupet brenda komuniteteve dhe gjeneratën e re. Në këtë kuptim, OJQ-të janë pjesë e shoqërisë civile dhe, kështu jo përfaqësues të saj. Duke marrë tërë këtë parasysh, ky punim do të përpiqet të merret me parakushtet e domosdoshme për arritjen e një shoqërie dinamike dhe të shumëllojshme civile, si dhe me rolin që një shoqëri e tillë civile duhet të lozë në zhvillimin e ardhmërisë së Kosovës. Duke bërë këtë, theks i veçantë do t'i kushtohet rëndësisë së qasjes rajonale në trajtimin e çështjeve zhvillimore në përgjithësi dhe atyre që kanë të bëjnë me rindërtimin dhe refugjatët, në veçanti.

GJENDJA E TANISHME DHE PËRPARËSITË E QASJES RAJONALE

Në Kosovë ende ndihet nevoja për ndërtimin e kapacitetit të organizatave rajonale, sektorale dhe lokale për të përmirësuar disa nga burimet e mundshme të konflikteve të trashëguara në tendosjet etnike, shijen e hidhur nga lufta dhe hendekun mes atyre që kanë qëndruar gjatë luftës dhe të kthyerëve. Megjithëkëtë, duhet të jemi të vetëdijshëm se zhvillimi i një shoqërie të pavarur dhe vetëpërmbytëse civile në Kosovë ballafaqohet me pengesa të mëdha, jo gjithaq nga përçarjet e thella etnike të shkaktuara nga lufta, sa edhe nga acarimi i vijave ndarëse për shkak të fijeve të ndryshme të nacionalizmit dhe të interesave rajonale pushtetare. Andaj, një nga sfidat më të mëdha ka qenë kombinimi i objektivave të pajtimit dhe të paqes, të rindërtimit ekonomik e reformës dhe të ndërtimit të shoqërisë civile me një sistem demokratik të qeverisjes. Mbase për këtë arsye, gjendja pas konfliktit në Kosovë karakterizohet ende nga forcat dhe institucionet e padefinuara për një funksionim normal të shoqërisë demokratike.

Përkundër shpejtësisë impesive të kthimit të popullsisë kosovare dhe të entuziazmit të dëshmuar në çastin imediat të tërheqjes së trupave serbe, zbrastësia e strukturave institucionale dhe sforsimi i ligjit dhe rendit ende është duke prodhuar një gjendje konfuzioni në mesin e shumë kosovarëve. Duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të merremi me faktin se nën kushtet ku informacioni është i mangët dhe aty ku shregullimet civile paraqesin qeverisje të dobët, rrjetat e brendshme dhe të jashtme të shoqërisë civile në mesin e grupeve të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile janë dëshmuar si të pandashme.¹

Në situata pas konfliktuozë, si kjo në Kosovë, ku autoritetet publike dhe ndërmarrjet private rindërtojnë qeverinë dhe tre-

i) Agon Demjaha dhe Lulzim Peci, "Zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë në gjendjen pas konfliktit", kapitull i paraqitur për botim në një libër të botuar mbi zhvillimin e shoqërisë civile në Evropën Juglindore, fq. 2.

gun, OJQ-të lozin rol kyç në ndërtimin e besimit dhe të mirëbesimit, nga që ato janë në gjendje të reflektojnë interesat e ndërsjella të qytetarëve përtej vijave ndarëse të krijuara nga konflikti.

Megjithëkëtë, "ndërkombëtarizimi" i konfliktit në Kosovë nuk duhet të sjellë patjetër deri te konkludimi se për zgjidhje kërkohet ilaç ndërkombëtar. Paradoksi i pranisë ndërkombëtare është se derisa bashkësia ndërkombëtare synon të ndihmojë në krijimin e organizatave të reja, një pjesë e mirë e talentit dhe e liderëve potencialë të OJQ-ve po orinetohet drejt pozicioneve joharmonike me organizatat ndërkombëtare.ⁱⁱ Kjo bllokon aftësinë, përndryshe të natyrshme, të ndërtimit të OSHC-ve (dhe të shoqërisë kosovare) në një gjendje të karakterizuar nga një mungesë mundësish të punësimit dhe mungese të ndërmarrjeve vendore. Pos kësaj, bashkësia ndërkombëtare nuk është gjithmonë e vetëdijshme se çdo futje e fondeve mund të çrregullojë aktorët e shoqërisë civile, mund të krijojë varësi dhe transferim të raporteve të pushtetit brenda shoqërisë civile në Kosovë. Kështu, promovimi i shoqërisë civile në Kosovë kërkon një identifikim të qartë të atyre grupeve dhe forcave që duhet mbështetur, në mënyrë që të lindë një shoqëri e shëndoshë civile. Besimi duhet të vëhet në strukturat ndërmjetëse vetëqeverisëse, nëse bashkësia ndërkombëtare dëshiron të ketë një ndikim afatgjatë në ndërtimin e paqes dhe të demokracisë. Madje edhe ndihma e drejtpërdrejtë humanitare ka pasur efekte të njohura stërngarkimi në aftësinë për të tërhequr mundësinë në zhvillimin kombëtar.ⁱⁱⁱ Ky rezonim e bën urgjente çështjen e bashkëpunimit mes organizatave ndërkombëtare, ngaqë vetëm përmes një bashkëpunimi efektiv është i mundur zhvillimi i një shoqërie civile vetëpërmbytëse dhe të pavarur në Kosovë në veçanti dhe në rajon në përgjithësi.

Nga ana tjetër, siç është përcaktuar tashmë në kornizën themelore të Paktit të Stabilitetit, vetëm bashkëpunimi rajonal i mbështetur në barazi, respektimin e të drejtave të njeriut dhe

ii) Ibid., fq. 2.

iii) Ibid., fq. 3.

prosperitetin e ndërsjellë ofron garancë për prosperitetin e vendeve të Evropës Juglindore. Dhe, kjo është vendosur pasi që ishte e qartë se përfitimet nga ndjekja e qasjes rajonale ishin me më peshë nga një varg strategjishë të vendeve të veçanta. Ndër të tjera, qasja rajonale favorizon bashkëpunimin ndërkulturor, ndëretnik dhe ndërkufitar; ajo madje ofron një vizion gjithëpërfshirës të përgjithshëm të situatës duke i mundësuar, në ndërkohë, bashkësisë ndërkombëtare të ofrojë mbështetje në mënyrë efektive dhe brenda një afati sa më të shkurtër kohor. Së fundi, qasja rajonale respekton shumëllojshmërinë e kulturës, etnicitetit, gjuhës dhe religjionit si brenda rajonit ashtu dhe brenda vendeve në fjalë dhe kështu forcon këmbimin ndërkulturor, arsimin joformal, mirëkuptimin paqesor dhe njerëzor.^{iv} Prandaj, vetëm përmes kësaj qasjeje mund të tejkalohen pasojat e konfliktit përmes rindërtimit pas-konfliktuoz të konczensusit, përmes zgjidhjes së konfliktit dhe me ndriçimin e barrës psikologjike të pasojës së luftës.

3. ROLI I SHOQËRISË CIVILE

Gjatë analizimit të rolit të shoqërisë civile në zhvillimin e Kosovës së ardhshme duhet ditur se idetë dhe konceptet e saj kanë rëndësi teorike dhe praktike. Si rezultat i ndërlidhjes me realitetin e përgjithshëm shoqëror në Kosovë, shoqëria civile do të mund të sillte zgjidhje produktive për problemet që dalin nga ndryshimi prej shoqërisë totalitare në atë demokratike. Pasi që, duhet ditur se në Kosovë, si në shumë vende të tjera të rajonit, transformimi nga shoqëria totalitare në atë demokratike është ende jo i plotë. Për fat të keq, institucionet e shoqërisë civile nuk kanë formën e domosdoshme për zhvillim intensiv, e as që ka decentralizim të mjaftueshëm vertikal të pushtetit ndaj vetëqeverisjes lokale. Së fundi, shumë shpesh ka një prirje nga ana e strukturave qeveritare për të rezervuar

iv) "Balkan Children and Youth Initiative," punim conceptual i përgatitur nga International Youth Foundation, Baltimore, fq. 3, gusht, 2000.

të drejtën për kontroll dhe menaxhim të të gjitha iniciativave civile dhe aktiviteteve vetëkontribuese, që nga ana tjetër pengon zhvillimin e OJQ-ve dhe shprehjen e plotë të funksioneve të tyre të mundshme.^v

Për më tepër, duhet ditur se për shkak të lidhjeve të saj të ngushta bazike, shoqëria civile mund t'i arrijë lehtë grupet e synuara të paprivileguara nën nivelin shtetëror që do t'i mundësojë asaj të japë kontribut të rëndësishëm në promovimin e procesit të formësimit të opinionit dhe të arritjes së vendimeve në mënyrë demokratike. Në të njëjtën kohë, shoqëria civile mund të promovojë procesin e formësimit të opinioneve politike dhe marrjen e vendimeve brenda popullsisë dhe mund të monitorojë dhe mbështesë zbatimin e reformave në tërë vendin. Në një vend si Kosova, ky pa dyshim është një funksion shumë i rëndësishëm në fushën jetike të pajtimit pas-konfliktuoz dhe ndërtimin e besimit. Së fundi, në Kosovë, si dhe në vendet e tjera postkomuniste, shoqëria civile shpesh shikohet si një alternativë ndaj socializmit dhe totalitarizmit, të karakterizuar me centralizëm ekonomik, sistem politik njëpartiak dhe pushtet absolut. Megjithëkëtë, duhet pasur kujdes për të mos ideologjizuar shoqërinë civile, pasi që në një rast të tillë ajo mund të bëhet lehtë burim iluzionesh shoqërore dhe të rrezikojë mundësitë për arritjen e shoqërisë së vërtetë demokratike.

Megjithëkëtë, duhet të jetë e qartë se, pa dyshim, kjo nuk mund të arrihet vetëm me përpjekjet e shoqërisë civile. Vetëm një dialog tresektorial dhe bashkëpunimi mes qeverisë, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile mund të japë kontribut të qëndrueshëm në ndërtimin e një ambienti të ri ekonomik, shoqëror dhe ekologjik në rajon. Nëse e njohim faktin se biznesi është makina kryesore për rritje, zhvillim, krijim të pasurisë dhe të vendeve të punës; se, nga ana tjetër, qeveritë mund t'i kontribuojnë krijimit dhe ndërtimit të një ambienti të aftë për rritje dhe zhvillim; dhe së fundi, se shoqëria civile shpesh kuptohet nga refugjatët, të kthyerit dhe madje nga qyte-

^v) "Evropa Qendrore shikuar nga perspektiva e një kombi të ri – formimi i shoqërisë civile", fjalim i Presidentit të Republikës Sllovaqe, Mihal Kovač, fq. 4, Tokio, 10 shkurt, 1998.

tarët e rëndomtë, si më e besueshme dhe më afër preokupimeve të tyre, atëherë është e qartë se për ndërtimin e suksesshëm të Kosovës pas konfliktit është esenciale të bashkohen të gjithë këta tre sektorë dhe të ndërtohet mbi njohuritë e tyre gjegjëse.^{vi} Në këtë kontekst, është esenciale të krijohet një baraspeshë mes qeverisë, administratës së saj dhe organizatave të shoqërisë civile. Një ndërlidhje duhet krijuar që kalon nga rivaliteti klasik në etapën demokratike të plotësimit të ndërsjellë dhe koekzistencën prosperuese të përbashkët. Qeveria duhet të ofrojë kushtet e nevojshme për funksionimin e pafrenuar të shoqërisë civile dhe duke bërë këtë, ajo duhet të heq dorë nga shumë prej autorizimeve të ashtuquajtura "sovrane" ndaj organizatave të shoqërisë civile. Organizatat e shoqërisë civile duhet të lejohen të veprojnë në ato fusha ku qeveria nuk është në gjendje të veprojë në mënyrë efektive.^{vii} Sot në Kosovë, nën kushtet që i përshkruam, të një qeverie jo të përkryer, kjo çështje ka një rëndësi kyçe.

Pos kësaj, qeveria duhet t'u përcaktojë organizatave të shoqërisë civile një vend të caktuar në mënyrë që të sigurojë që ato të jenë të informuara me kohë dhe të angazhohen në rezultatet e negociatave sa u përket vendimeve të rëndësishme dhe reformave. Në praktikë, kjo do të thotë se një dialog i strukturuar duhet të vendoset mes qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile, duke u mundësuar atyre kështu të japin kontributin e vet në zhvillimet politike. Për më tepër, për të qenë vërtetë demokratike, përfaqësuesit e qeverisë duhet të bëjnë përpjekje maksimale për të ndikuar në decentralizimin vertikal dhe horizontal të pushtetit politik, duke ndërtuar mekanizma të tillë politikë që do të hapin mundësi të reja dhe do të ofrojnë gjasa të barabarta për ekzistimin dhe lindjen e organizatave të reja të shoqërisë civile. Duke pasur parasysh se aktualisht Kosova është nën administrim ndërkombëtar, kjo në të vërtetë do të paraqiste mënyrën më të mirë për të siguruar tranzicion të pronësisë nga aktorët ndërkombëtarë në ata

vi) "Balkan Children and Youth Initiative," fq. 5.

vii) "Evropa Qendrore shikuar nga perspektiva e një kombi të ri – formimi i shoqërisë civile", fq. 4.

vendorë, duke mundësuar kështu pushtetëzimin e plotë të kosovarëve. Nga ana tjetër, një shoqëri e themeluar si duhet dhe funksionale civile në Kosovë do të shërbejë për forcimin e regjimit politik demokratik dhe të demokracisë pluraliste.

Duhet vënë në pah se e tëra që u tha më lart vlenë edhe për përpjekjet e rindërtimit dhe çështjen e refugjatëve. Së fundi, është duke u bërë gjithnjë e më e qartë se ka një lidhje mes prosperitetit ekonomik dhe forcës së jetës civile. Vetëm komunitetet ekonomisht vitale posedojnë institucione që mundësojnë dhe inkurajojnë kushte të nevojshme për rimëkëmbjen ekonomike, duke mundësuar kështu shfrytëzimin efikas të resurseve ekonomike dhe mundësinë për të kultivuar dhe për t'iu përshtatur kushteve të ndryshuara ekonomike. Sot në Kosovë, ka një sfidë monumentale për shoqërinë civile për t'u marrë me problemet e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, përfshirë integrimin e të rinjve në jetën dhe punën e rregullt të përditshme. Asnjë përpjekje rindërtimi nuk mund të jetë e suksesshme, nëse nuk është e kombinuar me mobilizimin e rrjeteve dhe shoqatave profesionale, të cilat më vonë do të evoluojnë në ndërtimin e ekspertizës shoqërore dhe ekonomike për zhvillimin e mundësive të punësimit, mbështetur në një sistem më të gjerë të nismave të ndërmarrësisë.^{viii}

Një çështje tjetër kyçe është kthimi i një numri akoma të madh të refugjatëve nga vende të tjera evropiane dhe riintegrimi i tyre në shoqërinë kosovare. Është imperative që të kanalizohen resurset në shoqërinë civile edhe në organizatat e saj, për të plotësuar riaktivizimin e përnjëhershëm të të kthyerëve në jetën shoqërore dhe ekonomike. Kjo do t'i kundërvëhet pasojave të barrës së dyfishtë të humbjes së mbështetjes për refugjatët në vendet e tyre të banimit të përkohshëm dhe tensionin e vënë mbi gjendjen depresive sociale dhe ekonomike me t'u kthyer. Pos kësaj, ka një nevojë për një koordinim më të ngushtë mes organizatave që punojnë në Kosovë dhe vendeve nikoqire të refugjatëve kosovarë për t'i ikur shtimit të numrit të të kthyerëve mbi masën e

viii) Agon Demjaha dhe Lulzim Peci, fq. 6.

mundësive reale të reintegrimit të tyre në Kosovë.^{ix} Në këtë kontekst, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertiza e tyre mund të shfrytëzohen në ofrimin e trainimit të mëtejshëm për të kthyerit, duke sjellë kështu reintegrimin e tyre në shoqërinë kosovare.

PËRMBYLLJE

Mund të konkludohet se shoqëria dinamike dhe vetëpërmbytëse civile paraqet një nga parakushtet kyçe për demokratizim të Kosovës. Në këtë kontekst, rëndësia e shoqërisë civile qëndron në entuziazmin, dinamizmin, shumësinë e ideve dhe në energjinë ekzistuese të organizatave të saj. Pos kësaj, në Kosovë, si dhe në mbarë rajonin, vetëm një shoqëri e zhvilluar civile mund të presupozojë dhe të sigurojë përgjegjësi nga ana e qeverisë. Për më tepër, është e qartë se gjatë procesit zhvillimor në Kosovë vetëm përkushtimi ndaj shoqërisë civile mund të çojë drejt tranzicionit të pronësisë nga aktorët ndërkombëtarë në ata vendorë, duke siguruar kështu pushtetëzimin e plotë të kosovarëve. Megjithatë, duhet ditur se vetëm shoqëria civile nuk mund të garantojë një të ardhme prosperuese demokratike për Kosovën. Por, është ndërtimi i një baraspeshe stabile mes qeverisë, administratës së saj, sektorit të biznesit dhe shoqërisë civile ajo që është parakusht kyç për plotësimin me sukses të procesit të demokratizimit në Kosovë.

^{ix}) Ibid, fq. 3.

FUQIZIMI I RINISË BALLKANIKE DHE INTEGRIMET EVRO-ATLANTIKE

Mbarimi i Luftës së Ftohtë u solli qeverive perëndimore një rast të papritur për të marrë vendime të padetyrueshme mbi të ardhmen e institucioneve të tyre, gjegjësisht NATO-n dhe BE-në, mbi rolet dhe misionet e tyre të reja dhe mbi mundësinë e hapjes së anëtarësimit të vendeve, që më parë ishin kundërshtare.

Për më tepër, prospekti i zgjerimit në Evropën Qendrore dhe Lindore i dha cytje shlyerjes së vijave shtuese të ndarjes, që ishin trashëgimi e "balancit të politikës së forcës" të së kaluarës, me të cilën ballafaqohej e tërë Evropa deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore. Kjo po i largon shtetet e rajonit nga konfrontimi dhe politika luftënxitëse drejt bashkëpunimit dhe integritimit në institucionet Evro-Atlantike. Rezultatet e politikës së zgjerimit janë evidente; pos luftës në ish-Jugosllavi, pjesët e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore po kalojnë në mënyrë paqesore tranzicionin drejt demokracive të tregut.

Mirëpo, ngjarjet tragjike të dekadës së fundit, të cilat për fat të keq po vazhdojnë ende në ish-Jugosllavi, paraqesin një pengesë të madhe drejt krijimit të kushteve për prosperitet në Ballkan. Si rrjedhojë, kjo ndikon në perspektivat e rinisë së Ballkanit për një jetë më të mirë dhe për kontributin e tyre në transformimin e shoqërive të tyre në aso demokratike. Në këtë aspekt, fuqizimi i rinisë së Ballkanit do të mund të ishte një nga çështjet kyçe në krijimin e shoqërive demokratike dhe të shëndosha në rajon.

Megjithëkëtë, në gjendjen e tanishme ndihet një nevojë për hulumtimin e disa prej rrugëve drejt pushtetëzimit të rinisë së Ballkanit, jo vetëm në aspektin rajonal, por edhe në një aspekt më të gjerë; atë evropian dhe global.

Por, me rastin e hulumtimit të mënyrave të fuqizimit (pushtetëzimit), së pari duhet analizuar zhvillimet ekonomike dhe politike, të cilat kanë ndikim në rininë e Ballkanit në dy faqe të fytirës evropiane: në Ballkan dhe në Evropën Perëndimore.

Situata në Ballkan mbetet akoma shumë e keqe, madje edhe në krahasim me Evropën Qendrore dhe Lindore, e cila po hyn në fazën e fundit të tranzicionit në një rend të plotë neo-liberal. Në këto vende, respektivisht në Republikën Çeke, Hungari, Poloni, Slloveni dhe Sllovaki, infrastruktura e domosdoshme është ndërtuar, e mbështetur nga ndihma e gjerë nga vendet perëndimore për ndryshime drejt ekonomisë së tregut dhe investimeve të mëdha.

Por, në Ballkan, pos trashëgimisë së Luftës së Ftohtë, lufta në ish-Jugosllavi ka dërrmuar ekonominë në rajon. Ka një disparitet të thellë në zhvillimin ekonomik të rajonit (shih Tabelën 1), duke filluar nga veriu relativisht i zhvilluar, respektivisht Sllovenia dhe Hungaria; zonën e mesme të ish-Jugosllavisë së shkatërruar dhe të dërrmuar, ngecjen e Rumanisë në reforma me rizgjedhjen e Ilieskut, Bullgarinë duke kaluar që në fillim të reformave të thella dhe Shqipërinë e varfëruar; kurse në jug, Greqinë, si vendi më i zhvilluar në rajon. Ky disparitet në zhvillimin ekonomik paraqet një pasiguri latente dhe jostabilitet në Ballkan.

Për më tepër, gjendja politike në shumicën e vendeve të rajonit është larg nga të qenit stabile. Strukturat e pareformuara dhe të brishta shtetëtoje, të shoqëruara me dhunën që ende është e pranishme në rajon, janë sfidat më të mëdha që kanë të bëjnë me transformimin e këtyre shoqërive në shoqëri demokratike.

Tabela 1¹

Shteti	Popullsia	GDP per capita (\$)	GDP Shtimi (%)	Borxh i Jashtëm \$ milionë
Shqipëria	3.000.000	810	-	706
Bosnia	2.000.000	1490	-	-
Bullgaria	8.000.000	1230	-	9.858
Kroacia	5.000.000	4520	-	6.842
Greqia	11.000.000	11650	3,7	-
Kosova ²	2.000.000	500	-	-
Maqedonia	2.000.000	1290	2,9	1.542
Rumania	23.000.000	1390	-5,6	10.442
Sllovenia	2.000.000	13900	3,6	-
Serb.&Mali i Zi	9.000.000	1380	-	15307
Turqia	63.000.000	3160	-	91205

Por, në esencë, shtetet e rajonit vuajnë nga probleme të ngjashme: sektorë relativisht të gjerë bujqësorë, kapacitetet të tepërta dhe të shkatërruara industriale, një tepricë e punës dhe infrastrukturë të kalbur. Jo që ato nuk kanë se çfarë t'i ofrojnë njëra-tjetrës, por ato aktualisht bëjnë garë me njëra-tjetrën për fonde të njëjta nga Perëndimi. Kështu, mund të konkludojmë se është vështirë të paramendohet se rajoni do të mëkëmbet pa ndihmë të besueshme dhe mbështetje nga Perëndimi.

Megjithëkëtë, angazhimi aktual ndërkombëtar në Ballkan paraqet një mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin dhe integrimin e rajonit në Perëndim. Por, vetëm prania nuk mjafton, nga që nëse nuk ka vizion, kjo do të çonte në mundësi të humbura.

Cilat janë perspektivat e rinisë së Ballkanit në këtë situatë? Për më tepër, do të doja të ngreja një pyetje: kush janë ata?

Do të përpiqem të japë një përgjigje të shkurtër, e cila jam i sigurt se nuk është e plotë. Brezi i tanishëm i rinisë së Ballkanit është një brez, që është rritur i ballafaquar me krime lufte dhe dhunë, madje edhe duke e bartur atë në shpatullat e veta. Por, ky brez i rinisë së Ballkanit është po ashtu brez i liderëve të rinj të rajonit, që pa dyshim do të bëhet pjesë e NATO-së dhe BE-së.

1) Burimi: Indicadores Socioeconomicos de los países del mundo (1998), "ABC", Madrid, Dec.31.2000

2) Të dhënat janë të përafërta

Nga ana tjetër, të gjitha qeveritë e rajonit e kanë të qartë se as lufta dhe as izolimi nuk shpaguhen. Ato janë të gatshme të integrohen në institucionet Evro-Atlantike dhe ishin të gatshme të paguanin çdo çmim sikur prospektet e tilla të ishin realiste, siç u demonstroi gjatë krizës së Kosovës.

Por, pa shoqëri demokratike, ekonomi të tregut dhe stabilitet të brendshëm, shtetet e Ballkanit nuk mund të bëhen anëtare të institucioneve euro - atlantike. Rindërtimi i rajonit duhet të ketë parasysh gjithashtu edhe zhvillimet e brendshme - ai duhet të fillojë nga brenda vetë populli, të bindur se kjo është në interesin e tyre dhe jo nga liderët që janë të gatshëm të imitojnë format perëndimore, por me fare pak substancë. Pakthyeshmëria e ndryshimeve në kohën para vitit 1989, duhet të arrihet nga të gjitha shtetet para se të pranohen në institucionet Evro-Atlantike. Fuqizimi i rinisë, mes të tjerash, do të mund të ishte një çytje e rëndësishme e arritjes së këtij qëllimi.

Në këtë aspekt, së pari duhet të njohim faktin se përmes Internetit dhe Tv satelitor, bota është afruar shumë, duke krijuar kështu mundësi lidhshmërie midis Perëndimit dhe Ballkanit, por në të njëjtën kohë duke krijuar pritje të reja për rininë në rajon.

Nga ana tjetër, Perëndimi shumë i zhvilluar po i prinë procesit të globalizimit, që pa dyshim sjell mundësi të reja, por edhe konkurrencë shumë të lartë brenda tregut global. Në këtë aspekt, sidomos shtetet evropiane shprehin ndjenja transnacionale dhe globalizimin e shoqërisë, në veçanti të rinisë. 93% e studentëve gjermanë flasin anglisht mjaft mirë për të mundur të zhvillojnë konversation, 45% mund ta bëjnë këtë me frengjisht, të mos flasim për mundësitë kualifikuese për tregun global që po lindë. Për më tepër, në programet e këmbimit të jashtëm, Suedia i prinë listës: 32% e studentëve të saj kanë studiuar jashtë, pasuar me 17% të gjermanëve, 16% të britanikëve, 11% të francezëve dhe 6% të spanjollëve.³

Duke pasur parasysh këto fakte, është e qartë së motivimi i rinisë së Ballkanit dhe realizimi i pritjeve të tyre, mund të gjen-

3) Burimi: Stephan Dahl, Communication and Culture Transformation, 1998 <http://www.stephweb.com/capstone/capstone.shtml>

den përmes krijimit të vendeve të punës dhe ofrimit të mundësive për t'u bërë pjesë konkurruese e tregut global të BE-së.

1						
2						
3						
4						
5						

Fig. 1. Trendet e Globalizimit⁴

Mirëpo, në anën tjetër procesi i globalizimit nuk është një proces i thjeshtë linear. Zhvillimi teknologjik është larg duke udhëhequr në proces, së bashku me zhvillimin ekonomik. Zhvillimi shoqëror (apo transformimi) është i ngadalshëm në krahasim me zhvillimin teknologjik. Por, nuk ka dyshim se zhvillimet e fundit teknologjike dhe ekonomike i kanë shkaktuar zhvillimet më të shpejta në historinë e njerëzimit.

Këtu hyn roli i bashkësisë ndërkombëtare. Rinisë së rajonit duhet ofruar një sërë mundësishë në arsim dhe kualifikim nga ana e Perëndimit. Të përmendim vetëm ndikimin mbi zhvillimin ekonomik dhe demokratizimin e shoqërive që arsimimi në Perëndim ka pasur për vendet tani të zhvilluara të Lindjes së Largët. Mendoj se kjo është shkalla më e lehtë dhe më pak e kushtueshme në transformimin e shoqërive të Ballkanit dhe forcimin e tyre, në planin e afërt.

Por, këto përpjekje do të jenë të pamjaftueshme pa kuptuar zhvillimet në shoqëritë e rajonit. Sipas mendimit tim, është esenciale që të dy palët, ndërkombëtarët dhe vendorët, të kuptojnë ndikimin fundamental që mund të ketë ndryshimi në ambientin politik dhe ekonomik mbi strukturat shoqërore dhe vlerat e shoqërisë, që në asnjë etapë nuk bën të lihet mënjana. Ajo që ka ndodhur në Ballkan dhe në ish-Jugosllavi dhe ajo që është duke ndodhur në Perëndim, nuk mund të shiko-

4) Diagram i zhvilluar nga Center for Applied Studies in International Negotiations, 2001, Gjenevë 1. Zhvillimi Teknologjik, 2. Zhvillimi Ekonomik, 3. Zhvillimi Politik, 4. Zhvillimi Kulturor, 5. Zhvillimi Shoqëror

het nga ana e ndërkombëtarëve dhe e vendorëve si film tmerri apo trillim shkencor, që ndodhë në një botë të largët. Përmes njohjes së këtij fakti, në Ballkan mund të bëhet një kalim i madh drejt një vetë-njohjeje të re të shoqërisë. Në të vërtetë, që të gjithë ne, si ndërkombëtarët, ashtu dhe vendorët, janë duke ecur nëpër tefin e të mësuarit të jetës së përbashkët. Ky është hapi i parë i njohjes së ndërsjellë se ne jemi të gjithë një familje që ndanë vlerat e demokracisë së tregut dhe lirisë. Duhet të llogarisim se rinia e Ballkanit ka të drejtë t'i sjellë këto në jetë.

Por, në mënyrë që këto vlera të kenë kuptim dhe të kenë sukses në rajon, bashkë me ndihmën ekonomike, ndihet nevoja për pushtetëzimin e shoqërive dhe të rinisë si të tillë. Në këtë aspekt, forcimi deh fuqizimi i rinisë dhe krijimi i bashkëpunimit dhe këmbimit ndërkufitar brenda kësaj fushe do të ishte një nxitje e fuqishme drejt gjetjes së identiteteve rajonale dhe kombëtare. Iniciativat e reja ballkanike, të ndërtruara në bazë të demokracisë dhe lirisë, pa dyshim do të shënojnë zgjidhjet përfundimtare të epokës së pas Luftës së Ftohtë dhe të konfliktit jugosllav, që do të mundësojë hyrjen e plotë të rajonit në rrjedhat e integritimeve Evro-Atlantike.

Megjithëkëtë, transformimi dhe pushtetëzimi i shoqërive ballkanike dhe prospektet për pasurim dhe prosperitet mund të arrihen vetëm kur Perëndimi ta ketë të qartë se strategjia e vetme e daljes nga rajoni është angazhimi i duhur që duhet të jetë një strategji integruese, dhe kur shoqëritë e Ballkanit ta kenë të qartë se për t'u bërë pjesë e institucioneve perëndimore, respektimi i vlerave të demokracisë, tregut të lirë dhe lirisë nuk mjaftojnë - ato duhet të jenë vlerat tona të pakontestuar dhe pjesë e jetës sonë.

LIGJI SI THEMEL I SHOQËRISË CIVILE: RASTI I KOSOVË

Ligji vetvetiu nuk e krijon shoqërinë civile, sepse në të kundërtën, edhe ish-shoqëritë komuniste, vetëm nga ky fakt do të duhej të trajtoheshin si civile, ndërkohë që është e ditur se pikërisht këto forma totalitare të organizimit shoqëror kishin përjashtuar çdo veprim të lire të organizatave jo-qeveritare¹. Mirëpo, nga ana tjetër, as shoqëria civile nuk është shoqëri anarkike dhe jo-ligjore. Përkundrazi, pa ligj, ajo do të ishte kontradiksion i shoqërisë civile.

Vetëm shoqëria e tillë, e ngritur mbi parimin e ligjëshmërisë, pra ligjit si një arbitër neutral, objektiv dhe përgjithësisht i pranuar në shoqëri, (përballë çdo arbitri personal, të interesit dhe parciaisht, apo fare të papranueshëm nga shoqëria), mund të jetë shoqëri civile, brenda së cilës lejohet dhe garantohet: mendimi i lirë, shprehja e lirë e tij, liria e shtypit, e organizimit, tubimit, ku qytetarëve u garantohet juridikisht një mundësi e tillë që të bashkohen, jo vetëm në rrafshin qeveritar, por edhe në atë qytetar joformal. Me fjalë të tjera, shoqëria e organizuar dhe e ngritur mbi ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar është shoqëri që mund të pretendojë të jetë edhe shoqëri civile, në të cilën individit nuk është e thënë të organizohet vetëm në parti politike, por që me vizionet, projektet dhe angazhimet e veta mund të kontribuojë për këtë shoqëri edhe jashtë organizimit partiak e qeveritar. Qytetarit, pra, ligjërisht duhet t' i garantohet mundësia e një angazhimi joformal qytetar.

1) Mr. Blerim REKA: "Ligji dhe ndërtimi i shoqërisë civile në Kosovë", kumtesë në Seminarin e FKSHC për Shoqërinë Civile, Prishtinë, maj, 2000, faqe. 1

Kosova, në këtë trekëndësh: ligji – qytetari – shoqëria (civile), mbase është një rast sui generis në historinë juridike. Dhe, njëkohësisht paradoksal. Një territor, i cili historikisht kishte gëzuar një mvehtësi administrative, kishte kaluar nëpër sisteme të nduarnduarshme legjislative. Çdo pushtues i huaj këtu kishte aplikuar ligjin e vet, por njëkohësisht, banorët e Kosovës prej shekujsh kurrë nuk i kishin pranuar ato ligje si të vetat. Për shqiptarët e Kosovës, ligjet e regjimeve dhe të qeverive pushtuese ishin përjetuar si të huaja.² Dhe, kështu kishte qenë që nga antika: nga romakët, bizantinët, serbët dhe osmanët. Madje, thuhet se edhe vetë romakët u kishin lejuar ilirëve, zbatimin e rregullave të tyre të pashkruara, por me kusht që ato të mos ishin në kundërshtim me të drejtën romake.³ Prej atëherë e deri më sot, shqiptarët e Kosovës, e cila duke mos qenë shtet sovran dhe i pavarur dhe duke mos pasur kompetenca të mvehtësishme legjislative, kishin aplikuar të drejtën e vet zakonore, të njohur si Kanuni i Lekë Dukagjinit. Pos karakterit thjesht juridik, Kanuni i Lekë Dukagjinit, për shqiptarët në përgjithësi dhe për ata të Kosovës në veçanti, kishte edhe rëndësinë politike e kombëtare. Duke i zbatuar paragrafet e tij, shqiptarët kishin provuar të ruanin rregullat autoktone të rregullimit të marrëdhënieve shoqërore dhe të zgjidhnin kontestet që ndodhnin brenda shoqërisë shqiptare. Si pandan ndaj ligjit pushtues, Kanuni ishte zbatuar me shekuj, deri në ditët tona. Madje, ka autorë që mendojnë se në malësitë shqiptare, ligji i huaj as që ishte zbatuar ndonjëherë. Ky problem: zbatimi i Kanunit të Leke Dukagjinit dhe moszbatimi i ligjeve osmane, kishte dalë atëherë edhe para Parlamentit Osman, i cili me masat përcjellëse administrative kishte provuar – por pa sukses, të ndalonte zbatimin e tij. Që atëherë, pra, shqiptarët përmes të drejtës së tyre të pashkruar kishin mbrojtur rregullimin autokton të shoqërisë së tyre, kundruall rregullativës qeveritare të pushtuesit turk.

2) Mr. Blerim Reka: "Elements of Conflict Prevention & Resolution in Code of Lekë Dukagjini", Tetovë, 1997, faqe. 11

3) Leonard Fox: "Introduction: Code of Lekë Dukagjini", New York, 1989, pg. XVI

Në kuptimin e sotëm të fjalës, ndoshta dhe kjo iniciativë jo qeveritare shqiptare përballë pushtuesit të huaj "qeveritar", mund të merret si një pararendës i jo-qeveritares. Siç do të dëshmojë koha, as ky e as pushtuesit e mëparshëm dhe ata të mëvonshmit, nuk kishin arritur që shqiptarëve t'ua ndalonin zbatimin e ligjit të vet të pashkruar. Me fjalë të tjera, sado që në këtë territor ishin ndërruar pushtuesit e huaj dhe ligjet e tyre, shqiptarët kishin vazhduar të zbatojnë të drejtën e tyre të pashkruar, për rregullimin e raporteve të veta shoqërore. Durhami po edhe Vickers, madje jo pa arsye, e quanin të drejtën zakonore shqiptare: "kushtetutë të pashkruruar shqiptare". Jashtë kësaj historie të përgjithshme robëruese shqiptare shumëshekullore, as në Kosovë, përkundër sundimit serb gati një shekullor, shqiptarët kurrë nuk i kishin pranuar ligjet e Beogradit për ligje të shoqërisë së tyre. Kështu kishte qenë deri nga mesi i viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, kur me fitimin e statusit federal të Kosovës, ajo kishte fituar një gjysëm mvehtësie kushtetuese-ligjore. Për të parën herë në historinë e saj, Kosova kishte nxjerrë edhe kushtetutën e vet të shkruar dhe ligjet në fushat që binin nën jurisdiksionin e saj. Madje, (së bashku me Kroacinë), Kosova ishte atëherë e vetmja njësi federale e ish-federatës së fundit jugosllave, që kishte pasur kompetenca kushtetuese-juridike për të hyrë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për të ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare që i lidhnin përfaqësuesit e saj zyrtarë⁴.

Mirëpo, pas defederalizimit antikushtetues të Kosovës nga regjimi serb, në fund të tetëdhjetave, ajo humbi edhe atë gjysmë mvehtësie kushtetuese e legjislativë. Dhe pas këtij desovranizimi të Kosovës, ajo nuk do t'i kthehej sërish Kanunit të Lekë Dukagjinit, pra "ligjit të pashkruar", por rregullimit të marrëdhënieve të saj shoqërore (edhe nën pushtimin serb), me aktet vetanake kushtetuese dhe ligjore. Kësaj radhe, pandan ligjit të huaj pushtues serb, do të jetë, jo e drejta e pashkruar, si nën pushtimin otoman, por Kushtetuta dhe ligji i shkruar i

4) Shih më gjerësisht lidhur me këtë: Mr. Blerim Reka: "E Drejta e vetëvendosjes: Dimension Ndërkombëtar i Problemit të Kosovës", Shkup, 1996

Kosovës. Nga fillimi i të nëntëdhjetave, Kosova do të nxirrte kushtetuten post-federale, për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, kurse gjatë viteve në vijim edhe disa nga ligjet më themelore si: Dekret-Ligjin mbi Arsimin e Lartë; Pakot e ligjeve zgjedhore, etj. Pa marrë parasysh mosnjohjen e këtyre normave juridike nga bashkësia ndërkombëtare dhe pavarësisht se efekti i tyre praktik ishte tejet i limituar nën kushtet e një regjimi pushtues, ato riemituan mesazhin shekullor shqiptar për mosdëgjueshmëri qytetare kundër pushtuesit, madje edhe në rrafshin legjislativ. Në Kosovë, pra edhe nën pushtimin serb, shqiptarët kurrë nuk i pranuan ligjet serbe për të vetat, por nxorën të drejtën e vet të shkruar. Ashtu sikundër që Kanuni i Lekë Dukagjinit, gjatë shekujve i kishte bërë ballë ligjeve të pushtuesve të huaj; po kështu, Kushtetuta dhe ligjet përcjellëse të Kosovës, të nxjerra pas vitit 1990, ndonëse të panjohtura ndërkombëtarisht si ligje të një shteti sovran të pranuar, e përjashtonin së paku moralisht, zbatimin e legjislacionit pushtues serb, pra, jo me vullnetin e shqiptarëve, por si një legjislacion të dhunshëm, të imponuar dhe të papranueshëm nga popullsia shumicë e Kosovës. Diskontinuiteti juridik me këtë legjislacion pushtues serb në Kosovë do të ndodhë më 24 mars të vitit 1999, pra, me fillimin e bombardimeve të NATO- s mbi caqet ushtarake të regjimin serb, me çka do të përfundojë edhe ushtrimi faktik i këtij sovraniteti të dhunshëm të Beogradit. Intervenimi ushtarak ndërkombëtar i aleancës veri-atlantike, nuk do të kishte, pra, vetëm karakter militar. Ai do të shënonte edhe fillimin e shkëputjes legjislative serbe në Kosovë dhe inaugurimin e një legjislacioni të ri në krijim, nën patronatin e Kombeve të Bashkuara⁵.

5) *(Blerim Reka: "New Legislation in Post War Kosova: The Sui Generis Model of National and International Co- Participation on the Exercise of Sovereignty", ("Kosova Law Review", Vol. IV, No. 4, Winter, 1999, pages: 8- 11).

“LIGJI I APLIKUESHËM” NË KOSOVËN E PASLUFTËS

Mirëpo, Kosova, ndonëse u çlirua nga pushstuesi serb, ajo nuk u sovranizua shtetërisht. Ajo edhe pas përfundimit të luftës dhe pas largimit të ushtrisë serbe, nuk u bë me legjislacion të vetin origjiner, por me një sistem juridik sui generis të bazuar në bashkëparticipimin kombëtar - ndërkombëtar. Ç’është e vërteta fillimisht Qeveria e përkohshme e Kosovës e dalë nga Marrëveshja e Rambujesë e tri forcave kryesore politike (UÇK, LDK dhe LBD), filloi nxjerrjen e ligjeve të veta, por pa njohje ndërkombëtare, përkatësisht nga Kombet e Bashkuara. Pra, edhe përkundër largimit përfundimtar të pushtesit klasik dhe tradicional të Kosovës, asaj as sot e gjithë ditën, nuk iu njoh ndërkombëtarisht e drejta që vetë t’a nxjerrë ligjin. Shpjegimi mbase gjendet në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB- së, e cila tërë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv ia garantonte Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së⁶. Kosova, apriori qe përjashtuar që t’i aprovonte vetë ligjet e saj, sepse brenda administrimit të përkohshëm ndërkombëtar 1999-2000 nuk kishte autoritetin më të lartë ligjvënës, Kuvendin e saj, të zgjedhur demokratikisht. Në mungesë të një autoriteti të tillë legjitim, më të lartë politik vendor, (i cili mbase pas përfundimit të sukseshëm të zgjedhjeve lokale të 28 tetorit 2000, do të duhej të konstituohet pas zgjedhjeve qendrore të Kosovës, të paralajmëruara për fillim të vitit 2001), UNMIK-u filloi të nxjerrë rregulloret me fuqi ligjore për Kosovën. Përfaqësuesëve vendorë, si atyre në nivelin politik, (brenda KPA- së), ashtu dhe atyre në nivelin e ekspertëve ligjor, (në Këshillin e Përbashkët për Çështje Legjislative- JACL), u lihej vetëm një mundësi e kufizuar e pjesëmarrjes në procesin ligjë- krijues: brenda UNMIK-ut. Ky hartim i ligjit sui generis: kombëtar-ndërkombëtar, kishte filluar më 15 gusht të vitit 1999, kur Përfaqësuesi i Posaçëm i

6) UN Security Council Resolution, 1244/99

Sekretarit të Përgjithshëm të OKB- se, Dr. Bernar Kushner, kishte inauguruar "një qasje të re legjislative" me krijimin e "Këshillit të Përbashkët Konsultativ për Çështjet e Legjislacionit", pranë UNMIK-ut⁷. Brenda këtij trupi këshilldhënës juridik, ekspertët ligjorë kosovarë dhe ata ndërkombëtarë filluan hartimin e ligjeve të para të Kosovës së pas luftës. Eksperimentimi disamujor me të ashtuquajturin: "ligj të aplikueshem", i cili fillimisht sipas rregullores së parë të UNMIK- ut⁸, e cila udhëzonte në "vazhdimin e zbatimit në Kosovë të ligjeve që ishin në zbatim deri më 24 mars të vitit 1999", kishte dështuar. Pas një "beteje" të argumentuar të ekspertëve ligjorë të Kosovës, mbi papranueshmërinë absolute të zbatimit të legjislacionit pushtues serb, kishte përfunduar me abrogimin e zbatimit të tyre. Në fund të vitit 1999, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB- se, kishte fuqizuar dy rregullore të reja. Me të parën⁹, kishte përcaktuar si ligje të aplikueshme në Kosovë rregulloret që i nxjerrë UNMIK-u dhe ligjet që kishin qenë në zbatim në Kosovë, deri më 23 mars të vitit 1989. Me rregulloren e dytë¹⁰, UNMIK-u edhe de jure kishte abroguar nenin kontetues 3, të rregullores numër 1/1999, që udhëzonte në zbatimin e legjislacionit të fundit jugosllav. Me këto dy rregullore, kishte përfunduar edhe sjellja në rrethin vicioz disamujor të mospërcaktimit të ligjit që duhet zbatuar në Kosovën e pasluftës - deri në aprovimin e ligjeve të e reja të Kosovës së re. Ishte kjo një fitore jo vetëm profesionale, por edhe morale e ekspertëve ligjorë të Kosovës ndaj kolegëve të tyre ndërkombëtarë. Shumë më tepër se një fitore ligjore dhe e ekspertëve juridikë të Kosovës, ajo ishte edhe një fitore e embrionit të shoqërisë civile të Kosovës në krijim, pra e kundërshtimit të juristëve, gjyqtarëve dhe qytetarëve të Kosovës ndaj zbatimit të ligjeve të fundit pushtuese serbe dhe imponimit të zgjidhjeve që vinin nga shoqëria e Kosovës. Ekspertët ligjorë të Kosovës, pra si një shtresë e veçantë e

7) Shih: UNMIK news: "The New Legal Aproach", August 18, 1999, pg. 1

8) UNMIK Regulation, 1999/1, të 25 korrikut të vitit 1999; neni. 3

9) UNMIK Regulation 1999/24

10) UNMIK Regulation 1999/25

shoqërisë civile në krijim, jo vetëm që argumentuan bindshëm parimin e së drejtës ndërkombëtare, që ligji i një qeverie që praktikon gjencodin mbi një popull, humb përfundimisht legjitimitetin e zbatimit në atë territor¹¹; por edhe ofruan ligjet e reja për të plotësuar vakuumin juridik në Kosovën e pasluftës. Kjo betejë e fituar e tyre ishte edhe një dëshmi më tepër për shoqërinë civile të Kosovës që po krijohej menjëherë pas lufte, sepse edhe ekspertët e një fushe arritën të ndikojnë në marrjen e vendimeve aq të rëndësishme shoqërore, çfarë ishte çështja, se cili ligj do të zbatohet në Kosovën e pasluftës, ndonëse kjo ishte kompetencë ekskluzive e SRSG, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB- së. Duke hartuar, madje ligjet e para në historinë e Kosovës, si bie fjala: Ligjin e Procedurës Penale, apo Ligjin Penal, (si të tërin - me pjesën e përgjithshme), ekspertët ligjorë të Kosovës imponuan këtë qasje edhe gjatë takimeve konsultative me Këshillin e Evropës¹². Kjo histori e shkurtër e “betejës” gjashtëmujore rreth ligjit të zbatueshëm në Kosovën e pas luftës, pos rëndësisë thjesht juridike, u dëshmua edhe si një model i veçantë i një “conflict prevention & resolution” midis faktorëve kombëtarë dhe atyre ndërkombëtarë në një fushë aq të ndieshme shoqërore çfarë është zbatimi i ligjit.

Nëse burimi i konfliktit ishte insistimi fillestar i UNMIK- ut për të vazhduar zbatimin e ligjit jugosllav në Kosovë edhe pas luftës, paraqitja e konfliktit UNMIK- Kosovë, ishte kundërshtimi i kësaj qasjeje nga ana e juristëve kosovarë dhe shoqërisë (civile) të Kosovës, atëherë parandalimi i konfliktit ishte krijimi i Këshillit Legjislativ (JACL), kurse vetë zgjidhja e konfliktit ishte aprovimi i dy rregulloreve të UNMIK- ut: 24/1999 dhe

11) Hurst Hannum: “The Spectr of Secession: Responding the Claims for Ethnic Self- Determination”, Foreign Affairs, March- April, 1998; Blerim Reka: “The Las Genocide in Kosova and Need for Neë International Law”, (Panel for Kosova, George Pompidu Centre, Paris, June 21, 1999

12) në Strazburg, në sesionin e parë punues, 28-30 tetor 1999 dhe në atë të dytin, 29 nëntor- 3 dhjetor, 2000; në shqyrtimin dhe ekspertizën profesionale të dy projekt ligjeve të sipërpermendura sistemore, nga ekspertët e Këshillit të Evropës, (janar- mars, 2000; 3- 8 prill 2000 dhe 14- 17 nëntor, 2000

25/1999, me të cilat edhe formalo-juridikisht ishte abroguar gasja fillestare e UNMIK- ut, për zbatimin e ligjit jugosllav.

Po të parafrazonim Ackermanin, se juristët dhe historianët, secili në mënyrën e vet e shkruajnë historinë¹³, do të mund të thonim se juristët e Kosovës e shkruajtën historinë në mënyrën e vet: duke diskontinuuar zbatimin e mëtejshëm të legjislacionit të fundit pushtues serb në Kosovë dhe duke vendosur bazat e një legjislacioni të ri të Kosovës së re. Krahësuar me përvojën historike të paraardhësve të tyre, që përmes Kanunit të Lekë Dukagjinit, kishin arritur që pavarësisht të normonin jetën shoqërore nën sundimet e huaja, sot, Kosova, pas një periudhe të gjatë nuk ka as pushtues të huaj, as legjislacion dhunësisht të imponuar. Ç'është e vërteta, ende nuk e ka as ligjin e vet, por së paku bashkëparticipon me bashkësinë ndërkombëtare në ushtrimin e sovranitetit legjislativ, deri në zgjedhje dhe deri në konstituimin e organave legjitime të Kosovës, pra edhe të atyre kushtetutdhënëse dhe ligjvënëse, çfarë është Kuvendi i Kosovës.

Edhe nga kjo pasqyrë e shkurtër e historisë juridike të Kosovës, del qartë rëndësia e ligjit dhe roli i tij crucial për çdo shoqëri. Aq më tepër, sot, kur ligji është gurthemel për ndërtimin e shoqërisë civile. Jo pa arsye thuhet: më trego se çfarë ligjesh ke, që të tregoj se çfarë shoqërie (shteti) je. Derisa për ndërtimin një shtëpie, çdo gjë fillon nga themeli, të ndërtimi i shtetit është e kundërta: çdo gjë fillon nga kulmi. Ligji për shtetin është kulmi dhe vetëm pas tij mund të ndërtohen "katet" e tjera të ndërtesës shtetërore: ekzekutiva, administrata dhe gjyqësia.

Por edhe në fazën aktuale "jo shtetërore", para-shtetërore, apo në atë që unë e quaj situatën e një shteti virtual, në të cilën është aktualisht Kosova, nuk do të thotë se duhet lejuar anarkinë, arbitraritetin dhe derregullimin. Edhe në rrethanat e një protektorati të moderuar ndërkombëtar multilateral i administruar nga: OKB, NATO, UE dhe OSCE, të cilin disa e quajnë edhe "pushtim i sofistikuar", jeta duhet rregulluar me

13) Bruce Ackerman: "Revolution on a Human Scale", The Yale Law Journal, Vol. 108, no.8, June, 1998

ligj. A do të jenë këto rregullore të përkohshme të UNMIK-ut, apo jo, kjo nuk ka edhe aq rëndësi. Para titullit, apo formës së aktit juridik, është me rëndësi përmabjtja e tij normative. Sidomos, kur edhe vet liderët kryesor politik shqiptarë të Kosovës, me marrëveshjen e 15 dhjetorit të vitit 1999, vullnetarisht hoqën dorë nga kompetencat e qeverisjes me Kosovën, duke ia bartuar ato OKB-së. Me Marrëveshjen mbi Strukturat e Përbashkëta Administrative u inaugua koncepti i bashkë-administrimit, por jo edhe ai i bashkë-qeverisjes, me çka i tërë pushteti legjislativ, (dhe ai ekzekutiv) i mbeten ende Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Me fjalë të tjera, nxjerrja e ligjit në Kosovë edhe për një kohë do të jetë kompetencë ekskluzive e bashkësisë ndërkombëtare, me çka sikur i afrohem konceptit të Garaponit, mbi të ashtuquajturin "denacionalizim të ligjit"¹⁴.

Ligji, edhe në këto rrethana post-konfliktuale, mbetet parakusht për ndërtimin e një shoqërie civile në Kosovë, sepse mundëson që ajo të qeveriset nga normat objektive juridike e jo nga dëshira subjektive e personit; nga rregullat ligjore, e jo nga arbitrariteti individual; nga fuqia e ligjit, e jo nga fuqia financiare apo politike e personit. Mirëpo, për të qenë një ligj i pranueshëm dhe i zbatueshëm, nga ata të cilëve ai edhe i drejtohet, pos nivelit të ekspertizës profesionale vendore, duhet siguruar edhe inkudrimi i nivelit laik, çka nënkupton përfshirjen sa më të gjerë të qytetarëve dhe elementeve të tjerë të shoqërisë civile në procesin ligjë-hartues. Duhet siguruar një transparencë më e madhe e ecurisë së procedurës ligjë-krijuese, me njohtimin paraprak publik të projekteve që shqyrtohen në nivel ekspertësh, në mënyrë që qytetarët, ndonëse laik, të mund të shprehin mendimet e veta rreth një ligji, para se ai të aprovohet. Kjo do të demokratizonte edhe ashtu procedurën e pazakonshme legjislative që aktualisht po zbatohet nga UNMIK-u dhe do t'i jepte rregulloreve të tij një kredibilitet dhe legjitimitet më të gjerë shoqëror. Kjo transparencë dhe

14) Antoan Garapon: "Le Gardian Des Promesses; Justice et Democratie", Paris, 1996

“konsultë” paraprake brenda shoqërisë civile në krijim - çfarë është Kosova, do t’a bënte edhe ligjin më të afërt, më të pranueshëm dhe prandaj edhe më të zbatueshëm për qytetarët, e jo të imponuar. Pikërisht për këtë qëllim, Instituti i Kosovës për Integritet Evro-Atlantike, (KIEAI), në nëntor të vitit 2000, ndërmori një iniciativë të re nga domeni i shoqërisë civile: formimin e Forumit Kushtetues të Kosovës, me qëllim të mbushjes së këtij vakuumi kushtetues në Kosovën e pasluftës me një model të ri të hartimit të Kushtetutës që vjen nga qytetarët, ekspertët dhe NGO-të. Duke qenë se Kosova deri në fund të vitit 2000 ishte shoqëri pa kornizë kushtetuese, fakt ky që ishte bërë një frenues i ndërtimit demokratik të shoqërisë kosovare, KIEAI kishte ofruar pikërisht Forumin Kushtetues të Kosovës, si një vendtakim burimor të shoqërisë civile të Kosovës për hartimin e aktit më të lartë juridik të saj me bashkëinkuadrimin e të gjitha shtresave të shoqërisë kosovare.¹⁵ Pos Forumit Kushtetues të Kosovës, i cili në mungesë të Kuvendit të Kosovës, do të duhej të koordinonte iniciativat qytetare për kushtetutën e re të Kosovës, poashtu edhe për ligjet e Kosovës së periudhës së pasluftës do të duhej të inaugurohej një model i debyrokratizimit legjislativ, çfarë ishte deri vonë procedura e nxjerrjes së rregulloreve të UNMIK-ut, që shkonte në relacionin: Selia e OKB- UNMIK- KPA- JACL- KPA- UNMIK- Selia e OKB- së. Kjo ngase në një rreth të tillë të mbyllur kabinetik dhe ekskluzivisht profesional juridik, shpesh qytetarët nuk kishin mundësinë të thonë mendimin e vet për rregulloret që nxirreshin në Kosovë. Trajta më e qëlluar për një qasje të tillë konsultative legale brenda shoqërisë civile kosovare, ndoshta do të mund të ishte organizimi i tryezave, apo i tribunave javore për ligjet-rregulloret e UNMIK-ut, që përgatiten, ku qytetarët do të mund të shprehnin lirisht mendimet e veta për aktet juridike në fjalë. Ky do të ishte edhe një dimension i rëndësishëm për ndërtimin

15 Shih Projektin e KIEAI- së për FKSHC, nëntor, 2000, pjesërisht të botuar e të emituar edhe në mediat vendore dhe ndërkombëtare, si: Radio Evropa e Lirë, 18 nëntor, 2000; “Bota Sot”, 19 nëntor, 2000, faqe. 2, etj.).

e shoqërisë civile në Kosovë: bashkëpjesmarrja e qytetarëve në hartimin e ligjeve të reja dhe demokratizimi i kësaj procedure ligjvënëse me zgjerimin e rjetit konsultues të mbarë shoqërisë kosovare. Hartimi i ligjit, me një bazë e me një konsultë të tillë më të gjerë shoqërore, do t' i jepte edhe një impuls tjetër të ri ndërtimit të shoqërisë civile në Kosovë. Ajo do të debyrokratizonte ftohtësinë tradicionale të ekspertëve legal dhe do t' i jepte jetë reale normave ligjore. Involvimi më i madhë i qytetarëve në nxjerrjen e ligjit do t' a bënte edhe më transparent këtë proces ligj-hartues. Dhe kjo nuk do të ishte ndonjë çpikje e jonë epokale, por diçka e parë edhe më heret në shoqëritë tjera perëndimore. Flitet për një anekdotë, se si Napoleoni, në komisionin për hartimin e ligjeve më të rëndësishme të kohës, pos ekspertëve, kishte emëruar madje edhe bujqit, në mënyrë që edhe një qytetar i thjeshtë dhe joprofesional, pra jo-ekspert, të shprehej rreth një ligji që ishte në hartim e sipër. Kuptohet se me transparencën e tillë, sot, nuk kërkohet deprofesioanilizimi i kësaj procedure, e aq më pak inaugurimi i laicizmit legal dhe i gjuhës jo-juridike të ligjit, por vetëm një pjesmarrje më e madhe e qytetarëve, pra edhe e shoqërisë civile në tërësi në këtë proces jashtëzakonisht të rëndësishëm ligjë-krijues, nëpër të cilin po kalon aktualisht Kosova.

Sa për gjuhën ligjore, është i njohur "udhëzimi" i Sartrit, për shkrimtarët francez, kur ata i kishte drejtuar t'a lexonin detyrimisht Kodin Civil Francez, (e në hartimin e të cilit, siç u tha megjithatë kishin marrë pjese edhe jo-juristët). Gjuha e tij ishte e kuptueshme, pra edhe e zbatueshme për ata, të cilëve edhe u drejtohej ky ligj. Prandaj, ligjë-krijimi është një proces kompleks, jo vetëm intelektual por edhe politik e kombëtar. Rëndësia e ligjit për një shoqëri civile në krijim e sipër, çfarë është kjo e Kosovës është e padiskutueshme. Sikur që është fortë e rëndësishme edhe komponentja e linguisitike dhe stilistike. Ligjet që nuk i kupton askush, më së paku i nevojiten një shoqërie, e cila pikërisht kishte vuajtur më së shumti nga efekti represiv i tyre. Kosovës, si shoqëri civile në krijim e sipër i nevojiten ligje të qarta, sa më të thjeshta, të kuptueshme, demokratike, koncize e të pranueshme për rrethin më të gjerë shoqëror. Kjo mund të arrihet me demokratizimin e proce-

durës ligjëvenëse. Kosova e shekullit të ri nuk ka nevojë për ligje kabinetike, as për ligje të komiteteve partiake e më së paku për ligje si monopol shoqëror i një klase politike a një grupi të interesit. Ligji për qytetarin dhe nga qytetari e kursesi kundër qytetarit.

Dimensioni bashkëkohor i shoqërisë civile në Kosovë nënkupton një përfshirje sa më të gjerë të qytetarëve të rëndomtë në procesin e hartimit të ligjit, liberalizimin dhe demokratizimin e procedurës ligje-hartuese, konsulltimin e bazës më të gjerë shoqërore, nëse deshirojmë që ky ligj të burojë nga vetë qytetarët dhe për qytetarët. Në të kundërtën, ligji do të ishte antipodi i tij: burim i paligjshmërive.

SHOQËRIA CIVILE DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Në këtë punim është shqyrtuar ndërvlerësia në relacionin zhvillimi ekonomik dhe shoqëria civile duke pasur parasysh momenti i pikërisht në Kosovë dhe nevojën imediate për artikullimin e interesave për zhvillimin human dhe ndërtimin e një roli i substancial të shoqërisë civile në këtë fushë. Thëksi është vënë në ndërtimin e shtetit ligjor si papakusht i barazisë në treg, reformave ekonomike dhe ndërtimit të ekonomisë së hapur. Lidhur me këtë është theksuar rëndësia e transparencës për fatin e reformave. Gjithashtu në këtë rrafsh është shtruar edhe viabiliteti ekonomik (qendrueshmëria e ekonomike) e Kosovës dhe roli i shoqërisë civile për ndërtimin e pavarësisë ekonomike në kushtet e integritetit. Është vënë theksi edhe në rëndësinë e NVM (zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme) dhe nevojën e përmirësimit të organizimit të komunitetit të biznesit si pjesë qendrore e klasës së mesme dhe e shoqërisë civile në Kosovë.

1. NDËRVLERËSIA : ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SHOQËRIA CIVILE

Ndërtimi i shoqërisë civile nënkupton arritjen e një niveli kritik të demokracisë në shoqëri por gjithashtu ndodhet në një interakcion dhe varshmëri reciproke me zhvillimin ekonomik. Kjo ndërvlerësi shprehet posaçërisht në cilësinë e zhvillimit në aspektin përmbushjes së kërkesave të pjesës dërmuese të shoqërisë dhe njwkohësisht në qendrueshmërinë e vlerave të shoqërisë civile në vendet e caktuara. Zhvillimi i ekonomisë së tregut dhe progresi teknologjik ka mundësuar krijimin e standardeve të qeverisjes së zhvillimit dhe ekonomisë duke u falenderuar mekanizmave të përsosur të tregut dhe pluralizmit

politik, i të cilët shpiejnë deri tek përgjegjësia shoqërore dhe deri tek transparenca. Kjo vie parasëgjithash si rezultat i funksionimit të shtetit ligjor i cili krijon shansa për të gjithë akterët por edhe një rrafsh ku secili bartë përgjegjësitë për vendimet dhe sjelljet e tija.

Një ndërvarësi e tillë në Kosovë krijohet në rrethana specifike të cilat parasëgjithash kanë të bëjnë me:

- a) rindërtimin e pasluftës duke përfshirë jo vetëm rindërtimin e infrastruktures e fondit të banimit por edhe të ekonomisë dhe hapjen e perspektivave të zhvillimit
- b) mungesën e strukture institucionale përgjithsisht e sidomos të kanaleve për ndikim të qytetarëve dhe shoqërsë civile procesin e marrjes së vendimeve dhe të ndërtimit të politikave ekonomike dhe mundësive shumë të kufizuara për monitorim dhe transparencë
- c) involvimin e fortë të bashkësisë ndërkombëtare – administratës ndërkombëtare dhe organizatave qeveritare dhe joqeveritare, por pa partneritet të mjaftueshëm me Kosovarët

Momenti i pikrëshëm në rrafshin ekonomik karakterizohet me shenjat e para të stagnimit dhe të ngadalësimit të ritmit të shpjegjës të ringjalljes së aktiviteteve të paluftës. Tani kur duhet kaluar nga faza emergjente në atë substanciale të zhvillimit duket se mungon jo vetëm energjia e nevojshme por politika e strategjia dhe gjithashtu sistemi i menaxhimit që do të artikulojë këto energji.

Konsiderohet se tanimë niveli i aktivitetit ekonomik ka tejkaluar atë të paraluftës ndonëse treguesit ekzakhtë statistikorë mungojnë thuaja tërësisht pasi që edhe pas dy viteve ende nuk është organizuar publikimi i një statistikë elementare. Sipas vlerësimeve të bazuara në anketa dhe vlerësimet e nivelit të konsumit konsiderohet se tani Kosova ka rreth 700 USD të GDP për banorë. Niveli i aktivitetit ekonomik i ndërmarrjeve private dhe ekonomive familiare është edhe më i qndrueshëm. Ndërmarrjet private, ndonëse pa mbështetje institucionale por edhe pa pengesat e mëdha të aparatit represiv që përbënte rrethinën e tyre për 10 vite kanë treguar vitalitet të madh. Ekonomitë familiare poashtu janë në një trend

pozitive të rivitalizimit, rikultivimi i tokës po bëhet më shpejtë se sa ishte planifikuare mos te flasim për dyqanet zejtare, tregtare dhe sherbyese. Problemet më të mëdha janë në ripërtitjen e fondit të bagëtive tek fermerët , të cilat kanë qenë dëmtuar gjatë luftës rreth 50%. Ndërmarrjet shoqërore kanë vështirësi shumë të mëdha . Kapitali fiks i këtyre ndërmarrjeve pa llogaritur infrastrukturën fizike vlerësohet në rreth 8 miliardë marka , mirëpo në mungesë të programit të privatizimit dhe problemeve që ndërlidhen me të , kjo pasuri në vende që të gjenrojnë të ardhura dhe vende të reja të punës i është nënshtruar një procesi të degjenerimit teknologjik. Si rezultat i kësaj aktualisht është një normë e lartë e papunësisë, cila vlerësohet në rreth 50% të popullsisë së aftë për punë.

Angazhimi i shoqërisë civile në fushën e zhvillimit ekonomik është thuaja simbolik sepse pikërisht në këtë fushë kapacitetet e shoqërisë civile (OJQ, media, edukimi) janë më modeste dhe nga ana tjetër, siç u theksua, shoqëria civile në Kosovë i ka mundësitë e kufizuara të veprimit në mungesë të institucioneve.

Andaj një karakteristikë dominuese e ndërtimit të Kosovës së pasluftës mund të përmbledhet në konstatimin: individi i suksesshem (ringjallja e biznese individuale dhe ndërtimi i ambientit jetësor) në kushtet kur muga sisetemi dhe mekanizmat që formësojnë një shoqëri që krijon sinergji. Së këndejmi në mënyrë imanente paraqitet nevoja për krijimin e institucioneve dhe kanaleve në të cilat intersat lidhur me zhvillimin ekonomik artikulohe, prezentohen dhe merren në konsiderate. Shoqëria civile sikurse edhe partitë politike ende nuk janë të aftësuar dhe të gatshme që ta marrin përgjegjësi lidhur me këtë. Nga ana tjetër gjendja e tashme e pavolitshme sa i përket komunikimit dhe mundësive të ndikimit të shoqërisë civile të Kosovës dhe përgjithsisht Kosovarëve në procesin e marrjes së vendimeve nga ana e administratës ndërkombëtare ka filluar të prodhojë frustracionet e para, të cilat ka rrezik që të rriten paralelisht me rritjen e këtij "gapi" .Ky shpërpjestim do të jetë gjithnjë e më i dukshëm në kohën duhet marrë më shumë vendime të karakterit strategjik, pasi që emrgjencën po lëmë fatbardhsisht gjithnjë e më shumë prapa nesh. Ilustrim për këtë është diskutimi i tashëm lidhur me privatizimin-debati dhe polemikat që zhvillohen lidhur me këtë midis koso-

varëve dhe disa segmenteve të administrates ndërkombëtare.

Në këto rrethana roli i shoqërisë civile në Kosovë dhe sidomos i disa segmenteve të saja duhet të jetë në artikullimin e këtij opinioni dhe sidomos në ushtrimin e një presioni konstruktiv sidomos në dy drejtime:

- a) krijimin dhe ndërtimin më të shpejtë të institucioneve demokratike dhe ndikimin pozitiv në punën e tyre më të frytshme
- b) në krijimin e kanaleve më efikase për transmetimin e inputeve dhe mesazheve kosovare në qendrat e vendosjes në administratën ndërkombëtare në Kosovë dhe jashtë Kosovës lidhur me zhvillimin ekonomik

Ndikimi i shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik do të shprehet pozitivisht në rritjen e qëndrueshme ekonomike në sajë të kombinimit më të suksesshëm të burimeve dhe resursve të kufizuara parasëgjithash nëpërmejt afirmimit të konceptit të zhvillimit human. Ky koncept ka të bëjë me ngritjen e cilësisë së zhvillimit e cila nënkupton ofrimin e shansave të barabarta për të marrë pjesë në proceset e zhvillimit, për të qenë akter i zhvillimit por edhe për të ndikuar në shpërndarjen më të drejtë të fruteve të zhvillimit. Ky paraqet një zhvillim të humanizuar, zhvillim për njeriun dhe duke respektuar në mënyrë rigorozë të drejtat e njeriut. Dhe këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me GDP ose të ardhurat kombëtare për një banorë si tregues sintetik i nivelit të zhvillimit ekonomik por edhe me shansat që ka popullsia e një vendi në pjesëarrje në shërbimet publike, shkallen e përfshirjes së gjenratave në nivelet e ndryshme të arsimit, mbrojtjen shëndetsore (jetë gjatësisë mesatare e popullatës), pozitën ekonomike të gruas dhe kategorive të caktuara të popullatës siç janë për shembull pakicat kombëtare. Duke inkuadruar edhe koeficientet e GDP për banorë, koeficientin e përfshirjes së gjeneratave në nivelin e ndryshme të arsimit dhe koeficientine jetëgjatësisë mesatare të popullatës UNDP përcjell për shumë shtete të botës treguesit e zhvillimit human, ndër të cilët më i njohuri është indeksi i zhvillimit human. Është me rëndësi se duke filluar nga ky vit Kosova do të inkuadrohet në mesin e më shumë se 150 vendeve për të cilat bëhet raporti i zhvillimit human.

Në këtë fazë kur në Kosovë kemi të bëjmë edhe me përkufizimin e strategjisë së zhvillimit shoqëror objektivi i shoqërisë civile duhet të jetë që pikërisht të afirmohen konceptet moderne të zhvillimit të cilat përfshijnë tregun si institucion i pazëvendësueshëm dhe rregullator që nxitë lirinë dhe kreativitetin, por gjithashtu edhe kriteret e zhvillimit human. Për Kosovën është me rëndësi që të ngritën kapacitetet për absorbimin e energjisë ndërmarrëse e cila është kapitali më i rëndësishëm zhvillimor i Kosovës. Afirmim i ndërmarrësit dhe rolit të tij në shoqëri si gjenrator i zhvillimit dhe i ndërmarrsisë si filosofi bazike e zhvillimit ka të bëjë pikërisht me zgjerimin e mundësisve që aktet e zhvillimit të kenë hapësirë krijuese, të vedosin dhe të marrin përgjegjësinë për vendimet e tyre. E aktet kryesor janë ndërmarrësit, ndërmarrjet, kompanitë, ekonomitë familiare, institucionet e sistemit ekonomik.

Shoqëria civile ka rol të pazëvendësueshëm në afirmimin e konceptit të zhvillimit të bazuar në dituri i cili rendësi vendimtare për rritjen e fuqisë absorbuese zhvillimore të një shoqërie. Konsiderohet se në kushtet moderne të zhvillimit faktet jomaterial (dituria, informatat dhe sistemi i qeverisjes) kanë një epërsi të dukshme për akcelerimin e zhvillimit në krahasim me botkuptimin tradicional për rendësinë e faktorëve si pasuritë natyrore dhe popullsia . Disponimi me informata, dituria për t'i përdorur në mënyrë efektive ato informata në marrjen e vendimeve ekonomike zhvillimore dhe në menaxhimin e biznesit paraqiten faktor kyç për zhvillim të bazuar në të arriturat e civilizimit bashkëkohor.

(2) SHTETI LIGJOR, BARAZIA NË TREG, REFORMA EKONOMIKE

Rrethina e favorshme e zhvillimit ekonomik nënkuton ekzistencën e shtetit ligjor si parakusht elementar për shansa të barabarta për të gjithë në kushtet kur ligjet respektohen e zbatohen pa përjashtim. Kjo është e lidhur ngusht me ekzistencën e konkurrencës së fer dhe të drejtë si parakusht i barazisë së aktet në treg dhe antipod i monopolit. Ndërtimi i tregut të lire dhe konkurrencës madje paraqet një ndër segmentet më të

vështira të zhvillimit të reformes në Kosovë , siç është rasti edhe me vendet e tjera në tranzicion. Konkurrenca dhe tregu i lirë nuk varen vetëm prej asaj se sa është tregu i kontrolluar nga shteti dhe çfarë regjimesh të importit dhe eksportit ekzistojnë. Shembull tipik për këtë mund të merret Kosova, ku tregtia është krejtësisht e lire dhe importi nuk ka kufizime, megjithatë konkurrenca "jo-fer", përkatësisht e pabarabartë paraqitet si problemi më kryesor për ndërmarrësit privatë në Kosovë (Anketës e realizuar nga Riinvesti me 300 ndërmarrje private, në nëntor të vitit 2000). Origjina e kësaj pabarazie në treg duket se ka të bëjë parasëgjithash me evazionin fiskal , përkatësisht me pabarazinë e subjekteve ekonomike ndaj pagimit të taksave , ku një pjesë e tyre krijhon përëparsia konkurruese në treg duke mos i paguar taksat. Evazoni fiskal është një çështje mjaft e ndieshme e cila ndërlidhet me veprimin e shtetit ligjor, me transparencën dhe korrupsionin, përkatësisht kriminalizimin e ekonomisë i cili mund të jetë fatal jo vetëm për zhvillimin e ekonomik por edhe përgjithësisht për demokracinë dhe promocionin e vlerave të shoqërisë civile.

Prandej është e qartë se tregu i lire dhe konkurrenca fer si një ambient i volitshëm për shoqërinë civile dhe përgjithësisht vlera fundamentale të civilizimit bashkëkohor mund të jenë rezultat i reformave komplekse ekonomike dhe përgjithësisht shoqërore ku ndërtimi i shtetit ligjor e ka rendësinë kyçe.

Krijimi i infrastrukture institucionale për ekonominë e hapur të tregut e cila duhet t'i korrespondojë shoqërisë së hapur dhe vlerave të shoqërisë civile në Kosovën e pasluftës ka shënuar disa hapa të rendësishëm . Janë vënë bazat e :

- sistemit të bankave
- sistemit të taksave dhe politikës fiskale
- ligjet të rendësishme komerciale (ligji mbi kompanitë, ligji mbi investimet e jashtme, ligji mbi kontratat afariste e të ngjashme)

Për kompletimin e kuadrit elementar ligjor të kërkuar nga një ekonomi e tregut të rendësisë së vaçantë kanë ngelë nxjerrja e rregulloreve/ ligjeve për privatizim, ligji bankrotit, dhe ligji i kontabilitetit. Shikuar nga prizma e shoqërisë civile është me

rendësi të shtrohet fakti se ndikimi i saj në procesin e nxjerrjes së këtyre ligjeve është shumë i vogël. Bile edhe informimi komunitetit të biznesit për këto ligje është fare i vogël. Rreth 60% e afaristëve konsideron se nuk janë të informuar mbi ligjet që i nxjerr UNMIK –u , ndërsa rreth 70% e tyre informatat më të rëndësishme për këtë i marrin nga kolegët ose medist.

Qendrimi i komutietit të biznesit në Kosovë dhe përgjithsisht i opinionit Kosovar ndaj refomave është shumë pozitiv. Rreth 80% e ndërmarrjeve kosovare – menagjerëve të tyre kërkojnë privatizim efikas dhe të menjëhershëm, por kjo nuk zbatohet për shkak të hezitimit të UNMIKU-t që ta shikojë drejtë këtë çështje. Paraqiten pengesa artificiale “politike” të cilat mund të kenë për pasojë konservimin e strukturs ekzistuese të pronës shoqërore e cila mund të ketë ndikimet të shumta negative jo vetëm në efikasitetin ekonomik por edhe lidhur me reformat dhe përgjithsisht demokratizimin e shoqërisë kosovare.

Orgnaizatat joqeveritare dhe mediat ende nuk kanë krijuar kanalet nepërme të të cilave do të ushtronin ndikim më të madh në intenzitetin dhe kahjen e reformave dhe ende nuk kanë ndërtuar një strategji të advokacionit të tyre lidhur me çështjet e zhvillimit ekonomik. Këtu përjashtim mund të bëjnë dy- tri organziata kërkimore por kjo është e pamjaftueshme për të ushtruar ndikimin më të madh në rrjedhat shoqërore.

Roli i mediave në këtë fushë po ashtu nuk po vie në shprehje. Deri sa gazetatat e përditshme dhe mediat elektronike tregojnë një interesim në rritje për problemet e rindërtimit, zhvillimit ekonomik dhe reformave ato ende nuk kanë krijuar staf të përgatitur profesionalisht në masen e duhur për të trajtuar këto tema më me kompetencë. Veçanrisht mungojnë publikimet më të specializuara që do të zhvillonin , kulturën e ndërmarrësisë, etikën e biznesit dhe do të ofronin informacion mbi rrjedhat më të reja të ndikuara nga globalizimi dhe digjitalizimi i ekonomisë.

Është një rrezik latent që puna mjaft e mbyllur e UNMIK–ut të krijojë praktika që janë jashtë nivelit të domosdoshëm të transparences dhe të ndikimit të opinionit dhe testimit e respektimit të disponimit të tij. Në kushtet kur faktikisht mungon përgjegjësia ndaj zgjedhsve dhe votes së lire të qyte-

tarëve si një ndër faktorët e domosdoshëm korrigjues ekziston rreziku real për marginalizimin e ndikimit të opinionit dhe respektit të domosdoshëm që duhet të ekzistojë për këtë. Gjithashtu edhe polarizimi i fortë politik midis akterëve kryesor në spektrin politikë mund të këtë ndikim në zvogëlimin e objektivitetit të opinionit në vlerësimin e rezultateve të bartësve të funksioneve me rëndësi shoqërore. Prandej në këtë lloj hapësire roli i shoqërisë civile është edhe më i madh sidomos në angazhimin e saj për të kultivuar elemente të rendësishme të transparencës sië janë : puna publike, përgjegjësia ndaj zgjedhësve dhe opinionit, monitoringu si një shprehje mosindiferencës shoqërore. Të gjitha këto janë aspekte të rendësishme të ndërtimit të shoqërisë civile e cila do të zvogëlonte hapërsirën për deformimet të shprehura më së shumti në formë të korrupsionit që në masë më të madhe paraqiten në vendet në tranzicion dhe vendet e pazhvilluara ekonomikisht.*

Krijimi i institucioneve të pushtetit lokal paraqet një fazë të rendësishme në krijimin e institucioneve demokratike dhe praktikave të përgjegjësisë ndaj opinionit dhe të transparencës së mirëfillët. Mirëpo derisa nuk ekzistojnë institucionet qendrore që kanë kompetenca më të mëdha sa i përket zhvillimit ekonomik do të mbetet një zbrastësirë dhe fushë e pambuluar edhe për shoqërinë civile

3. VIABILITETI EKONOMIK (QENDRUESHMËRIA EKONOMIKE) I KOSOVES DHE ROLI SHOQËRISË CIVILE

Dilemat mbi aftësinë e Kosovës për të mbijetuar ekonomikisht e pavarur shtrohen shpeshherë nga këndshikime të ndryshme lidhur me statusin final të Kosovës. Natyrisht se kjo çështje shpesh shtrohet edhe për qëllime spekulative sepse Kosova gjithsesi duhet ta servisojë buxhetin e vet ose duhet të pajtohet me pozitë koloniale. Prandej pavarësia ekonomike është e pashmangshme. Tek e fundit çdo vend mund të jetë i aftë për të mbijetuar, apo më mire të themi jetuar mire apo keq

varësisht se sa është i zoti të përdorë mire burimet dhe potencialet e veta, në rend të parë njerzit, dituritë dhe shkathtësitë e tyre, sa ka informata në disponim dhe çfarë sistemi të qeverisjes (sistem ekonomik) ka .

Në këtë relacion edhe Kosova në mënyrë të pashmangshme duhet ta projektojë dhe menaxhojë pavarësinë e vet ekonomike . Cilësia e pavarësisë ekonomike mund të jetë e ndryshueshme , varësisht nga të ardhurat vjetore përkatësisht GDP për një banor! Pra ne mund të jetojmë me 700 \$ për një banorë, me 3.000, 10.000 , apo 20.000 \$ mesatarisht brenda vitit. Kjo varet nga ne, nga zgjedhja që bëjmë si konsumatorë dhe zgjedhës në kutitë e votimit, nga përgjegjësia që ushtrojnë në qeverisjen e shoqërisë dhe ekonomisë, transparenca, natyra e sistemit ekonomik dhe nga përkushtimi për të ndërtuar shoqërinë demokratike, të lire, pa dhunë pra shoqërinë e hapur e cila apsorbon dhe artikulon energjitë ndërmarrëse.

Gjykuar në bazë të analizave tona objektive dhe studimeve të Riinvestit mund të konkludohet se Kosova është në gjendje ta buxhetojë pavarësinë e vet ekonomike në kushtet e ndërtimit të një sistemi bashkëkohor ekonomik sipas kërkesave të ekonomisë së hapur të tregut. Burimet dhe potencialet e Kosovës janë një përparësi e Kosovës në krahasim me shumë shtete të rajonit dhe më gjërë . Shtrohet pyetja se sa e ka dëshmuar Kosova këtë aftësi në të kaluarën?

Në periudhën e autonomisë substanciale të Kosovës në kushtet e ish Jugosllavisë 1968-1989 , Kosova ka financuar buxhetin e saj rreth 75% dhe ka kontribuar në buxhetin e federates së ish Jugosllavisë. Buxheti i atëhershëm i Kosovës ka qenë thuaja dyfish më madhe se ky i tanishmi (rreth 950 milion DEM). Në këtë kohë sipas analizave të ekspertëve Kosovar ka qenë objektivisht e dëmtuar në aspektin e bilancit të pagesave (hyrjeve dhe daljeve me ish Jugosllavi) por ka treguar shkallë relativisht të lartë të mvetësisë ekonomike.

Ne periudhën 1989-1999, Kosova mbijetoi okupimin dhe klonializmin më të vrazhdë . Krijoi sistemin e vet të pavarur të shërbimeve publike (me me tepër se 25000 punëtor publik, me paga të rregullta për të mbajtur gjallë shërbimet vitale) dhe buxhetin e vet,. Veç kësaj Kosova me diasporën e saj financoi dhe rrezistencën e armatosur 1998-1999. Në këtë mënyrë me

rrezitencën e vetë të armatosur dhe rrezistencën evetë paqësore populli i Kosovës tregoi vitalitein e vet dhe aftësinë për mbijetësë, e meritoi lirinë dhe dëshmojë se mund ta mbajë vetveten dhe mund ta ndërtojë paqen dhe pavarësinë.

Tani Kosova është një vend me pasoja të rënda të luftës dhe në ndërtim të shtetësisë së vet me një involvim të forte të komunitetit ndërkombëtar. Rindërtimi i pas luftës, sidomos aty ku është vararur nga përjekjet individuale ka dëshmuar të njëjten energji dhe potenciale. Kthimi në Kosovë, rindërtimi i shtëpive, rifillimi i bizneseve familiare dhe i ndërmarrjeve private kanë impresionuar botën dhe përmirësuar edhe më imazhin e Kosovarëve në botë ? Mirëpo problemet kanë ardhur aty ky nevojitet të veprojmë si sistem, aty ku duhet të punojmë bashkë brenda përmbrenda amëz sociale në Kosovë.

Sa i përket aspektit ekonomik Kosova po e rrit buxhetin evet dhe pjesëmarrjet në krijim e të ardhurave të tij. Në vitin 2000 kosovarët mbulonin rreth 50% të shpenzimeve të buxhetit të konsoliduar, kurse parashikimet për pagesa e taimëve dhe taksave u tejkaluan, kurse me 2001 rreth 2/3 e këtij buxheti, në kohën kur ai arrin shumën rreth 500 mil DEM . Ky është një sukses. Por të gjithë e dijmë se buxheti real i Kosovës do të jetë gati dyfish më i madh ? A mund ta bartin këtë Kosovarët ? Përgjegjja është po, gradualisht me rimëkëmbjen ekonomike dhe rritjen e përgjegjësisë për pagesën e taksave? Shkaku kryesor qendron tek evazioni fiskal i cili u përmend edhe më lartë. Por shoqëria kosovare duhet të ketë mekanizma mbrojtës për këtë. Presioni i opinionit publik, mediave, shoqërisë civile dhe partive politike duhet ta krijojë ambientin në të cilin ai që nuk paguan taksat do të ndihej i turpëruar. Mirëpo evazioni fiskal nuk mund të luftohet vetëm me masa administrative dhe apele moralizuese. Komuniteti i biznesit duhet t'i ketë mundësitë për të ndikuar në ligjet që nxirren, ndërsa struktura e taksave duhet të jetë e logjikshme dhe e pranueshme për pjesën dërmuese të biznesmenve. Në rastin konkret në Kosovë komuniteti i biznesit në rreth 60 % i konsideron taksat të larta ose të papërbalueshme (Anketa e Riinvestit – 2000) ndërsa mundësitë e këtij komuniteti për të ndikuar në regjimin ekzistues të taksave praktikisht nuk kanë ekzistuar prandaj edhe ky fakt mund të ndikojë në evazionin fiskal.

(4) ZHVILLIMI I NVM DHE ORGANIZIMI I KOMUNITETIT TË BIZNESIT SI KOMPONENTË E SHOQËRISË CIVILE

Në Kosovë para luftës kanë qenë të regjistruara rreth 16700 ndërmarrje private , apo ndërmarrje të mesme dhe të vogëla (NVM). Pas lufte deri më fund të vitit të kaluar janë rievenduar rreth 14500 ndërmarrje. Janë evidentuar pothuajse edhe po aq ndërmarrës individual (shitoret, kafetë, restorantet , dyqanet zejtare, agjencitë e tj.). Kjo përbën komunitetin të biznesit në Kosovë. Ripërteritja e aktiviteteve pas luftës u bë shpejtë , numri i të punësuarve ka shënuar një rritje vjetore për rreth 10% gjë që tregon për një dinamizëm të këtij sektori. Rëndësia e NVM nuk qendron vetëm për faktin se ato do të jenë gjenratori kryesor i zhvillimit në Kosovë por edhe se ndërmarrësit , pronarët dhe menaxheret e lidhur për këtë sektor biznesi përbëjnë ndoshta komponentin më të rëndësishëm të klases së mesme në Kosovë, e cila ka rëndësi shumë të madhe për cilësië e demokracisë dhe rrrjedhat e ndërtimit të saj. Lidhur me këtë është me rëndësi të posaçme se me çfarë rruge krijohet kjo klasë e mesme, a është ajo rezultat i një ambienti të shëndoshë biznesi apo krijohet npërmjet të rrugëve informale dhe jashtë kanaleve legale.

Gjendja e pikërishtme e zhvillimit të iniciativës private dhe NVM tregon se rrethina e biznesit në Kosovë është mjaft turbulente dhe krijojn pasiguri për zhvillim më afatgjatë. Sipas anketës së cituar të Riinvestit pengesat më të mëdha , me të cilat ballafaqohen bizneset në Kosovë janë :

- Mungesa e ligjeve
- Konkurrenca jolojale
- Financimi
- Tatimet e larta
- Disponimi i informatave

Ky regjistër pëngesash është tipike për një rrethinë të pade-finar institucionalisht dhe pa infrastrukture mbështetëse sido-

mos lidhur me financimin. Komuniteti i biznesit ka nevojë që të jetë më i organizuar nëpërmjet asociacioneve të biznesit, të cilat duhet të bëjnë një lloj lobimi dhe advokacioni për interesat e ndërmarrësve. Aktualisht komuniteti i biznesit në Kosovë nuk ka fizionomi të ndërtuar dhe mungon zëri i tij për t'u prezentuar në mënyrë adekuate tek krijuesit e politikave ekonomike gjatë procesit të nxjerrjes së ligjeve ose përku-fizimit të masave të tjera të politikës ekonomike. Oda Ekonomike e rikrijuar pas luftës ka bërë disa hapa të rendësishëm më tepër në krijimin e lidhjeve tregtare me partnerët nga bota e jashtme por ende ka mbetur ne suazat e një institucioni tradicional me antarsim të obligueshëm. Shoqatat e afaristëve (biznesmenve dhe ndërmarrësve) kanë filluar të riaktivizohen, mirëpo ato enda kanë një numer modest antarësh dhe gjithashtu kapacitete të pamajaftueshme menagjeriale për të realizuar funksionet e lobimit dhe advokacionit për interesa të komunitetit të biznesit.

Anketa e përmendur tregon se vetëm 49 % e ndërmarrjeve janë antarë të asociacioneve të biznesit, ndërsa 77% shprehin pakënaqësi lidhur me aktivitetin e këtyre asociacioneve dhe mënyrës së organizimit të tyre. Kërkesat më të mëdha ndaj asociacioneve janë lidhur me :

- asistencë profesionale
- informimi
- advokimi dhe lobimi
- edukimi për biznesit

Gjithashtu ekziston një pakënaqësi mjaft e shprehur lidhur me atë se si bizneset janë prezentuar në media. Rreth 85% e ndërmarrësve të anketuar konsiderojnë se biznesi nuk i është prezentuar në mënyrë të mjaftueshme në media.

Forcimi i komunitetit të biznesit dhe i rolit të tij në shoqëri ka rëndësi shumë të madhe për dinamikën, strukturën dhe cilësinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe gjithashtu për forcimin e një segmenti shumë të rendësishëm të shoqërisë civile. Në shumë vende të tranzicionit një pjesë e konsiderueshme e asistencës teknike ka qenë e orientuar pikrisht në forcimin e asociacioneve të biznesit.

Në Kosovë kjo mbetet të bëhet në periudhen para nesh. Projekti i FKSHC me Agjencinë Europiane për Rindërtimin dhe projektet e mbështetura nga USAID pritet të të krijojnë mundësi të reja dhe më të mira për këtë.

RRJEDHAT DEMOGRAFIKE NË KOSOVË DHE SHOQËRIA CIVILE

Në kushtet e pavolitshme shoqëro-historike e politike dhe moszhvillimit ekonomik e kulturor për një kohë të gjatë, në Kosovë u formua një kompleks mjaft karakteristik socialo-demografik, e që deri vonë ishte territorialisht mjaft homogjen, me të gjitha konturat e shoqërisë paraindustriale, ku si profesion dhe mënyrë dominante e jetës ishte bujqësia ekstensive dhe natyrale, ndërsa analfabetizmi si përcjellës shekullor i shqiptarëve ishte në nivel shumë të lartë, sidomos te popullata femërore. Përtëritja biologjike e popullsisë ishte shumë joracionale, sepse ekuilibri demografik midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish për shkak të vdekshmërisë së lartë, sidomos të foshnjave. Në anën tjetër, moszhvillimi shoqëro-ekonomik i Kosovës, veçanërisht mungesa e industrializimit u manifestua në ndryshimet e ngadalshme në rishtrirjen e popullsisë (migrimet) dhe në mobilitetin e vogël social dhe profesional të popullsisë, që ndikuan në koncentrimin e vogël demografik dhe në moszhvillimin e qyteteve dhe të mënyrës urbane të jetës. Megjithë transformimet e konsiderueshme populative, Kosova edhe sot paraqet transicionin e fundit demografik në Evropë, me normë më të lartë të fertilitetit, me strukturë shumë të re të popullsisë (mosha mesatare rreth 26 vjet) dhe me rreth 50% të popullsisë deri në 19 vjet. Prej gjithsej 1445 vendbanimeve, vetëm 26 sish i përkasin tipit urban, ndërsa rreth 65% e popullsisë jeton në fshat. Koncentrimi i popullsisë në qytete pas kthyerjes së shqiptarëve nga deportimet që i bënë serbët, do të jetë i përkohshëm, deri sa të bëhet rindërtimi i shtëpive të shkatërruara dhe normalizimi i jetës në vendbanimet rurale.

1. FAKTORI DEMOGRAFIK SHQIPTAR DHE IRRACIONALITETI SERB

Deri në fund të viteve të 60-ta Serbia dhe Jugosllavia e Dytë nuk treguan ndonjë interes që Kosova dhe shqiptarët si popull shumicë të zhvillohen ekonomisht dhe të përfshihen në të gjitha rrjedhat e zhvillimit shoqëror dhe të emancipimit kulturor. Preokupimi kryesor i shtetit të atëhershëm jugosllav deri në këto vite ishte që çështja e shqiptarëve të zgjidhej me shpërnguljen e tyre në rajonet feudale të Turqisë dhe me asimilim, duke ushtruar mbi ta një presion dhe dhunë të fuqishme gjatë viteve të 50-ta e të 60-ta. Politika ekonomike dhe veçanërisht politika e investimeve ishte plotësisht në funksion të përbushjes së interesave të Serbisë dhe të ish-Jugosllavisë (thëngjilji, plumbi, zinku, nikeli, fuqia punëtore etj.). Kosova në planin ekonomik gjithnjë kishte pozitë të një kolonie, ndërsa deri në hyrjen e forcave ndërkombëtare më 12 qershor 1999 paraqiste shembullin më tipik të kolonisë dhe okupimit klasik.

Vëllimi i lindjeve, mosha e re, rritja demografike dhe shtrirja e pakëputur etnike e shqiptarëve kaherë u bënë faktor shqetësues për qarqet politike, shtetërore, kishtarë dhe shkencore të ish-Jugosllavive dhe mbi të gjitha të Serbisë. Akuzat ndaj faktorit demografik të shqiptarëve u rritën sidomos pas vitit 1981, ku në kuadër të fushatës së gjerë kundër Kosovës dhe shqiptarëve diskursi zhvillohej në mungesë të plotë të gjykimit racional dhe problemet demografike të shqiptarëve, veçanërisht nataliteti, nuk shtroheshin me qëllim të humanizimit të raporteve midis gjinive, përmirësimit të cilësisë së riprodhimit biologjik, ruajtjes së shëndetit të femrës apo të ngritjes së standardit jetësor të shqiptarëve, por për arsye të frikës nga një bashkësi etnike e konfesionale, që nuk është me origjinë jugosllave, sllave dhe ortodoksiste. Shqiptarofobia mori përmasa aq të mëdha sa që shqiptarët nisën të numërohen: qarqet e përmendura shihnin kinse rrezikimin e hapësirës serbo-jugosllave dhe prosperitetin gjeodemografik, kombëtar, politik dhe ekonomik të sllavëve të jugut, në një

anë, dhe gjoja krijimin e "Kosovës etnikisht të pastër" dhe "Shqipërisë së Madhe".

Ish-shteti, duke financuar segregacionizmin dhe aparatin represiv ndaj shqiptarëve, vazhdoi të angazhohej haptazi për mposhtjen e epërsisë numerike dhe reproduktive të shqiptarëve dhe të vënies së baraspeshës etnike përmes kolonizimit të serbëve dhe dëbimit të shqiptarëve. Ky shtet propozoi një varg masash administrative dhe antisociale për zvogëlimin radikal të lindshmërisë të shqiptarët, sikurse në Indi, Kinë etj., me elemente të qarta të dhunës dhe në kundërshtim me të drejtat elementare njerëzore mbi vendosjen e lirë për numrin e pasardhësve dhe intervalin kohor midis lindjeve dhe ndjenjave, arsyt dhe vullnetin e njerzëve. E gjithë shoqëria serbe, me përkrahjen e ish-njësisve tjera federale, në mitingjet populliste-nacionaliste, ku bëhej mobilizimi etnik i masave serbe, nxiste parulla me përmbajtje krejtësisht neomaltusianiste, shoviniste, raciste e gjenocidale, si p. sh. "Shqiptarët shumohen shumë, por farën e kanë të prishur", "Shqiptarët duhet dëbuar përtej Bjeshkëve të Nemuna", "Shqiptarët duhet vrarë" etj. Lufta kundër faktorit demografik shqiptar u bë pjesë përbërse e strategjisë antishqiptare. Në të gjitha synimet dhe projektet serbe të shek. XX, plleshmëria e fëmërs shqiptare konsiderohej si pengesa më e madhe për rrënimin e substancës demografike shqiptare dhe realizimin e aspiratave shtetomëdha serbe. Serbia dhe të gjitha Jugosllavitë e dëshironin edhe Kosovën e kolonizuar nga serbët, edhe Kosovën e pazhvilluar dhe më normë të lindshmërisë të tipit evropian për shqiptarët. Mirëpo, këto dy qëllime, natyrisht, nuk shkonin së bashku.¹

1) H. Islami, "Demografska stvarnost Kosova", në: Sukob ili dojalog (zbornik radova), Subotica, 1994, ff. 29-51; H. Islami, Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës, Enti i Teksteve i Kosovës, Prishtinë, 1997, ff. 73-74, 191-194.

2. KOMPONENTET E LËVIZJES NATYRORE TË POPULLSISË

Në rrjedhat e ndryshimeve intensive shoqëro-ekonomike, vonë e ngadalë, u përfshinë sektorët kyç të riprodhimit biologjik të popullsisë: femra si faktor kryesor i përtëritjes biologjike; familja si suazë vendimtare e procesit të lindjes, amësisë dhe si bartëse e shumë funksioneve socioalo-ekonomike; dhe fshati si strukturë dominante në shoqërinë kosovare. Mirëpo, pas viteve të 60-ta, industrializimi inicial, urbanizimi dhe proceset e tjera të zhvillimit shoqëror, duke zbërthyer strukturën relativisht homogjene socioekonomike të Kosovës, ndikuan në zvogëlimin e natalitetit,² dhe diferencimin e tij në pikëpamje territoriale dhe sociale. Edhe në shembullin e popullatës kosovare, të dhënat tregojnë se lëvizja e natalitetit, duke u thyer nëpër prizmin e stratifikimit shoqëror, nuk është etnikisht dhe konfesionalisht i determinuar, e as e lidhur me veçori ataviste apo ideologji nacionaliste. Në vitin 1981, një femër kosovare (kohorta 45-49 vjet) aktive në jetën ekonomike kishte lindur 3,07 fëmijë, ndërsa ajo e mbajtur 5,49 fëmijë; femra e mbajtur në bujqësi kishte lindur

2) Kthesa e madhe në zvogëlimin e numrit absolut dhe relativ të të lindurve midis viteve 1990 dhe 1992, veçanërisht midis viteve 1991 dhe 1992, ndodhi si rezultat i shpërnguljes së të rinjve shqiptarë në vendet perëndimore, por edhe me ndikimin e një varg variabla të karakterit politiko-psikologjik dhe sociopsikologjik, siç janë frika nga lufta rreth Kosovës, ndjenja e pasigurisë sociale dhe komponenteve të tjera të krizës materiale dhe psikologjike, kur një numër i konsiderueshëm i të rinjve kishte shtyer themelimin e bashkësive martesore, ndërsa shumë çiftë bashkëshortorë me vetëdije kishin vendosur për t'i shtryer lindjet e dëshiruara të fëmijëve. Mirëpo, një ndër faktorët me rëndësi që ka ndikuar në këtë zvogëlim është edhe përfshirja jo e plotë e të gjitha rasteve të lindjeve dhe vdekjeve, sidomos të foshnjave, që në statistikën demografike njihet si nënregjistrim i këtyre ngjarjeve. Nënregjistrimi lidhet pikërisht me shkëputjen e shqiptarëve nga institucionet serbe dhe formimin e institucioneve të tyre, me mosbesimin në institucionet shtetërore dhe civile të Serbisë, të cilat në Kosovë, pas përjashtimit të shqiptarëve nga puna në vitin 1990, i udhëhiqnin serbët (Shih më gjerë: H. Islami, Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës, ff. 45-48).

6,74 fëmijë, kurse femra aktive në profesionet jobujqësore 2,74 fëmijë; femra analfabete dhe pa përgatitje shkollore kishte lindur 7,04 fëmijë, me shkollë të mesme 2,24 dhe me arsim superior 2,18 fëmijë.³

Dallimet në normën e natalitetit janë evidente edhe midis pjesëtarëve të nacionalitetit dhe konfesionalitetit të njëjtë, por që jetojnë në territore me shkallë të ndryshme të zhvillimit. Në pesë decaeniet e fundit p. sh., normë më të lartë të natalitetit serbët kishin në Kosovë dhe B e H, malazezët në Mal të Zi (deri vonë edhe në Kosovë), boshnjakët në rajonin e Sanxhakut, kroatët në B e H dhe në Kosovë, ndërsa shqiptarët në të gjitha rajonet e ish-Jugosllavisë, meqenëse ishin të pazhvilluara në çdo pikëpamje.⁴ Femrat serbe në fund të periudhës riprodhuese kishin 3,42 fëmijë, në B e H 2,81, në Kroaci 2,02, në Vojvodinë 1,87, në Serbi 1,85 dhe në Slloveni 1,65 fëmijë, ndërsa femrat malaziasë gjatë periudhës së tyre riprodhuese kishin lindur gjithsej: në Kosovë 3,16, në Mal të Zi 2,98, në Maqedoni 2,59, në Serbi 2,12, në B e H 2,05, në Slloveni 1,98, në Vojvodinë 1,99 dhe në Kroaci 1,84 fëmijë. Në vitin 1981 femrat shiptare, që e kishin përfunduar periudhën e përtëritjes biologjike, kishin 6,66 fëmijë në Kosovë, në Maqedoni 5,60, në Serbi 5,75 dhe në Mal të Zi (për shkak të shpërnguljes së të rinjve) 4,43 fëmijë, ndërsa në Slloveni femrat tona kishin lindur 3,07, në Kroaci 3,56 dhe në B e H 4,29 fëmijë.⁵ Ose, në vitin 1991 norma e fertilitetit të përgjithshëm te femrat serbe të moshës 45-49 vjet në Kosovë ishte 2,8, ndërsa në Serbi 1,8 fëmijë.⁶ Te femrat shqiptare, edhe përkundër shkallës së ulët të aktivitetit ekonomik dhe arsimit, rënia e fer-

3) G. Todorovic, "Dejstvo aktivnosti i obrazovanja zene na njeno radjanje i stav o njemu na podrucju SR Srbije", Stanovništvo, br. 1, Centar za demografska istrazivanja, Institut drustvenih nauka, Beograd, 1984/85, f. 58.

4) Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti, Centar za demografska istrazivanja, Institut drustvenih nauka, Beograd, 1978, ff.27-31.

5) Demografski razvoj i populaciona politika SAP Kosova (interna studija), Centar za demografska istrazivanja, Institut drustvenih nauka, Beograd, 1988, f. 62.

6) G.Penev, "Tendencije i osobine fertiliteta", në publikimin Zena i radjanje na Kosovu i Metohiji, Centar za demografska istrazivanja, Institut drustvenih nauka, Beograd, 1998, ff. 17-22.

tilitetit në gjysmën e dytë të shek. XX është e madhe në të gjitha kohortat e moshës, me intensitet të theksuar nga fundi i periudhës prokreative. P. sh., fertiliteti te kohorta e grave 45-49 vjet në vitin 1995 është 40 herë më i ulët në raport me vitin 1950.⁷

Nga gama e gjerë e faktorëve biologjikë, socialë, ekonomikë etj., reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar, që ndikojnë në lëvizjen dhe nivelin e lindshmërisë, aktiviteti ekonomik, punësimi dhe arsimimii femrës janë ndër faktorët më kryesorë që determinojnë jo vetëm ndryshimet në sjelljen riprodutive, por edhe pozitën e gjithëmbarshme të femrës dhe rolin e saj në raportet familjare dhe në shoqëri. Mbi këtë bazë krijohen supozimet objektive për motivacione dhe vetëdije të re për përqafimin e kontrollit të lindjes në martesë si “stil” të jetës dhe ndryshimin e regjimit të riprodhimit.⁸

Tabela 1. Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës prej 1950 deri 1997⁹

Viti	Numri i të lindurve	Në 1000 banorë	Numri i të vdekurve	Në 1000 banorë	Shtimi natyror	Në 1000 banorë
1950	35.222	46,1	12.991	17,0	22.321	29,1
1960	41.631	44,1	13.365	14,2	28.266	29,5
1970	44.496	36,1	10.829	8,9	33.667	27,6
1980	53.147	34,2	8.909	5,7	44.238	28,5
1990	55.175	27,8	8.214	4,1	46.961	23,6
1991	52.193	26,6	8.526	4,3	43.737	22,2
1992	44.418	22,1	8.004	4,0	36.414	18,1
1993	44.132	21,6	7.804	3,8	36.328	17,8
1994	43.450	20,9	7.667	3,7	35.738	17,2
1995	44.776	21,3	8.078	3,9	35.698	17,2
1996	46.343	21,4	8.392	3,9	37.951	17,2
1997	43.411	19,8	8.275	3,8	34.136	16,0

7) H.Islami, Evolucion i dhe transicioni demografik, Dukagjini, Pejë, 1999, f.132.

8) R.Reedman, “Fertility Determinants”, në publikimin J.Cleland and C. Scoot (eds.), The World Fertility Survey, an assesment, Clarendon Press, Oxford, 1987; D.Breznik, Stanovništvo Jugoslavije, Chronos, Titograd, 1991, ff. 45-94.

9) Vjetari Statistikor i KSA të Kosovës, XIV, Enti Krahinor i Statistikës, Prishtinë, 1989, f. 27; Statisticki godisnjak Jugoslavije, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1984, ff. 438-439; Demografska statistika 1990, SZS, Beograd, 1992, ff. 27, 32; Saopštenje saveznog zavoda zastatistiku, br.052, Beograd, 24.02.1998, ff. 6-11.

Ndryshimet janë të dukshme edhe në lëvizjen e mortalitetit të përgjithshëm, ku, përveç faktorëve socialë, materialë dhe shëndetësorë, ka ndikuar edhe vetë faktori demografik, përkatësisht struktura e re e popullsisë. Ndërkaq vdekshmëria infantile, e cila në zhvillimin e popullatës shqiptare ishte shprehje e drejtpërdrejtë e gjendjes së saj të përgjithshme të pavolitshme, ndonëse mjaft është zvogëluar, megjithatë vëllimi relativ dhe absolut i saj ende paraqet një problem të madh shëndetësor, demografik, human dhe shoqëror në përgjithësi. Me përjashtimin e punëtorëve shqiptarë nga institucionet e shëndetësisë publike në vitin 1990, gjendja ishte keqësuar edhe më tepër, kështu që këto vitet e fundit (deri në hyrjen e forcave ndërkombëtare në qershor të vitit 1999) shkalla e mortalitetit të foshnjave supozohet të ishte mbi 35 promila. Është thelluar edhe raporti i shkaqeve të vdekjes së foshnjave në favor të faktorëve ekzogjenë (mortaliteti postneonatal).¹⁰

3. DINAMIKA E RRIJES SË POPULLSISË

Edhe përkundër proceseve intensive emigruese dhe rrethanave të tjera të pavolitshme në periudha të caktuara shoqëro-historike, një nga veçoritë kryesore të zhvillimit të popullsisë së Kosovës për një kohë të gjatë është rritja e numrit të saj si rezultat i normës së lartë të natalitetit, zvogëlimit të mortalitetit dhe shkalls së lartë të shtimit natyror. Popullsia e Kosovës për këto 100 vjetët e fundit rritet për më se 600%. Në vitin 1880 vlerësohet se Kosova kishte rreth 240.000 banorë.¹¹ Në procesin e "bumit demografik" Kosova hyri në vitet e 60-ta, i cili si në pikëpamje të rritjes absolute, ashtu edhe të asaj relative është deri atëherë më i fuqishëm (Tabela 2). Në periudhën 1961-1991 popullsia e Kosovës rritet për 1.054.512 banorë, që do të thotë dyfishimin e saj për më pak se 30 vjet.

10) H. Islami, "Aspekti sociodemografik i mortalitetit të popullsisë së Kosovës", Thema, 14, Prishtinë, 1996, ff.83-106.

11) The Population of Yugoslavia, The Demographic Research Center, Institute of Social Sciences, Belgrade, 1974, p. 11.

Mirëpo, duhet theksuar se në të gjitha periudhat midis regjistrimeve të popullsisë rritja e numrit të popullsisë është më e vogël se shumia e shtimit natyror, që nënkupton se emigrimi ka gëlltitur një pjesë të konsiderueshme të këtij shtimi dhe saldoja migruese ka qenë negative. Në vitin 1991 (vlerësimi) Kosova kishte rreth 2 milionë banorë, ndërsa sot, llogaritur sipas konceptonit të popullsisë së përhershme apo rezidenciale (population résidente), ka rreth 2.400.000 banorë.

Tabela 2. Rritja e popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-1991¹²

Viti	Numri i popullsisë	Rritja në periudhat midis regjistrimeve		
		Periudha	Numri absolut	%
1948	733.034	1948-1953	83.874	11,4
1953	816.908	1953-1961	147.080	18,1
1961	963.989	1961-1971	279.705	29,0
1971	1.243.693	1971-1981	340.747	27,3
1981	1.584.440	1981-1991	434.060	27,0
1991	2.018.500	1948-1991	1.285.466	175,0

4. PËRPARËSITË DHE PROBLEMET E STRUKTURËS SË RE TË POPULLSISË

Ndër veçoritë e posaçme të zhvillimit demografik të Kosovës dhe të shqiptarëve është pikërisht përbërja e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë, që janë formuar si rezultat i ndikimit të shumë determinanteve demografike dhe socioekonomike. Shqyrtimi dhe analiza e përbërjes së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë nga aspekti i kontigjenteve të rëndësishme funksionale të saj, ka rëndësi të veçantë si për gjendjen dhe evolucionin e këtyre kontigjenteve gjatë një periudhe 40-vjeçare (1953-1991), ashtu edhe për ecuritë e

12) Burimi: për vitet 1948-1981 regjistrimet zyrtare, ndërsa për vitin 1991 vlerësimi.

ardhshme të tyre dhe të zhvillimit demografik dhe shoqëro-ekonomik në përgjithësi. Pa komentime të hollësishme, për disa arsye, po japim një paralele midis Kosovës dhe Serbisë, ku jo vetëm që dalin në shesh dallime të mëdha sa i përket disa kontingjenteve funksionale në popullsinë e tyre të gjithmbarshme në periudhën e përmendur, por edhe ndryshimet janë zhvilluar në drejtime krejtësisht të kundërta. Këto raporte flasin njëkohësisht edhe për pozitën populative dhe gjeopolitike të këtyre dy entiteteve sot dhe në të ardhmen.

Rënia e normës së natalitetit ka ndikuar që në Kosovë të zvogëlohet përqindja e kontingjentit 0-6 vjet në numrin e përgjithshëm të popullsisë, mirëpo numri i fëmijëve të kësaj moshe është dyfishuar në periudhën 1953-1991. Në Serbi, ndërkaq, shënohet rënie e konsiderueshme edhe e numrit relativ, edhe e numrit absolut të kontingjentit parashkollor, kështu që Serbia në të ardhmen do të ketë tepriçë të madhe të hapësirës shkollore. Zatën, këto 30 vjetët e fundit, që kur ka nisur të zvogëlohej numri i lindjeve, në shumë mjedise të Serbisë, sidomos në ato fshatare, nuk ka pasur nevojë të ndërtoheshin shkolla fillore. Ndërsa, sa i përket kontingjentit të shkollimit të obligueshëm në Kosovë vërehet një tendencë e rritjes së fuqishme (për 151%), ndërsa në Serbi që nga fillimi i viteve të 60-ta shënohet zvogëlim relativ dhe absolut i këtij kontingjenti. Këto kontingjente të popullsisë, me këtë vitalitet, duke pasur parasysh varshmërinë reciproke midis përbërjes së popullsisë sipas moshës dhe proceseve të tjera demografike dhe sociale-ekonomike, natyrisht krijojnë efekte të ndryshme në rrafshin demografik (vëllimi i lindjeve) dhe shtrojnë kërkesa të shumëfishta në jetën shoqërore-ekonomike në kontekst afatgjatë kohor (punësimi, shkollimi, mbrojtja shëndetësore, entet parashkollore etj.).

Tabela 3. Kontingjentet e rëndësishme funksionale të strukturës së popullsisë sipas moshës dhe gjinisë në Kosovë dhe në Serbi¹³

		1953		1991	
		Numri	%	Numri	%
Kontingjenti parashkollor (0-6 vjet)	Kosova	182.525	22,4	364.007	18,6
	Serbia	665.680	14,9	485.370	8,5
Kontingjenti i shkollimit të obligueshëm (7-14 vjet)	Kosova	145.647	17,9	366.522	18,8
	Serbia	564.667	12,7	615.116	10,8
Popullsia fertile femërore (15-49 vjet)	Kosova	183.464	22,5	457.588	23,4
	Serbia	1.235.479	27,7	1.382.061	24,2
Femrat në periudhën optimale riprodhuese (20-34 vjet)	Kosova	85.509	10,5	228.921	11,7
	Serbia	621.689	13,9	577.995	10,1
Kontingjenti i punës (15-64/m dhe 15-59/f)	Kosova	434.839	53,3	1.110.952	56,9
	Serbia	2.894.278	64,6	3.752.966	65,6
Kontingjenti i parë Mobilizues (18-34 vjet/m)	Kosova	104.731	12,8	296.111	15,2
	Serbia	686.590	15,4	661.798	11,6
Kontingjenti i moshuar (80 e më tepër vjet)	Kosova	7.313	0,9	16.701	0,9
	Serbia	30.971	0,7	116.212	2,0

Popullsia fertile femërore në Kosovë gjatë gjithë periudhës pas Luftës II Botërore ka shënuar rritje, më pak relative e shumë më tepër sa i përket numrit absolut (prej 1953-1991 për 149,4%), sikundër që është rritur kontingjenti i femrave në moshën optimale riprodhuese (për 167,7%). Kjo do të thotë se megjithë rënien e konsiderueshme të lindshmërisë këto vitet e fundit, më tepër si pasojë e emigrimit të rinjve, popullsia kosovare do të riprodhohej në të ardhmen në vëllim të kënaqshëm, sigurisht mbi përtëritjen e thjeshtë. Në Serbi, përkundrazi, që të dy kontingjetet riprodhuese deri nga gjysma e viteve të 60-ta janë rritur, ndërsa pas këtyre viteve, absolutisht dhe relativisht, janë në rënie.

Kontingjenti i punës në periudhën 1953-1991 në Kosovë është rritur për më se dy herë e gjysmë. Mirëpo, për shkak të strukturës relativisht të re të popullsisë përqindja e këtij kontingjenti në popullsinë e përgjithshme në dy vitet e vështruara është nën atë të Serbisë, ndonëse ka shënuar rritje prej 53,3% më 1953 në 56,9% më 1991. Ndërkaq në Serbi deri nga fundi i viteve të 70-ta ky kontingjent funksional është

13) Burimi: Rezultatet e regjistrimit të popullsisë 1953 dhe për Serbinë rezultatet e vitit 1991; për Kosovën për vitin 1991 vlerësimi (Razvitak stanovnistva Srbije 1950-1991, Beograd, 1995, f. 110).

rritur, kurse pastaj ka shënuar rënie të madhe për arsye të procesit intensiv të moshënimit demografik; në periudhën 1981-1991 është zvogëluar prej 682.650 në 577.995 persona. Sa i përket kontingjentit të parë mobilizues, shumë i rëndësishëm nga aspekti i mbrojtjes së vendit, në këtë periudhë në Kosovë ndodh gati trefishimi i tij; rritje shënohet në popullsinë e gjithmbarshme madje edhe në pikëpamje relative. Në Serbi ky kontingjent funksional shënon rënie si në pikëpamje të numrit, ashtu edhe të përqindjes në popullsinë e përgjithshme. Derisa në Kosovë kontingjenti mbi 80 vjet, me gjithë rritjen për 128,3% në periudhën 1953-1991, është mjaft i ulët në pikëpamje absolute dhe relative, ndërkaq në Serbi është në rritje ekspansive si pasojë e moshënimit të popullsisë së saj. Ndonëse sot nuk kemi të dhëna të të gjitha këtyre kontingjernteve në Kosovë dhe në Serbi, mund të supozohet se raportet absolute dhe relative jo vetëm që janë ruajtur midis këtyre dy entiteteve, por edhe janë thelluar.

5. KOMPOZICIONI ETNODEMOGRAFIK I KOSOVËS

Pasqyra etniko-demografike e Kosovës tashmë më tepër se një shekull është bërë objekt manipulimi e spekulimi i të gjitha qarqeve serbe dhe jugosllave. Për t'i jetësuar aspiratat shekullore për dominim dhe hegjemoni ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, këto qarqe, përveç me të ashtuquajturën "të drejtë historike", po spekulojnë pandërprerë edhe me "argumentin demografik" me qëllim që Kosova të kundrohet si "çështje ekskluzivisht serbe", ndërsa shqiptarët të privohen edhe nga të drejtat e tyre historike, edhe të drejtat e tyre aktuale, dhe atë jo vetëm për të vendosur vetë për fatin e tyre, por edhe për të jetuar në Kosovë! Mirëpo, rezultatet e hulumtimeve albanologjike dhe ballkanologjike, regjistrimet kadas-trale turke ose defterët (që ofrojnë të dhëna të bollshme të karakterit demografik, social dhe etnik), vetë dokumentet e shumta mesjetare të monumenteve ligjore serbe (krisobulat, dhuratat etj.), raportet e ndryshme të misionarëve të propa-

gandës Fide në Romë, shënimet e udhëpërshkruesve të ndryshëm, pjesëmarrja masive e shqiptarëve në luftërat e shumta para shek. XVII dhe XVIII, duke përfshirë edhe Luftën e Kosovës (1389) etj., tregojnë se shqiptarët kanë dominuar në të gjitha periudhat historike. Ndërkaq, në bazë të të dhënave të të gjitha statistikave zyrtare serbo-jugosllave në shek. XX, popullata shqiptare gjithashtu përbënte shumicën dërmuese. P. sh., sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1921, edhe përkundër shumë dobësive në dëm të shqiptarëve, megjithatë në bazë të gjuhës amtare shqipe (arnautski, siç e quanin), shqiptarët përbënin 65,8% të popullsisë së gjithëmbarshme të Kosovës (439.010 banorë), ndërsa grupacioni i gjuhës serbokroate përbënte 25,9% dhe i asaj turke 6,3%.¹⁴ Tabela 2 tregon evolucionin e strukturës së popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-1991 sipas regjistrimeve zyrtare, ku më 1991 jetonin 360.124 pjesëtarë të bashkësive etnike joshqiptare.

14) Prethodni rezultati Popisa stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenaca 31. januara 1924, Drzavna stamparija, Sarajevo, 1924, ff.3-24; Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47, Savezni zavod za statistiku - Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 205.

Tabela 4. Përbërja kombëtare e popullsisë së Kosovës, sipas regjistrimeve të popullsisë 1948-1991¹⁵

	1948	1953	1961	1971	1981	1991
Shqiptarë	498.242 68,5	524.559 64,9	646.605 67,2	917.167 73,7	1.226.736 77,4	1.596.072 81,6
Serbë	171.914 23,6	189.869 23,5	227.016 23,6	228.261 18,4	209.497 13,2	194.190 9,9
Malazezë	28.050 3,9	31.343 3,9	37.588 3,9	31.555 2,5	27.028 1,7	20.365 1,0
Bosnjakë	6.679 1,3	6.241 0,8	8.026 0,8	26.351 2,1	58.562 3,6	66.189 3,4
Turq	1.315 0,2	34.583 4,3	25.764 2,7	12.244 1,0	12.513 0,7	10.445 0,5
Romë	11.230 1,5	11.904 1,5	3.202 0,3	14.593 1,2	34.126 2,1	45.745 2,3
Kroatë	5.290 0,7	6.201 0,8	7.251 0,8	8.263 0,7	8.718 0,6	8.062 0,4
Jugosllavë	1000 0,0	1000 0,0	5.206 0,5	920 0,0	2.676 0,1	3.457 0,2
Të tjerë	11.100 1,5	10.999 1,3	3.330 0,3	4.338 0,3	4.585 0,3	11.671 0,6
Gjithësej	733.820 100,0	815.798 100,0	963.988 100,0	1.243.693 100,0	1.584.440 100,0	1.956.196 100,0

6. PASTRIMI ETNIK I KOSOVËS DHE KOLONIZIMI I SAJ

Qëllimi kryesor i të gjitha regjimeve serbe në 120 vitet e fundit ishte ndërrimi i përbërjes etnike të Kosovës dhe viseve rreth saj përmes kolonizimit të serbëve dhe shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve. Midis dy luftërave botërore u shpërngulën në Shqipëri rreth 50.000 shqiptarë dhe në Turqi rreth 240.000 shqiptarë në kuadër të marrëveshjes së Jugosllavisë me qeverinë turke,¹⁶ ndërsa është bërë kolonizimi i më se

15) Burimi: Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u 1981. godini. Nacionalni sastav stanovništva po optinama, Statistički bilten 1295, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 16; Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema popisu 1991, Stanovništvo 47, Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 213.

16) Konvencija sa Turskom o iseljavanju iz Juzne Srbije muslimanskog stanovništva, DASIP, Beograd: Poslanstvo u Turskoj, F. 31. D/9 pov., 1939; "Konventa jugosllavo-turke u vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve", Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave historike, XII, Prishtinë, 1982, ff. 342-271.

11.000 familjeve serbe, me rreth 54.000 anëtarë dhe 12.000 kolonistë të tjerë të rëndomtë. Kolonistëve iu dha toka e marrë nga shqiptarët e varfër; më se 200.000 ha tokë iu nda jo vetëm kolonistëve, por edhe kishave dhe manastireve, ushtrisë, xhandarmërisë, çetnikëve, optantëve, komunarëve, shkollave bujqësore dhe ekonomive serbe etj.¹⁷ Pas Luftës II Botërore, gjithashtu në kuadër të marrëveshjeve të fshehta midis Jugosllavisë dhe Turqisë, nga Kosova dhe viset përreth, të banuara me shqiptarë, u shpërngulën rreth 250.000 veta në Turqi,¹⁸ ndërsa numri i imigrantëve serbomalazezë sillej rreth 50.000 veta.¹⁹

Nga fillimi i viteve të 80-ta ideja mbi kolonizimin e Kosovës përsëri u aktualizua dhe gjeti mbështetje të gjitha strukturat shtetërore dhe partiake të ish-Jugosllavisë dhe filloi realizimi i saj përmes të ashtuquajturit Program jugosllav për Kosovën. Pas viteve të 90-ta, pushteti serb, me pajtimin e të gjitha partive politike, nxjerrë projekte dhe ligje të reja për kolonizim, të cilat nuk dhanë rezultate të kënaqshme. Prandaj, shteti policor dhe militarist serb vendosi që këto synime t'i realizojë me shpërnguljen e një numri sa më të madh të shqiptarëve, veçanërisht të të rinjve, duke ushtruar mbi ta terror të vërtetë.²⁰ Duke dëshiruar që politikën kolonizuese ta bënte sa më efikase, Serbia nga gjysma e viteve të 90-ta ndërmerr disa aktivitete institucionale. Në vitin 1991 Kuvendi i Serbisë nxjerr ligjin mbi kushtet e ndarjes së tokave bujqësore në Kosovë;

17) M. Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Istorijski institut, Pristina, 1981, ff. 221-222.

18) P. Nushi, "Karakter i osobenosti prilaza izucavanju iseljenistva naroda i narodnosti Pokrajine Kosovo", në librin *Iseljenistvo naroda i narodnosti Jugoslavije*, Zagreb, 1978. f.586.

19) H. Islami, *Rrjedha demografike shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 1994, f.69.

20) Krahës shpërnguljes së shqiptarëve pas vitit 1991, regjimi serb nisi ta kolonizojë Kosovën me refugjatë-kolonë nga Kroacia dhe BeH, përkundër dëshirës së tyre, numri të cilëve ishte rreth 10.000 sish dhe me serbomalazezë nga Shqipëria (rreth 6.000), ndërsa pas ofansivës kroate "Stuhia" të 5 gushtit 1995, në Kosovë u sollën afër 20.000 serbë, gjithashtu pa dashje (H. Islami, "Kolonizimet serbe të Kosovës dhe eksodi i shqiptarëve", *Studime*, 2, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1995, ff.39-45).

nga fondi i tokave, që do të formohej nga tokat komunale, tokat e organizatave bujqësore dhe nga tokat që do t'i falnin personat juridikë dhe fizikë, me këtë ligj parashihej që kolonëve t'u jepej toka falas, ndërsa për ndërtimin e shtëpive do të jepeshin kredi me kushte shumë të volitshme me afat kthimi prej 25 vjetësh. Në janar të vitit 1995 Serbia nxjerr një dekretligj, ku paralajmërohet vala më e rëndësishme e kolonizimit prej 100.000 kolonëve; sipas këtij dekretligji kolonëve do t'u ofroheshin kredi me kushte shumë joshëse për ndërtimin e shtëpive, vende të punës dhe shumë beneficione të tjera. Po në këtë vit Serbia nxjerr ligjin kadastral mbi rregullimin e pronave të paluajtshme që nga viti 1945, kinëse për të vërtetuar pronësinë e vërtetë mbi patundshmëritë e qytetarëve të Kosovës dhe për t'i korriguar gabimet eventuale. Ata që nuk posedojnë dokumentacionin e duhur nuk do të mund të fitonin të drejtën e patundshmërisë në librat kadastrale. Kur dihej se pushteti serb u kishte bërë shumë pengesa shqiptarëve në zgjidhjen e problemeve pronësore-juridike, ishte e qartë se këta "qytetarë" ishin shqiptarët. Me këto ligje mbi pronësinë, pos qëllimit të vërtetë, tentohej të krijoheshin tensionime të reja, meqenëse me marrjen e tokave e të pronave të tjera të paluajtshme, shqiptarët jo vetëm që do të goditeshin në bazën ekzistenciale, por edhe në rrafshin emocional dhe individual-psikologjik, ku mund lehtë të provokoheshin.

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës (mars 1989) dhe së bashku me të edhe rrënimi i të gjitha institucioneve politike, administrative, ekonomike, sociale, kulturore dhe shëndetësore përjashtimi masiv i punëtorëve pas grevës së 3 shtatorit 1990 etj., shihej qartë se nuk ishte fjala për një pushtet që kishte si synim vetëm okupimin, kolonizimin dhe vënien e sistemit kolonialist në Kosovë, por kishte për qëllim degradimin sistematik të shqiptarëve, varfërimin, rrezikimin e ekzistencës biologjike dhe shpërnguljen e tyre. Vitet më të rënda për shqiptarët e Kosovës pa dyshim janë vitet 1998 dhe 1999, kur Serbia, në sytë e gjithë botës, idetë dhe synimet e kahmotshme ndaj shqiptarëve i shndërroi në gjenocid faktik: sipas të dhënave jo të plota, rreth 15 mijë shqiptarë civilë, ku kishte gra, fëmijë dhe pleq, u vranë, u masakruan ose u dogjën të gjallë dhe u futën në qindra varreza masive, mbi 100 mijë shtëpi, të

shtrira në rreth 1100 vendbanime, u dogjën, u rrënuan apo u dëmtuan, fshatra të tëra dhe shumë qendra urbane u shkatërruan, rreth një milion shqiptarë u deportua jashtë Kosovës me mjete të ndryshme, me trena, kamionë, autobusë, vetura, në këmbë nëpër male, gjithnjë rrugës duke u poshtruar, torturuar e dhunuar, dhe disa qindra mijëra të tjerë nën dhunë e kërcënime u ndoqën nga shtëpitë e tyre, duke bredhur brenda territorit të Kosovës.

Regjimi serb, me të gjitha mjetet u vërsul mbi identitetin dhe themelet e jetës së shqiptarëve, ku përmes deportimit masiv, që i ngjante plotësisht deportimit të çifutëve gjatë Luftës II Botërore, dhe zhdukjes së dokumentacionit (letërnjoftimet, pasaportat, regjistrat kadastrale, librat amë të të lindurve, të të kurorëzuarve dhe të të vdekurve, numrat personalë, librat e nënshtetësisë etj.) donte ta këputte çdo lidhje juridike të shqiptarëve me truallin gjeoetnik të tyre, ta rrëronte një etni, një kulturë, një shoqëri me të gjitha institucionet e saj, ta dehumanizonte njeriun e përkatësisë etnike shqiptare dhe ta shkatërronte shoqërinë kosovare me ato kontura të multietnicitetit që kishte, ku shqiptarët në strukturën etnodemografike kishin një dominim absolut. Të gjitha këto veprime, të qëllimshme e të dhunshme ndaj popullatës së etnikumit shqiptar, në kuadër të krimeve kundër njerëzimit, me të gjitha konventat ndërkombëtare, konsiderohen si krime gjenocidale, që shënojnë anën më të errët në historinë e njerëzimit dhe tragjedinë më të madhe në jetën e kombit që i ka përjetuar. Si pasojë e sjelljeve dhe veprimeve afatgjate gjenocidale serbe mbi shqiptarët, frustrimeve dhe mëllefeve të akumuluar, që te shqiptarët, pas hyrjes së forcave ndërkombëtare, shpërthyen ndaj disa serbëve, që mund të cilësohen si vepra penale aksidentale, stabilizimi i gjendjes, vendosja e një paqeje të qëndrueshme dhe krijimi i një shoqërie civile e demokratike në Kosovë është një proces afatgjatë.

Kthyerja e shqiptarëve, e një mase kaq të madhe për një kohë kaq të shkurtër, madje përkundër apeleve të bashkësisë ndërkombëtare që të mos nguten të kthehen sepse nuk ka kushte për ekzistencë, me shtëpi të shkatërruara, pa ushqim, me rreziqe të mëdha nga minat që i kishin vënë forcat serbe, megjithatë tregon se sa është e fuqishme te ata lidhja emo-

cionale për truallin gjeoetnik të tyre, për pronën e paluajtshme, për shtëpinë dhe tokën. Ishte ky një fenomen që bënte përjashtim në historinë e eksodeve masive etnike në epokën bashkëkohore, që e habiti gjithë botën, e forcoi imazhin e shqiptarëve të Kosovës dhe siguroi një simpati edhe më të madhe sesa para dhe në kohën e bombardimeve të forcave të NATO-s mbi forcat serbe. Këtë imazh, mjerisht, e prishën disa grupe të shqiptarëve me sjelljet e tyre (uzurpimet, plaçkitjet dhe kërcnimet), si vetë liderët e shqiptarëve me grindjet e tyre në luftë për pushtet, ndonëse ishte e qartë se Kosova ishte vënë nën proktektorat ushtarak dhe civil ndërkombëtar.

Pasqyra etnike e Kosovës sot ka pësuar ndryshime të konsiderueshme, ku shqiptarët përbëjnë shumicën dërmuese, mbi 90%. Së bashku me tërheqjen e forcave policore, militare dhe paramilitare serbe pas nënshkrimit të Mrrëveshjes së Kumanovës më 3 qershor 1999, siç dihet, afër gjysma e serbëve u tërhoq nga Kosova (100.000 veta) për shkak se ishin implikuar në forma të ndryshme në operacionet kriminale, ndërkaq rreth 100.000 të tjerë mbetën të jetonin në Kosovë. Aktualisht serbët jetojnë në enklava etnike, të cilat shtrihen në komunën e Prishtinës, të Gjilanit, të Kamenicës, të Shtërpçës, të Lipjanit, të Vitisë, të Novo Bërdës, si dhe në komunat serbe të Leposaviqit, të Zveçanit e të Zubin Potokut dhe në veri të qytetit të ndarë të Mitrovicës. Në qytete, ku dominojnë shqiptarët, kanë mbetur shumë pak serbë, që ruhen nga forcat ndërkombëtare. Pjesa më e madhe e tyre po u shesin shqiptarëve pronat, shtëpitë dhe banesat.

REFORMA E SISTEMIT TË ARSIMIT NË KOSOVË NJË RRUGË DREJT TË ARDHMES

1. KONTEKSTI

Çdo reformë e një sektori aq të rëndësishëm shoqëror çfarë është arsimi duhet të marrë parasysh kontekstin në të cilin zhvillohet, si kontekstin nacional, ashtu edhe atë ndërkombëtar. Kontekstin nacional e përbëjnë rrethana të ndryshme historike, gjeografike, politike, kulturore dhe ekonomike. Në rastin e Kosovës, konteksti ndërkombëtar ka një rëndësi të veçantë, e cila tejkalon trendet e përgjithshme të globalizimit që e karakterizojnë shekullin XXI.

Periodha 1990-1999 karakterizohet me përpjekjet mbijetëse të kosovarëve për të siguruar mbijetesën e sistemit të arsimit, të rrezikuar nga politika e cila shkaktoi katër luftëra në territorin e ish-Jugosllavisë. Si rezultat i mungesës të kushteve minimale për punë u regjistrua një rënie drastike e cilësisë së arsimit në Kosovë. Situata komplekse politike dhe të sigurisë dhe rënia rapide e standardit jetësor bënë që regjistrimi në të gjitha nivelet e arsimit të shënojë rënie të dukshme (shih tabelën 1), ndërsa ndërprerja e shkollimit dhe shkalla e anal-fabetizmit arritën shifra alarmante.

Tabela 1. Regjistrimi i nxënësve/studentëve në institucionet e arsimit sipas niveleve¹

Niveli i arsimit	1991/92	1995/96	1998/99	1999/00
Shkollat fillore	287,194	268,096	255,000	286,940
Shkollat e mesme	66,910	56,187	61,115	80,661
Institucionet e shkollimit të lartë	19,622	13,805	16,000 ¹	22,058
Gjithsej	373,726	338,088	332,115	389,659

Lufta e vitit 1999 shkaktoi ndërprerje të plotë të punës në institucionet arsimore, ndërsa për pasojë të drejtpërdrejtë kishte dëmtimin e pothuajse gjysmës së objekteve shkollore, shumë prej tyre seriozisht.³

Në pajtim me Rezolutën 1244 të KS të OKB, në Kosovë u instalua Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Prioritet themelor i UNMIK-ut në fazën emergjente ishte rindërtimi i sistemit të arsimit në Kosovë i cili respekton të drejtën e çdo individi për arsim, si dhe ndërtimi i një sistemi të unifikuar, jodiskriminues dhe gjithëpërfshirës të arsimit, i cili ofron mundësi për nxënie për të gjithë pavarësisht nga origjina etnike apo sociale, gjinia, feja, përcaktimi apo qëndrimi politik.⁴ Disa nga këto prioritete u jetësuan ose janë duke u jetësuar përmes veprimeve konkrete të cilat i ndërmorri ose i koordinoi UNMIK-u, e veçanërisht Departamenti për Arsim dhe Shkencë (në fillim: Departamenti për Arsim dhe Kulturë). Megjithatë, për shkak të zhvillimeve politike në Kosovë dhe në regjion, shumë pak është arritur në unifikimin e sistemit të arsimit, e veçanërisht në integrimin e pjesëtarëve të nacionalitetit serb në sistemin kosovar të arsimit.

1) Qendra për Arsim e Kosovës: Shifra dhe Fakte për Arsimin e Kosovës, Prishtinë, 2000.

2) Vlerësim (në mungesë të të dhënave të sakta)

3) UNMIK, Kosovo Reconstruction 2000

4) UNMIK, Interim Arrangements for the Resumption of School Education in Kosovo, 4/10/1999

2. PROJEKTET PËR NDIHMË ARSIMIT

Në ditët e sotme Kosovën e rëndojnë disa probleme, të cilat kanë ndikim në pothuajse të gjitha segmentet e jetës shoqërore. Nga lufta e fundit, Kosova ka dalur e dëmtuar rëndë, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në aspektin e resurseve humane. Lëvizjet e mëdha të popullatës kanë bërë pothuajse të pamundur çdo projeksion real të zhvillimit ekonomik apo të strukturës demografike. Në periudhën e paraluftës, të ardhurat bruto nacionale vlerësohen në 720 mil. dollarë⁵, gjë që e klasifikon Kosovën në radhën e vendeve më të varfëra të Evropës. Nga ana tjetër, Kosova hyn në fazën e tranzicionit me një papunësi prej rreth 70%.

Të gjithë këta faktorë flasin për rëndësinë e kontributit të donatorëve në reformimin e sistemit të arsimit, ose edhe më konkretisht, për varshmërinë e Kosovës nga donatorët në këtë fushë. Në historinë e re të arsimit, ekziston një traditë pozitive e kontributit të donatorëve në reformimin e sistemeve të arsimit në vendet në zhvillim, veçanërisht në Afrikë, Azi dhe Amerikë Latine. Suksese të veçanta janë arritur në rritjen e përfshirjes së fëmijëve/të rinjëve në arsimin fillor dhe të mesëm, megjithëse ndërtimi i shkollave të reja dhe krijimi i vendeve të reja të punës në arsim nuk mund të quhen elemente kyçe të reformës së arsimit, edhe pse janë segmentet më të kushtueshme të saj. Projekte të caktuara të donatorëve kanë adresuar edhe segmente të tjera qenësore të reformës: trajnimin e mësimitdhënësve, zhvillimin e kurrikulave, zhvillimin e materialeve mësimore, përcaktimin e standardeve nacionale të arsimit dhe vlerësimit, planifikimin, etj. Megjithatë nuk duhet pritur që kapitali i huaj do t'i zgjidhë të gjitha problemet me të cilat ballafaqohet një shoqëri gjatë reformimit të sistemit të vet të arsimit.

5) World Bank Group Response to Post Conflict Reconstruction in Kosovo: General Framework for an Emergency Assistance Strategy (July 1999)

Donatorët kontribuojnë kryesisht me anë të projekteve, të cilat i menaxhojnë organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare. Kjo qasje buron nga suksesi që ka shënuar i ashtuquajti Plan i Marshallit në rindërtimin e Evropës, i cili është bazuar pikërisht në projekte. Në raste të shumëta, projektet në fushën e arsimit janë plotësisht të izoluar nga konteksti politik. Donatori zakonisht viziton një institucion të arsimit, identifikon një nevojë të caktuar, dhe disenjon projektin me qëllim që atë nevojë ta plotësojë brenda një periudhe të caktuar kohore. Një numër i madh i projekteve të tilla, përnjë natyrë e tyre janë projekte të tipit "pilot", pra kërkohet që rezultatet e tyre të replikohen dhe të bëhen të qëndrueshme nga vet përfituesit e projektit. Një qasje e tillë e donatorëve nuk ka qenë gjithnjë e saktë dhe kjo ka rezultuar me dështimin e projekteve të shumëta, veçanërisht në fazën kur ka përfunduar financimi nga ana e donatorëve. Të shumtën e rasteve është provuar se arsyet e dështimit janë supozimet e gabuara të disenjuesve të projektit mbi kontekstin në të cilin implementohet projekti.⁶

Në rastin e Kosovës, donatorët kanë dhënë kontributin më të madh në fushën e ndërtimit dhe rindërtimit të objekteve shkollore. Kështu, sipas të dhënave të Departamentit për Arsim dhe Shkencë, për ndërtimin dhe rindërtimin e shkollave dhe objekteve universitare, nga donatorët kryesorë gjatë viteve 1999 dhe 2000 janë dhënë të paktën 50 mil. USD pa llogaritur këtu shumë donatorë më të vegjël, të cilët poashtu kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm.

Ndërkaq, projektet të cilat implementohen në fushën e "softuerit" arsimor mund t'i ndajmë në dy grupe:

Projektet të cilat paraqesin ndihmë të drejtëpërdrejtë autoriteteve të arsimit në Kosovë dhe kanë për qëllim ndërtimin e kapacitetit të tyre, i cili do të duhej ta bartë barrën e rëndë të reformave në fusha të caktuara të sistemit të arsimit,

6) Adriaan Verspor: Pathways To Change: Improving the Quality of Education in Developing Countries, World Bank Discussion Paper No. 53 (1989), p. 145.

Projektet që ndihmojnë drejtpërderjht institucionet kosovare të arsimit ose organizatat joqeveritare në përpjekje që të inicojnë një qasje më aktive të shoqërisë civile në reformimin e sistemit të arsimit.

Ndonëse në numër më të vogël, duhet theksuar se ekzistojnë projekte të cilat mund të klasifikohen në të dy grupet e përmendura.

3. STRATEGJIA E REFORMËS SË SISTEMIT TË ARSIMIT

Përkundër disa ndryshimeve që janë bërë në vitet e nëntëdhjeta, sistemi kosovar i arsimit është ende i ngarkuar me trashëgiminë e sistemit të arsimit nga koha e ish-Jugosllavisë. Reformat e shumëta që janë bërë në sistemin kosovar të arsimit gjatë 50 vjetëve të fundit kanë pasur ndikim shumë të kufizuar në ngritjen e cilësisë së arsimit, ndoshta pikërisht për shkak të faktit se nuk e kanë marrur parasysh sa duhet kontekstin nacional dhe atë ndërkombëtar. Në të shumën e rasteve, ato janë kufizuar vetëm në ndryshimin e planeve dhe programeve mësimore, pa u shoqëruar edhe me forma të tjera të ngritjes së cilësisë së arsimit (përmirësimi i kushteve të punës, trajnimi i mësimeve, etj.). Poashtu, nuk mund të flitet për ndonjë pjesëmarrje aktive të mësimeve, nxënësve/studentëve dhe shoqërisë në përgjithësi në disenjimin e reformave të deritanishme, prandaj edhe është i pranishëm një qëndrim i gabuar në shoqërinë kosovare se reformat duhet të disenjohen në qarqe të mbyllura dhe të burokratizuara të ekspertëve, ndërsa mësimeve dhe nxënësve/studentët janë ata që do t'i zbatojnë reformat në institucionet e arsimit.

Praktika tregon se suksesi i reformës nuk mund të garantohet vetëm me cilësinë e ekspertëve të cilët marrin pjesë në hartimin e saj. Duhet të ekzistojë një fazë e përgatitjeve, ku në mënyrë të përshtatshme këmbëhen informatat mbi qëllimet e reformës dhe tentohet arritja e një konsenzusi të përgjithshëm rreth këtyre qëllimeve. Kjo është më se e nevojshme për shkak

të faktit të thjeshtë se çdo reformë kërkon sakrifica dhe nuk mund të kryhet me sukses pa ndërmarrjen e disa hapave të vendosur që mund të kenë efekt negativ tek kategori të caktuara të mësimdhënësve, nxënësve/studentëve dhe popullatës në përgjithësi.

Reformat e suksesshme në vendet e Regionit dhe në ato evropiane kanë kaluar kryesisht nëpër tri faza:

1. Hartimi i një "Libri të Gjelbër" në formë të analizës kritike të situatës në sistemin e arsimit dhe diskutimi inicial në bazë sa më të gjerë i ndryshimeve të nevojshme në sistemin e arsimit.
2. Hartimi i kornizës për veprim të mëtutjeshëm, bazuar në rezultatet e diskutimit, e cila përmban mekanizmat kryesorë për ndryshime në fusha të ndryshme të sistemit të arsimit (i ashtuquajtur "Libër i Bardhë"), si dhe diskutimi në bazë sa më të gjerë i kësaj kornize.
3. Faza përfundimtare gjatë të cilës ndryshimi merr fizionominë e vet përfundimtare, përmes ligjeve ose vendimeve juridike-administrative.

Për fat të keq, në shumë vende në zhvillim nuk ekzistojnë kapacitete kërkimore-shkencore, të cilat përcjellin funksionimin e sistemit të arsimit duke vënë në dukje vazhdimisht pikat e forta dhe të dobëta të tij. Ndodhë që analizat e tilla bëhen në intervale jo të rregullta kohore, edhe atë me iniciativën e faktorit të jashtëm, gjë që nuk jep rezultate të kënaqshme. Stimulimi i punës kërkimore-shkencore në analizën e segmenteve të ndryshme të sistemit të arsimit do të duhej t'i shërbente autoriteteve të arsimit që të shmangen nga ambiciet për aplikimin e reformës të tipit ad-hok, fleksibiliteti i të cilës nuk bën të mundur përmirësimin e gabimeve që mund të shfaqen në fazat e ndryshme të saj.

Reforma e suksesshme e arsimit duhet të jetë e mirëpritur nga njerëzit, për më tepër, është e dëshirueshme që ata të identifikohen me reformën. Edhe në ato raste kur dëshira për reformim nuk ekziston, ajo duhet të gjenerohet para se të fillojë çfarëdo aktiviteti tjetër. Një qasje e tillë jo vetëm që mundëson identifikimin e drejtë të nevojave, por edhe krijon një ndjenjë të fortë të "pronësisë" mbi rezultatet e reformës.

Hap tjetër i rëndësishëm është përcaktimi i mekanizmave

të reformës. Edhe në vendet tjera është paraqitur dilema se a duhet të ngriten grupe të vogla të individëve të kualifikuar të cilët do të punojnë në qetësi dhe do ta njoftojnë kohëpaskohe opinionin mbi rezultatet e punës së tyre, apo duhet të përfshihet një numër më i madh i individëve, të cilët do të punojnë haptaz dhe në përcjellje të vazhdueshme të opinionit?⁷ Padyshim, opcioni i parë është më i lirë dhe më i thjeshtë, mirëpo mendohet se opcioni i dytë e bën shumë më të besueshëm suksesin reformës.

Në shumë raste zbatimi i reformave në sistemin e arsimit fillon me fazën e pilotimit, e cila zhvillohet në institucione të zgjedhura të arsimit. Informatat kthyesë nga institucionet "pilot", të cilat sigurohen përmes monitorimit dhe vlerësimit të rregullt, duhet t'i kontribuojnë formulimit të strategjisë së përgjithshme për ndryshime në sistemin e arsimit. Këtu duhet theksuar rolin kyç të mësimdhënësve, pa pjesëmarrjen aktive të të cilëve nuk mund të paramendohet sukcesi i asnjë reforme. Mësimdhënësit duhet të kenë ndikim të mjaftueshëm në procesin e ndryshimeve, veçanërisht kur është fjala për ndryshime kurrikulare.

4. INICIATIVAT PËR REFORMA NË KOSOVË

Iniciativa e parë e Departamentit për Arsim dhe Shkencë të UNMIK-ut në lidhje me reformimin e sistemit të arsimit ishte DESK (Developing Education System in Kosovo - Zhvillimi i Sistemit të Arsimit në Kosovë). Idea ishte që, përveç një grupi qëndror të punës, të formohen edhe një varg grupesh tjera të punës, të cilat do të merren me aspekte të ndryshme të reformimit të sistemit të arsimit. Projekti inicial theksonte nevojën e inkuadrimin sa më të madh të kosovarëve në disenjimin e reformës në mënyrë që të artikulohen nevojat reale të shoqërisë kosovare. Për arsye të shumëta, ky Projekt u braktis

7) I. Svetlik, A Barle-Lakota: Curricula Reform: The Case of Slovenia, Strategies of Educational Reform in SEE Countries, Proceedings of the Seminar, Bled, Slovenia, June 8-10, 2000

në qershor të vitit 2000, gjashtë muaj pas fillimit të tij

Qasja e tanishme e Departamentit për Arsim dhe Shkencë bazohet në të ashtuquajturat agjensi udhëheqëse, të cilat në të vërtetë janë bartësit e projekteve të caktuara të donatorëve ndërkombëtarë që kanë për qëllim intervenimin në fusha të ndryshme të sistemit të arsimit. Këto agjensi udhëheqëse kanë për detyrë që të zhvillojnë kapacitetin lokal në fushat e tyre të veprimit, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria dhe diseminimi i rezultateve të projekteve që janë në implementim e sipër. Të njëjta agjensi duhet të jenë edhe bartës të ndryshimeve në fushën e intervenimit të tyre, ndërsa do të duhej të ekzistonte edhe një mekanizëm koordinues në mes tyre. Sipas Departamentit për Arsim dhe Shkencë "koncepti i agjensisë udhëheqëse është një hap drejt administratës bashkëkohore civile, i cili është në kundërshtim me traditën ballkanike, sepse as universiteti as agjensitë qeveritare nuk kanë kompetencë dhe legjitimitet të mjaftueshëm për t'i zhvilluar dhe implementuar elementet e reformës në sistem".⁸ Deri tani janë emëruar agjensi udhëheqëse për kurrikula, edukimin parashkollor, arsimin special, trajnimin e mesimdhënësve dhe për arsimin profesional. Prej ndryshimeve të rëndësishme në strukturën e sistemit të arsimit është sanksionuar aplikimi i modelit: 5 vjet të shkollës fillore, 4 vjet të ciklit të ulët të shkollës së mesme (që paraqet edhe shkollimin e obligueshëm në kohëzgjatje prej 9 vjetëve), si dhe 3 vjet të ciklit të lartë të shkollës së mesme.⁹

Në planin e arsimit universitar është aktual reformimi i studimeve universitare në frymën e Deklaratës së Bolonjës, të nënshkruar në vitin 1999 nga 29 ministra evropianë të arsimit dhe ku parashihet regjimi i caktuar për fitimin e thirrjeve akademike, si dhe mundësia e shtuar për mobilitetin e studentëve dhe të mesimdhënësve universitarë. Parashihet që të zhvillohet modeli 3-5-8 (për fitimin e shkallës akademike të bakelorit, magjistratit dhe doktorit të shkencave, përkatësisht),

8) Michael Daxner: Education Policy Statement 2001, UNMIK Department of Education and Science

9) UNMIK, Regullorja 2000/51

adoptimi i sistemit evropian për transferin e pikëve (ECTS), si dhe zhvillimi i një profili autonom ndaj çdo qeverie të ardhshme.¹⁰

Nuk mund të thuhet se ekziston ndonjë iniciativë serioze lokale për reformimin e sistemit të arsimit, nëse përjashtohet dëshira e kosovarëve që sistemi i arsimit në Kosovë të jetë i ndërtuar në bazë të standardeve ndërkombëtare. Në fakt, asnjëherë gjatë historisë nuk është kërkuar prej kosovarëve që të jenë aktivë në këtë drejtim, prandaj arsyeja për mungesën e iniciativës mund të jetë kultura lokale, por mund të jetë edhe mungesa e kapacitetit për të marrë mbi vete një barrë të tillë. Nga ana tjetër, pozita e vështirë materiale e arsimit e bën profesionin e punëtorit të arsimit plotësisht joatraktiv gjë që ndikon në zvogëlimin e dukshëm të kapacitetit për implementimin e ndryshimeve në sistemin e arsimit.

Në Kosovë veprojnë disa organizata joqeveritare lokale dhe organizata ndërkombëtare, të cilat bëjnë përpjekje që, në kuadër të mundësive të tyre, të mobilizojnë kontributet e donatorëve për ndihmë sistemit të arsimit. Këto organizata paraqiten si ofertues alternativ të shërbimeve të ndryshme, siç janë trajnimi i mësimdhënësve, njohja e opinionit me praktikën pozitive në vendet tjera, etj. Si u tregua më sipër, disa prej tyre ushtrojnë veprimtari të caktuara në emër të autoriteteve të arsimit. Sidoqoftë, vet numri i organizatave lokale dhe ndërkombëtare që ushtrojnë veprimtari në lëminë e arsimit nuk mund të sigurojë krijimin e një mase kritike, e cila do të ushtronte një presion pozitiv tek vendimmarrësit. Për më tepër, këto organizata duhet të zhvillojnë një bashkëpunim intensiv deri në krijimin e një rrjeti sektorial, gjë që do të kontribuonte në krijimin e një strukture që do të jetë në përkrahje të reformës.

10) Michael Daxner: Education Policy Statement 2001, UNMIK Department of Education and Science

5. PËRFUNDIM

Reformimi i sistemit të arsimit është një detyrë komplekse dhe proces afatgjatë me interes të përgjithshëm shoqëror. Për këtë arsye, një detyrë e tillë duhet të kryhet me kujdes të veçantë, duke respektuar praktikën pozitive të vendeve tjera, si dhe nevojat e shoqërisë. Për shkak të ndërlidhjes natyrore në mes të segmenteve të ndryshme të sistemit të arsimit nevojitet një shkallë e lartë e koordinimit në mes të subjekteve që merren me reformimin e sektorëve të ndryshëm të sistemit të arsimit.

Është evidente se në shoqërinë kosovare ekziston një qasje pozitive ndaj ndryshimeve në sistemin e arsimit, edhe pse shikuar në përgjithësi, arsimi nuk duket të jetë prioritet i subjekteve politike kosovare, gjë që në kompleksitetin e kontekstit politik mund të jetë deri diku e kuptueshme. Çdo iniciativë për reformimin e sistemit të arsimit duhet të marrë parasysh faktin se suksesi i saj mund të garantohet vetëm me pjesëmarrjen aktive të subjektit kosovar, e veçanërisht të mësimdhënësve. Krijimi i mekanizmave për eksploatimin e kësaj energjie pozitive paraqitet si prioritet në fazën initiale të reformimit të sistemit të arsimit, ndërsa mungesa momentale e tyre nuk mund të jetë arsye për marrjen e vendimeve të rëndësishme dhe me efekt afatgjatë në mënyrë administrative.

INTELEKTUALI KONVERTIT DHE KRIZA E IDENTITETIT KULTUROR

(qasje për studim)

Në shoqëritë në tranzicion, sidomos në ato që kanë kaluar një shpërbërje totale, siç ka ndodhur me shoqërinë kosovare, kultura ka pësuar më së shumti, jo vetëm nga shkaku se regjimi okupues serb në Kosovë kishte në program rrënimin përfundimtar të institucioneve të kulturës dhe akulturimin e shqiptarëve, por edhe nga shkaku se në Kosovë kultura asnjëherë nuk u konsiderua si vlerë me interes të veçantë kombëtar sa të bëhej diçka, që erozioni dhe shkatërrimi i planifikuar të pengohej, apo që pasojat e tij të ishin më të vogla...

Në shoqërinë kosovare, rrënimi kulturor që ndodhi është pasojë e arsimimit dhe emancipimit kombëtar, në emër të të cilit u shkaktuan rrënoja të mëdha në strukturën tradicionale të jetës shqiptare. U shkatërrtua në tërësi kodi kanunor i kulturës jetësore shqiptare. U shkatërrua në tërësi një trashëgimi mijëvjeçare kulturore, që ruhej dhe bartej nga një gjeneratë në tjetrën, përmes një kulture të veçantë dëgjimi dhe ligjërimi, që ishte kultivuar në oda. Ndërrimi i gjuhës në mënyrë gati revolucionare, pa asnjë rezistencë, duke u kuptuar si akt patriotik, i hapi rrugë instalimit të shpejtuar dhe artificial të një diskursi të ri në të folurin shqiptar në Kosovë dhe kjo solli me vete një mentalitet të ri, që ndërroi çdo gjë, që nga mënyra e të menduarit, deri të mënyra e të folurit. Me shpejtësi të madhe, si në laboratorët orvëlliane, shkollarë dhe dijetarë të vjetër e të rinjë paraprakisht fshinë nga mendjet e tyre "gjuhën e vjetër" dhe u ngutën që më të shpejtë të përdorin "gjuhën e re", me bazë dialektore toskërishte të quajtur gjuhë letrare, apo gjuhë e njësuar...

Euforia patriotike së pari mbyti vetëdijen kritike e pastaj solli mostra të ideologjizuara, me të cilat u shartua mendësia

shqiptare dhe kështu u krijua shtresa e re intelektuale e Kosovës.

Në emër të së resë u rrënua pa mëshirë krejt ajo që kurrë më s'do të mund të rimëkëmbet. Tjetërsimi ynë nga të menduarit dhe ligjërimi tradicional, si dhe shortimi në sistem të të mënduarit dhe të të shprehurit deklarativ (revolucionar), ka pasur për pasojë humbjen e një arsenali madhështor të një kulture, e cila mbase, si e tillë, ishte e vetme në Evropë. Mbështetja në modelin i ri të të menduarit, të kanalizuar në skema të ideologjizuara e të politizuara, pati për pasojë shkomëbtarizimin shpirtëror të popullatës shqiptare, pasojat e të cilit po i ndjejmë aq shumë sot.

Mendimtari tradicional shqiptar e ka ditur se e vërteta nuk mund të përthekohet, as të shprehet me fjalë. Atëbotë, ka mjaftuar një rrëfim i shkurtër për të shprehur një mendim të thellë rreth një çështjeje, e cila nuk ka pasur nevojë të artikullohej më hollësisht me asnjë elaborim plotësues. Nëse tjetri nuk është pajtuar me atë mendim të shprehur përmes rrëfimit autentik, ai mospajtimin e tij e ka shprehur në të njejtin diskurs, me rrëfim. Ata nuk kanë ditur që t'i vëjnë mendimet në konflikt, siç bëjmë ne sot, duke polemizuar pa shije, me intonacione agresive, në mungesë të argumentacionit të mirëfilltë.

Kultura tradicionale e ligjërimit të tërthortë, e ballafaquar me modelin agresiv të ligjërimit diskurziv, i cili si i till ishte në fazën pionere, të ngjyrosur me skema ideologjike, nuk kishte mundësi t'i përballonte këtij lloj agresioni. Modeli i intelektualit të ri erdhi në odën shqiptare me formula të mësuara përmendësh, me kokën plot mendime e fraza e citate të gatshme, me të cilat çdo gjë definohej si e vërtetë përfundimtare dhe e cila plasohej si diçka me vlerë gati religjioze, në të cilën apriori duhej të besohej. Mendimi i vjetër u shpall dhe u rrënua me formulën: "Botën e vjetër ne do ta shkatërrojmë dhe pastaj, një botë të re ne do ta ndërtojmë në vend të saj".

Mendimtari tradicional shqiptar, i gjetur përballë shkollarëve të edukuar nga vepra të Marksit, Engelsit e Darvinit, që prejardhjen e njeriut ua shpjegonin fëmijëve dhe pleqve si zbritje majmunësh nga degët në tokë, i përballur me një diskurs të tillë agresiv, ia imponoi kulturës tradicionale shqiptare kompleksin e inferioriteti dhe kjo pastaj shpejtoi pro-

cesin e rrënimit përfundimtar të të gjithë vlerave tradicionale, të cilat përfunduan në skema folklorike primitive, si imitime groteske të qëndrimeve burrërore e patriarkale nëpër shfaqje të teatrove amatore, apo në kolorit atraktiv për të huajt në veshjet e ansambleve folklorike, ku dominonte struktura rituale e kësaj kulture, me qëllim të denigrimit dhe nënçmimit të këtij populli deri në atë masë sa të paraqitej si një fis primitiv, i cili paskësh jetuar me doke e zakone të egra mali...

Pleqët tanë, Sokratët e fundit në Evropë, që në vete ruanin arsenal të çmuar të dijes mijëvjeqare, të bartur nga njëri brez në tjetrin, u tërhoqën para "autriteteve" të reja të shkollarëve, që erdhën në odat shqiptare, si ata që sollën dije të re, pa e kuptuar se dija e e tyre e re nënkupton rrënimin dhe zhdukjen e dijes së vjetër. Etja për dije, që ishte diçka konstante te dijetarët e traditës, e kishte krijuar edhe mitin e ri për shkollarin e ri. Fjala e një shkollari të ri, e ndërtuar me një diskurs të ri dhe me gjuhë të njësuar në një kuvendim, edhe kur ishte tërësisht e pavlerë, dukej se peshonte më tepër se fjala e plakut-filozof, i cili i pamësuar që mendimin e vet ta thotë pa e pasur rrëfimin ku do mbështeste, tërhiqej, duke u bërë sikur nuk i di gjërat... "Ju keni shkollë, ju i dini më mirë këto punë". Ndoshta respekti i tepruar për dijetarët e rinj, (sepse, kishte ardhur vërtetë koha që dija e vjetër të avansohej në dije të re), bëri të mundur rrënimin aq të shpejtë të kulturës së ligjërimit të lashtë.

Ndryshimi "revolucionar" i strukturës tradicionale të të menduarit dhe të ligjërimit, dhe konvertimi në ligjërime deklarativ pati për pasojë ndryshimi rrënjësor në strukturën etnopsikologjike të karakterit tonë kombëtar, si dhe stërkeqjen e kësaj strukture. Se është kështu këtë mund ta ndjejë secili që ka pasur mundësinë të kalojë ndonjë natë në ndonjërin nga odat e Dukagjinit apo të Drenicës. Diskursi i ri që aplikohet sot në këto oda, mjerisht, është i ngjashëm me atë që mund të ndeshet në secilën kafene të Prishtinës.

INTELEKTUALI SHQIPTAR DHE ÇMIMI'I KONVERTIZMIT POLITIK

Tek intelektualit shqiptar i Kosovës I dy decenieve të fundit, në kohën kur duhej të përjetonte afirmimin dhe pjekurinë e vet edhe në relacione me botën, me rrënimin e sistemeve, në të cilat u krijua qoftë si disident, qoftë si njeri i regjimit, rrënohet diçka që atij i jepte fizionomi të caktuar.

Intelektuali i periudhës post-komuniste, edhe nëse ka qenë bartës apo inspirues i atyre ndryshimeve, vetvetiu i tërë ky proces tek ai ka lënë traumat e veta në strukturën morale dhe psikologjike. Intelektualit shqiptar shpesh i është dashur të marrë shumë detyra dhe barrë të rënda për ta ndërruar kahjen e historisë kombëtare. Për ta bërë këtë, ai më parë u detyrua ta ndërrojë vetveten e pastaj të bëhet model me autoritet për të tjerët. Ai, në këtë mënyrë, u bë disa herë konvertit. Në këtë aspekt, konvertizmi i tij duhet shikuar si proces pozitiv, pa të cilin nuk ka qenë e mundur të ndërrojë asgjë në shoqërinë shqiptare.

Por gjatë procesit të shndërrimit në diçka tjetër, gjithsesi, konvertiti, bashkë me humbjen e identitetit të mëparshëm, humb edhe një pjesë të idinitetit dhe të personalitetit të vet. Nëse, ta zëmë, për nga bindja politike apo ideologjike dikur ka qenë Titist, apo Enverist, ndryshimi i tij i mëvonshëm, pa dyshim, për shoqërinë, e veçanërisht për interesin kombëtar, ka mundur të konsiderohet punë e mirë, e dobishme, por asnjëherë nuk është vlerësuar se gjatë procesit të konvertimit të tij çka ka mundur të ndodhur në psikën dhe në personalitetin e tij; pra, cilat kanë qenë pasojat e gjithë atyre ndryshimeve. Nëse shndërrimi ka qenë i lehtë, pra nëse bindjet e tij lehtë janë konvertuar në vlera të kundërta, atëherë kjo tregon se sa të pavlera dhe të zbehta kanë qenë të gjitha ato ide, apo doktrina në të cilat personi X ka besuar.

Cili ishte modeli i intelektualit të angazhuar, në të cilin u konvertua intelektualit i shoqërisë së shkuar?

Një kohë të gjatë u mendua se njerëzit e mençur, gjegjësisht të dijsëm, janë ata që kanë përgjigje adekuate për të

gjitha pyetjet e reja që shtron koha e re. Kjo, në parim, duket se është ashtu. Nga kjo doktrinë e re u lansua me kohë edhe miti për shkollarin dhe prej tij u krijua figura mitike e intelektualit hero, prapa të cilit nisën të rreshtohen masat. Në një kombinim paradoksal, kjo figurë ambivalente e heroit krijoi modelin e një rezistence të çuditshme, të njohur si të tillë vetëm ndër shqiptarët e Kosovës. Intelektuali i ri merr përmasat e autoritetit të një heroit. Pa dyshim se ndryshimet mund të kenë ndodhur në çastet vendimtare. Por, pikërisht në këtë kombinim paradoksal, intelektualit e sterilizon dhe e kastron potencën e heroit, ndërsa psikologjia e heroit e bllokoi tërësisht mendimin e lirë, pa të cilin nuk mund të paramendohet një intelektual. Nëse heroit, në strukturën e tij mentale, e ka si konstantë guximin për të vepruar, në strukturën mentale të intelektualit ekziston dilema, hezitimi konstant para secilit veprim.

Intelektuali shqiptar i Kosovës, duke marrë mbi vete rolin e heroit në momente kyçe historike u kthye në antihero. Në themel të mendimeve dhe të veprimeve të veta, ai ka dilemën, hezitimin, vetminë. Nëse duhet të ecën për diku, vetëdija e tij krijon njëqind argumente të qëndrueshme për ta bindur se ecja është e pakuptimtë. Nëse duhet të qëndrohet në vend, mendimet e tij krijojnë teori të tëra për nevojën supreme për ecje. Të ecet apo të qëndrohet? Qëndresë, qëndrim, qëndro: asnjëra nga këto fjalë nuk ka në vete mekanizëm të lëvizjes.

Intelektuali i konvertuar në hero, për t'i ikur përgjegjësisë arrinë të gjejë mbështetje në një hapësirë neutrale, në të cilën koha është asnjëse, në një hapësirë të pakohë, një hapësirë e cila mund të merret edhe për të vërtetë edhe për iluzion, që është edhe reale, edhe fiktive. Intelektualët konvertitë nuk besojnë në norma të dhëna para tyre. Ata nuk besojnë në autoritete, qofshin ato shtetërore apo nacionale, ata nuk janë ateistë, por as besimtarë. Nuk i duan autoritetet, por as vetë nuk dëshirojnë të bëjnë jetë autoritari. Veprimet e tyre pra, janë dihotomike. Shpirti i tyre ambivalent. Mosveprimin e vet ai do të mundohet ta paraqes si mençuri. Përndryshe, ai gjithnjë do të mundohet të fitojë në kohë, çuditërisht i bindur se koha mund të punojë në favorin e tij, i bindur se koha mund të sjellë diçka tjetër në opcion... Ai futet në lojë dhe, në

pamundësi të kthehet jashtë loje, nuk është i zoti as të vazhdojë lojën më tutje, por as të dalë nga loja. Ai nuk mund të rrijë në lojë deri në fund, sespe nuk as forcë e as kurajo që ta marrë përgjegjesinë e një fundi jo të suksesshëm. Sepse, i frikësohet humbjes. Sepse, ka hyrë në lojë me psikologji të shartuar. Ai di si duhet të bëhet një punë. I di përparësitë dhe mangësitë e të tjerëve. Por, jo edhe përparësitë dhe mangësitë e veta.

Intelektuali konvertit, për periudhë të shkurtër është i aftë që nga vetja të bëjë atë njeriun që të tjerët e kërkojnë dhe e presin prej tij. Çastet e sukseseve të vogla në punët fillestare e tërheqin më thellë dhe ia rrisin ambicjen dhe bindjen se ai mund t'ia dalë mbanë një pune. Por, mossuksesi i parë shkakton tek ai shterim energjie për të vazhduar tutje, në të shfaqet zhgënjimi, shpirtëngushtësia dhe lodhja. Prandaj, preferon ndaljen dhe pritjen. As nuk kthehet prapa, as nuk vazhdon përpara.

MENTALITETI SHQIPTAR SOT: LUFTA NDËRMJET SHQIPONJËS DHE URITHIT

Pavarësisht nga disa analiza dhe vlerësime cinike dhe denigruese, që na i kanë bërë të tjerët, megjithatë në një aspekt, edhe në analizat që na i kanë bërë, madje edhe armiqtë tanë, krenaria dhe guximi na janë pranuar si virtyte elementare, me të cilat jemi njohur si popull gjatë shekujve të kaluar, virtyte këto që shpesh kemi pasur dëshirë t'ia atribuojmë ndikimit të totemit tonë kombëtar shqiponjës, me të cilën u identifikuam aq shpesh gjatë historisë. Kështu ka qenë dikur. Por, a është sot kështu? Edhe romantikët më naivë tanimë e dinë se ne kaherë nuk jemi të tillë. Çka ka ndodhur me ne në ndërkohë, që e humbëm kaq shumë këtë përmbajtje esenciale morale e shpirtërore?

Nuk do mend, se nga virtytet e moçme, përpos krekosjes folklorike, shpesh groteske, në mentalitetin e shqiptarit bashkëkohor, sidomos të atij që jeton në Kosovë, thuajse nuk ka ngelur më asgjë. Totemi i shqiponjës krenare, këtij shpendi

madhështor që bën jetë të vetmuar në maje të shkrepave, u zhduk gati pahetueshëm nga karakteri i kombit tonë, sidomos nga pjesa e robëruar e tij. Nëse totemi i shqiptonjës iku prej nesh, me cilin totem u shartuam në ndërkohë?

Nëse do të huazonim, përkohësisht, optikën kritike të vrojtitimit të thellë të një Faik Konice për ta analizuar ndryshimin në strukturën tonë shpirtërore dhe morale, do të shihnim se vërtet, në shumë aspekte, brenda psikës sonë etnike, ka marrë formën e vet shartimi me karakterin e një zvarraniku nëntokësor, siç është urithi.

Ndoshta, jeta në trysni permanente, përballë kanosjeve të shumta me luftë shfarosëse, ndjenja kolektive për pafuqinë tonë për të bërë diçka, në rast se kërcënimet e tilla do të bëheshin realitet, mbase të gjitha këto dhe shumë shkaqe të tjera krijuan klimë, që në psikën tonë kombëtare të ndodhin shartime perverse. Pra, jeta në një ankth të tiillë, që në kontinuitet zgjatë që nga viti 1989, por që nismën e vet e pati më 1981, ka bërë që me kohë ne të marrim diçka nga karakteri i këtij zvarraniku të vetmuar, i cili bjerrë jetën e vet korridoreve nëntokësore dhe atë ta shartojmë në karakterin tonë të ri si komb.

Jeta jonë alternative, gjatë dekadës së “rezistencës paqësore”, sidomos gjatë kësaj periudhe historike, me shumëçka i gjasonte jetës nëntokësore të këtij zvarraniku dhe, ndoshta, pikërisht kjo ka kushtëzuar më së tepërmi krijimin e një strukture të re mentale në psikën tonë kombëtare.

A është e mundur që vërtet të ketë ndodhur kështu?

Para dhe gjatë luftës, kafenetë e Prishtinës, shumica ishin të vendosura në hapësira, ku nuk depërtonte drita e diellit, nëpër korridore nëntokësore ose në hapësira që u gjasojnë korridoreve të tilla. Shumica e kafeneve shqiptare, rëndom të ngjitura njëra pas tjetrës, siç ishin ato në “Kurriz” dhe në “Qafë”, ku bjerrnin kohën në pritje mijëra të rinj shqiptarë, pastaj intelektualë të shumtë, profesorë, artistë të estradës, të kiçit e të shundit, gazetarë, biznesmenë të rrejtshëm, politikanë amatorë, në llafosje të pafundme, duke përtypur tema të njëjta. Vite me radhë, gumëzhinin rreth tavolinave me makiato përpara për politikë të lartë.

Vegjetimi ynë i gjatë në ato hapësira pa diell, simbolikisht do të mund të shpjegohej si një zgjedhje iracionale, që i shkon psikës së njeriut të robëruar, që kërkon hapësira alternative ku do të ndjehet më i sigurtë, një psikologji e ngjashme me atë të urithit. Jeta në korridore pa diell, realisht do të duhej të ngjallte asociacione mortore, ankthe iracionale, frikë nga vdekja. Një decenje e tërë jete në frikë dhe izolim konstant dhe adaptimi në një realitet të tillë ka pasur për pasojë atrofime dhe stërkeqje shqisash e motivesh, tretjen e vullnetit për liri e, bashkë me të, edhe dëshirën për të ngritur krye. (Ata presin jashtë me shat të ngrehur, gati për ta masakruar urithin e gjorë, porsa të ngrejë kokë - dheun- plis përjashtë) Jeta në ankth të pritjes së katastrofës, apo në pritje të lirisë së premtuar, bjerrja e kohës në pritje të kotë, kanë bërë që psikologjia jonë kombëtare, veçanërisht në pesëmbëdhjetëvjetëshin e fundit, të ndryshojë rrënjësisht.

Lufta, dalja e UÇK-së në skenë, solli një stres tjetër në psikologjinë tonë kombëtare.

Një kohë u mendua se kryengritja ishte diçka e paarritshme për ne shqiptarët. Kjo sforcoi panikën, si emocion kolektiv dhe paranojën kolektive që ndjente në çdo aksion serb, si fillim të katastrofës së paralajmëruar. Rezistenca e armatosur u kuptua si alibi për justifikimin e sulmeve, që po ndermernte ushtria dhe policia serbe...

Streset e këtij ndryshmii të papritur në psikën shqiptare bënë përsëri ndërrimin e totemeve... Shqiponja nis të kthehet në vendin e dikurshëm. Por, popullata ngeli si e kryqëzuar mes dy totemeve, mes shqiponjës dhe urithit...

Ndryshimet, që në ndërkohë kanë ndodhur në psikën tonë etnike, e ato vërtet kanë ndodhur, dikush duhet t'i analizojë dhe t'i definojë në aspektin shkencor.

Një gjë është e qartë: Ne e kemi humbur identitetin e dikurshëm kombëtar dhe nuk kemi asnjë model të qartë se si duhet të jemi në të ardhmen. Kontura e mentalitetit të ri, që po merr formë dhe përmbajtje perverse, është shenjë e fillimit të një procesi që mund të sjellë deri tek vdekja jonë shpirtërore si komb.

MEDIAT NË KOSOVË

Situata, në të cilën gjenden mediat e Kosovës, pothuajse është e ngjashme me gjendjen në të cilën gjindet shoqëria kosovare në tërësi. Kjo gjendje mund të përshkruhet si periudhë tranzitore, e cila në tërësi është unike. Mediat në Kosovë, si shtypi ashtu dhe ato elektronike, janë duke shprehur një realitet që dallon nga realiteti apo gjendja në të cilën kanë qenë mediat në Evropën Lindore. Në shumicën e këtyre shteteve ish-komuniste faza tranzitore është tejkaluar dhe tani shtypi i këtyre vendeve, me gjithë problemet me të cilat ballafaqohet, megjithatë e ka pamjen e mediave të shteteve perëndimore.

Janë dy karakteristika që e shtyejnë shtypin në Kosovë të jetë në gjendje tejet specifike. Karakteristika e parë është se në Kosovë nuk ekziston shtypi shtetëror (në pronësi dhe në kontroll të shtetit), siç ka ekzistuar në fazën tranzitore të shteteve të Evropës Lindore. Në disa nga këto shtete, një lloj i tillë i shtypit ekziston edhe sot. Shpjeguar më ndryshe, disa nga këto shtete ende mbajnë nën kontroll disa nga mediat e tyre. Siç u tha më lartë, në Kosovë nuk kemi të bëjmë me një situatë të tillë, për arsye se shteti dhe mediat që kanë ekzistuar gjatë viteve të fundit, nuk ekzistojnë më.

Situata specifike e Kosovës, nën administrim të OKB-së, po ashtu ndikon që kjo gjendje të jetë edhe më specifike. Gjykuar nga një aspekt tjetër, një situatë e tillë në mediat e Kosovës është ndikuar herë pozitivisht e herë negativisht në gjendjen e tanishme si dhe në planin afatgjatë të zhvillimit të mediave.

Specifika e dytë është mungesa e vullnetit nga ana e administratës së UNMIK-ut për të filluar procesin e privatizimit në përgjithësi, e cila gjë do të ishte reflektuar edhe në gjendjen e pronësisë që ka të bëjë me këtë fushë.

Deri më tani, me një status të tillë të papërcaktuar, funksionojnë shumë radio stacione lokale, të cilat janë ringjallur

nga një gjendje e rëndë që i ka përcjellur në dhjetëvjetëshin e fundit. Këto radiostacione më parë ishin në pronësi shtetërore, kurse tashti është vështirë të përcaktohet pronësia e tyre. Një gjendje e tillë mund të krahasohet me çfarëdo fabrike të çfarëdo prodhimi, ku dalin probleme që kanë karakteristika dhe specifika që mund të jenë të njëjta me ato të mediave. Sa u përket mediave të shtypura, deri më tani ka mbijetuar vetëm "Rilindja", e cila ballafaqohet me problemet e përmendura, të cilat janë duke e vënë seriozisht në pyetje çështjen e ekzistimit të mëtejme të kësaj të përditshme me traditë 56-vjeçare e që dikur ishte një shtëpi botuese me pamje dhe përmasa të një gjiganti medial.

Ish-RTP-ja tashti është transferuar në RTK dhe ka mbijetuar, duke u shndërruar në radiotelevizion publik, që për nga pronësia, shpjegohet të jetë me statut joshetëror e joprivat, formë e cila njihet pothuajse në të gjitha vendet perëndimore. Duke u nisur nga nevoja për ekzistimin e një mediumi të tillë, UNMIK, OSBE dhe organizata e donatorë të tjerë ndërkombëtarë, deri më tani, kanë treguar një interes të veçantë në drejtim të zhvillimit të këtij mediumi specifik. Rilindja nuk e ka pasur këtë fat.

TRI LIRI TË SHTYPIT DHE TË FJALËS SË LIRË - TRI TË VËRTETA

Mund të thuhet lirisht se shtypi në Kosovë është i lire, pasi që atë nuk e kontrollon dhe nuk e financon shteti. Është kështu për arsye se, siç u tha më lart, nuk ekziston shteti në format apo shembujt e njohur të tij, me ligje dhe rregullativa të plota, që do të përcaktonin statusin dhe të drejtat dhe obligimet e mediave. Rregullativat e UNMIK-ut dhe të OSBE-së, që kanë të bëjnë me mediat, ende janë në zhvillim e sipër, ku mungojnë ligjet sistimore të kësaj fushe.

Mediat elektronike dhe një numër tejet i vogël i gazetave dhe revistave, tentojnë të ruajnë një lloj pavarësie, duke i ikur përkrahjes së ndonjë grupi të caktuar politik. Një numër tejet i vogël i mediave të shtypura tenton ruajtjen e një lloj

pavarësie. Por, kjo nuk vlen për gjithë shtypin.

Në Kosovë ekzistojnë tri organizime politike, apo tri forma politike që mundohen të jetësohen në praktikë dhe, si të tilla, kanë ndikim edhe në mediat:

Një formë është bashkësia ndërkombëtare (UNMIK, OSBE, dhe organizata e fondacione të tjera ndërkombëtare), LDK-ja, si partia politike më e madhe dhe fituese e zgjedhjeve të fundit komunale.

Partitë politike që kanë dalë nga lufta dhe që përfaqësojnë frymën triumfaliste luftarake, por jo atë politike.

Ky është një realitet i çuditshëm. Që të tri këto entitete kanë agjendat e veta dhe, natyrisht, kanë edhe shtypin për t'i plasuar idetë dhe qëllimet e tyre. Në një farë mënyre, këto tri entitete nuk insistojnë doemos në kontrollin e mediave. Mirëpo, në praktikë duket se është e kundërta. Janë disa nga gazetatat, nganjëherë edhe mediat elektronike, (por këto më pak), që vullnetarisht marrin anën e këtyre tri entiteve politike.

Një pjesë e konsiderueshme e shtypit ende është e financuar nga donatorë të jashtëm. Pothuajse gjysma e gazetave tona të përditshme, si dhe shumë revista periodike, mbesin në treg në sajë të donatorëve të huaj. Nga kjo mënyrë, shohim se në Kosovë kemi 7 gazeta të përditshme, kurse numri i revistave është i madh dhe fluktues. Por, ajo që është e sigurtë është se Kosova ka më shumë gazeta nacionale ditore nga ç'ka, p.sh. Britania e Madhe, që konsiderohet si djep dhe shembull i gazetarisë. Natyrisht, me kalimin e kohës, ky numër i gazetave tona do të ndryshojë në drejtim të reduktimit, që do të bëhet gjatë konkurrencës që do ta imponojë tregu.

Megjithatë, edhe për një kohë, gjendjen do ta kemi të tillë. Për t'u kthyer në esencën e ndihmës së donatorëve ndërkombëtarë, ajo që duhet thënë është se ndihma e tyre ka qenë dhe është esenciale në drejtim të zhvillimit të gazetarisë profesionale të tipit perëndimor. Por, sa i indihmon kjo gjë plasimit të së vërtetës, nëse këto gazeta nuk botojnë artikuj apo lajme, të cilat qesin në pah ndonjë anë negative të komunitetit ndërkombëtar në Kosovë? Nga kjo del se këtu krijohet nevoja e themelimit të një blloku që thith dhe boton vetëm të vërtetën e llojit të vet, duke injoruar "të vërtetën e njëmendët".

Grupi i dytë i mediave është në shërbim të LDK-së. E vërteta që është kundër këtij formacioni politik nuk ka vend në këtë hapësirë mediale. Njësoj është edhe me gazetatat që promovojnë politikën e partive të dala pas luftës, gjegjësisht PDK-së.

Kjo, natyrisht, krijon një situatë paradoksale. Komuniteti ndërkombëtar nuk ka fshehur simpatinë për politikën paqesore të LDK-së. Por, komunitetin ndërkombëtar gjithmonë e ka penguar qëndrimi aspak profesional gazetaresk i "Botës sot". Ky komunitet është në marrëdhënie "dashurie" me LDK-në, kurse në marrëdhënie të "urrejtjes" me gazetën "Bota sot", e cila promovon politikën e LDK-së. Derisa ndërkombëtarët për LDK-në mendojnë se e udhëheq një politikë të moderuar, për gazetën suportuese të saj mendojnë se është me ndikim negativ në zhvillimin e shoqërisë kosovare. Kjo është kështu për shumë arsye, por një nga arsyet është se kjo gazetë nuk merr donacione nga ata, të cilët nuk e duan qëndrimin e saj ndaj të tjerëve. Kjo është një çështje që do studim dhe shpjegim të veçantë e që ka të bëjë pak me gazetarinë profesionale.

Një çështje tjetër, që mund të ngritet këtu, është paraqitja e mendimeve të atyre që nuk bijnë në asnjërën nga këto tri formacione politike. Nuk është lehtë për mendime të tilla që të plasohen në këto media, të cilat janë të prejjudikuara dhe, si të tilla, nuk ofrojnë vend për mendime alternative. Duke pasur parasysh këtë gjendje, mund të konkludohet se ka pak shpresa dhe hapësirë për zhvillimin e shoqërisë civile, e cila konsiderohet si ndër elementet kryesore në ndikimin e zhvillimit të shoqërisë, në përgjithësi dhe rrugës politike, në veçanti.

Është vështirë të thuhet se dikund ekziston shtyp tërësisht i lirë. Natyrisht, kjo çështje ka të bëjë më shumë me debat filozofik. Mediat, kudo në botë, zakonisht, me qëllim apo pa qëllim, mbrojnë orientime të caktuara politike. Edhe në vendet me traditë të gjatë dhe sistem të themeluar mirë të gazetarisë, vërehet animi i mediave në drejtim të grupacioneve apo organizatave politike. Në këto vende, janë të njohura botërisht gazetatat që përkrahin të majtët e cilat të djathtët në skenën politike. Një gjë e tillë lejohet të bëhet vetëm në hapësirat e gazetave të rezervuara për editoriale, apo komente. Lajmet, si dhe rëndësia e tyre, në këto gazeta paraqitet njësoj. Pra, ndahen komentet nga faktet, që është parimi themelor i gazetarisë së

sotme të pavarur. Në shtypin e Kosovës, këto dy fakte, që duhet të jenë të ndara tërësisht nga njëra-tjetra, shpesh paraqiten të përziera me njëra-tjetrën, apo paraqiten si një njësi. Shpesh këto media i injorojnë me qëllim aktivitetet e suksesshme të palës tjetër politike, të cilën nuk e përkrahin.

Qëllimi dhe, sidomos roli i mediave qëndron në të ushtruarit e influencës në krijimin e opinionit të lexuesit. Nga kjo që shihet më lart del se në Kosovë nuk kemi situatë të tillë. Shumica e mediave, pasi që u drejtohen qarqeve të caktuara me mendime të krijuara, nuk e kanë këtë efekt, pasi që ato u drejtohen grupeve me mendim të formësuar. Në këtë aspekt, këto media luajnë rolin e kuzhinierit dhe të shërbyesit të ushqimit të preferuar për formacionet politike në fjalë. Pra, ser-vohet menyja dhe shija që kërkohet dhe porositet.

Çështja tjetër, që duhet shtruar për diskutim brenda këtyre segmenteve, është edhe numri i lexuesve dhe shikuesve të mediave. Sa u përket mediave të shtypura, tek të gjitha të përditshmet që dalin në Kosovë, numri i përgjithshëm i tirazhit të tyre nuk e kalon shifrën e 40 000 ekzemplarëve, dhe ky është tregues i lexueshmërisë së tyre. Në një territor me 2 milionë banorë, çfarë është Kosova, ky numër i tillë i ulët i shitjes shkakton bengosje për ata të cilët i nxjerrin këto gazeta. Para dy dekadave, kur në Kosovë ekzistonte vetëm një e përditshme, numri i qarkullimit të kësaj gazete të vetme (Rilindja) ndodhte të ishte edhe dyfish më i madh. Tashti, pas dy dekadave, kur edhe numri i popullsisë është shtuar, numri i lexuesve ka rënë. Një nga arsyt e rënies së interesimit mund të jenë kushtet, në të cilat jetojnë shoqëritë e pasluftës, si dhe shtimi i numrit të madh të mediave elektronike, të cilat mbushin më lehtë hapësirën dhe nevojën për informim. Në tërësi, edhe kjo çështje duket se kërkon një studim të veçantë. Një element tjetër i rëndësishëm është edhe numri i madh i migrantëve nga Kosova në Evropën Perëndimore dhe në SHBA. Vetëm mediat që kanë edhe botime për perëndim ("Koha ditore", "Bota sot"), kanë më shumë sukses në treg dhe mund të mbahen edhe pa donacione.

VETËRREGULLIMI

Që nga fillimi i vitit të kaluar, kur UNMIK-u ka nxjerrë dokumentet për rregullimin e mediave, Shoqata e Gazetarëve të Kosovës (SHGK), duke i përfaqësuar të gjithë gazetarët e Kosovës, ka kundërshtuar një "rregullim" të tillë, duke i cilësuar rregulloret (2000/4 dhe 2000/37) si një hap kundër lirisë së shtypit dhe pengesë për organizimin e gazetarisë në Kosovë. Shpesh edhe OSBE-ja ka përkrahur UNMIK-un në këtë drejtim dhe kjo është arsyeja që SHGK është në kundërshtim edhe me këtë organizatë, kur është fjala për nxjerrjen e ligjeve të tilla, që nuk ndihmojnë në drejtim të këtij zhvillimi.

HGK, në konsultim me shumë gazetarë dhe përfaqësues të mediave të Kosovës, ka ardhur në përfundim se duhet të favorizohet një mënyrë tjetër e "rregullimit" të shtypit, e cila mënyrë është vetërregullimi.

Vetërregullimi nënkupton organizimin vetanak të gazetarëve dhe të mediave të Kosovës duke dashur që shteti të mos lejohet të përzihet në punën e gazetarëve, apo në sferën e gazetarisë, në përgjithësi. Pra, qëllimi është që shteti të mbahet sa më larg nga përzierja në punët e mediave, ashtu siç mbahet në shumë vende perëndimore.

Hapi i pare, apo gjysma e rrugës së themelimit të vetëorganizimit, është bërë me nxjerrjen e kodit të mirësjelljes gazetareske, të cilin kod e kanë aprovuar pothuajse të gjitha e mediat e Kosovës. Pas këtij hapi të parë, tashti koha është që të përmbyllet faza e organizimit të vetërregullimit. Kjo nënkupton krijimin e Komisionit për Media. Puna, roli dhe rëndësia e këtij Komisioni do të jetë deri diku e ngjashme me atë të zyrës së Komisionit të Përkohshëm për Media, që më herët ka vepruar nën organizimin dhe kontrollin e OSBE-së, por që tani paraqitet të jetë si i pavarur.

Faza përfundimtare e vetërregullimit përfshinë shuarjen e zyrës së Komisionit të Përkohshëm të Mediave dhe zëvendësimin e saj me Komisionin e Mediave, i cili do të ketë karakter tërësisht vendor. Pastaj, sipas premtimeve të dhëna nga zyrtarët e UNMIK-ut dhe të OSBE-së, do të pasojë tërheqja e rregulloreve në fjalë, të cilat pengojnë zhvillimin normal

të gazetarisë në Kosovë. Nga ky moment fillon të formësohet vetërregullimi, apo organizimi ynë në gazetari. Kjo procedurë është e ngjashme edhe me fazën kalimtare të vetëadministrimit të organeve shtetërore, apo të organeve të karaktereve të tjera, që ende janë nën kontroll ndërkombëtar.

Vetërregullimi, që do të përmbillet me themelimin e Komisionit të Mediave, ndryshe mund të quhet edhe si gjyq i nderit. Ky institucion, pos tjerash, do të ndikojë në përgjegjëshmërinë e mediave tona. Komisioni, me themelimin e tij, do të vazhdojë veprimet, duke qenë tërësisht i pavarur në punën dhe vendimet e tij. Me këtë, nuk do të kontribuohet vetëm në ngritjen e kualitetit apo standardit të profesionit. Themelimi i Komisionit të Mediave paraqet një hap të rëndësishëm së veçantë, për arsye se, deri më tani, mediat në Kosovë mund të konsiderohen si organizma, të cilat nuk janë të organizuar si duhet dhe si e kërkon zhvillimi i situatës. Organizimin i mediave duhet bërë për arsye se gjendemi në një situatë, ku vazhdimisht nxirren ligje dhe e cila kërkon që gazetarët t'i paraqiten ligdhënësit me presion të artikuluar, në mënyrë që interesat e gazetarëve dhe të mediave të mbrohen në mënyrë sa më të denjë.

Deri më tani nuk është bërë ndonjë presion apo organizim serioz. Si e tërë shoqëria kosovare, edhe gazetarët dhe mediat gjenden të kurthuar në interesa individuale, pa ndonjë aspiratë serioze për organizim të rrjetit të nivelit të kënaqshëm apo të suksesshëm. Për t'u mos organizuar suksesshëm janë duke kontribuar dhe disa media tona, të cilat me apo pa dashje, mundohen të shtynjë përpara interesat e politikave të tyre individuale redaktuese, e cila gjë sjellë injorimin e organizimit si rezultat. Në situata normale, duhet që gazetarët dhe mediat të krijojnë vijën e presionit ndaj organizmave të tyre, në mënyrë që interesat e tyre të mbrohen nga një trup i përbashkët. Një vijë e tillë e presionit mund të jetë e ndërsjellë. Deri tashti, kjo punë nuk është bërë ashtu si duhet. Themelimi dhe të vepruarit e Komisionit për Media mund të jetë sfida kryesore që do të testojë interesimin jo vetëm të gazetarëve.

Qëllimi apo puna kryesore e Komisionit do të përqëndrohet në ruajtjen e Kodit të Gazetarëve të përmendur më lart, në të cilin gazetarëve u bëhet me dije se, pos të drejtave të tyre,

kanë edhe obligime profesionale dhe shoqërore. Madje, në disa vende, pos ekzistimit të komisioneve të tilla, mediat e ndryshme angazhojnë edhe institucionin e ombudsmanit. E tërë kjo bëhet me qëllim të ruajtjes së etikës së profesionit të gazetarit dhe mbrojtjes së interesit të lexuesve apo dëgjuesve, ose thënë më ndryshe të opinionit publik.

Në vendet me organizim vetanak të gazetarëve kemi dy lloje komisionesh të tilla, për nga aspekti i organizimit të brendshëm. Në njërin, me numër të barabartë të anëtarëve, përfaqësohen gazetarët dhe shoqëria civile. Në llojin tjetër, pos këtyre dy grupeve, përfaqësohet edhe grupi i tretë, që janë botuesit, apo pronarët e mediave. E tërë kjo formë bëhet për shkak të marrjes së vendimit në të cilin duhet pasur prezent një spektër sa më të gjërë të përfaqësuesëve të interesave të ndryshme dhe që pastaj vendimi që merret të mos hasë në pengesa gjatë procedurës së zbatimit. Natyrisht, këto vendime janë të karakterit moral. Në situatën e pushtetit komunist, nga e cila ka dalë shoqëria kosovare, shkelja e ligjit, që është bërë nga gazetarët me rastin e kryerjes së detyrës, është sanksionuar dhe dënuar me ligj penal. Në shoqëritë e sotme bashkëkohore, dënimi penal konsiderohet si masë drakonike kundër lirisë së shtypit dhe fjalës së lië. Në këto shtete, në vend të ligjeve penale, në funksion janë vënë ligjet për etiketime, të cilat parashohin vetëm dënime me të holla. Një gjë e tillë pritet të ndodhë edhe në Kosovë. Kjo çështje jo vetëm që do të lehtësojë situatën, por edhe do të vendosë në binarë të drejtë zhvillimin e gazetarisë sonë.

Komisioni duhet të ketë edhe sekretariatin e vet, i cili kujdeset në aspektin administrativ dhe në të përgaditurit e punës formale, apo të procedurës përgaditore të fazës së para marrjes së vendimit. Në këtë organ administrativ do të punësohen së paku tre vetë, me orar të plotë të punës, si dhe të tjerë në cilësi të ekspertëve.

MJEDISI KOSOVAR

Globalizimi dhe Shoqeria Civile: Sfidat e Ketij Shekulli

"Kemi hyrë në mileniumin e ri... mjedisi, nga i cili na varet ekzistenca, po asgjësohet me pashpirtësi dhe pa pikë kuptimi. Besoj se zgjidhja gjendet diku brenda shpirtit të njerëzimit... ngel qe secili prej nesh ta përcaktojë përgjegjësinë vetanake brenda përgjegjësisë kolektive globale; që secili ta zbusë kafshën e vetëkënaqësisë dhe të përballet përvuajtshëm me domosdonë e qenies dhe rregullit në natyrë; që secili të jetë në gjendje ti arsyetojë veprimet e veta para gjeneratave të ardhme. "

(Vaclav Havel)

GLOBALIZIMI

Është e pamundur të flitet për shekullin 21, pa u përmendur fenomeni i globalizimit. Termi "globalizim" zakonisht përdoret për ta përshkruar "integrimin global të ekonomisë", mirëpo edhe përkunder shumë kritikave që i bëhen këtij termi, duket se është bërë i paevitueshëm në përshkrimin e shumë proceseve aktuale, bazë e të cilave është një sistem gjithnjë e më i integruar i komunikimit mes njerëzve në tërë globin. Ky proces me siguri do ta ngrit nivelin e bashkëpunimit ekonomik mes vendeve të ndryshme, që do të duhej të rezultonte me një zhvillim të gjithëmbarshtëm ekonomik. Në anën tjetër, zhvillimi ekonomik nënkupton rritjen e prodhimtarisë dhe të konsumit, që rrjedhimisht do të krijojë probleme mjedisore, të cilat gjithnjë e më tepër i kalojnë kufijtë nacionalë duke influencuar popullatën, ekonominë dhe ekologjitë e vendeve fqinje. Për këtë arsye, është i paevitueshëm harmonizimi i ligjeve ekologjike globale. Që nga fillimi i viteve të 80-ta ka filluar procesi i "intergrimit global ekologjik" ose më mirë të themi i

"qeverisjes globale të mjedisit" që ka rezultuar me një numër të rëndësishëm të konventave ndërkombëtare, qëllimi i të cilave është reduktimi i emitimit të ndotësve të mjedisit.

Meqenëse shumë shpesh zhvillimi ekonomik është në konflikt me mbrojtjen e mjedisit, duhet të sigurohemi se "integritet global politik" në një aspekt do ta kenë parasysh faktin se tregu global duhet të punojë ekskluzivisht në interes të njerëzimit dhe se duhet të rregullohet me standarde që nuk e komprometojnë cilësinë e mjedisit si dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Mirëpo, janë të vogla gjasat që një globalizim i tillë "të ndodhë", në të ardhmën e afërt. Shumica e kombeve do të hezitojnë të "heqin dorë" nga sovraniteti, sidomos sot, kur pjesa më e madhe e potencialit ekonomik dhe ushtarak është e koncentruar në vetëm disa vende. Kombet e Bashkuara do të vazhdojnë të merren me probleme të veçanta të shteteve anëtare, dhe akoma është larg momenti kur kjo organizatë do të mund të qeverisë dhe udhëheq një "demokraci globale", për të mirën e të gjithë banorëve të globit. Është e sigurtë se procesi i integriteteve globale ekonomike dhe ekologjike do të ndodhë shumë më shpejt se sa ai i integriteteve globale politike. Në një vakum të tillë politik, është shumë e rëndësishme të ndërtohet një shoqëri e fortë civile globale, e cila do të jetë në gjendje t'i adresojë konfliktet mes ekologjisë dhe ekonomisë si dhe konfliktet mes shoqërive të pasura dhe atyre të vobekta, përmes një dialogu dhe debati global.

SHOQËRIA CIVILE

Mund të thuhet se shoqëria civile sot, në vendet perëndimore, është mjaft e fortë, ndërsa në vendet në zhvillim porsa ka filluar të ndërtohet. Komunizmi plotësisht e shkatërroi shoqërinë civile, ndërsa tranzicioni i kësaj shoqërie në demokraci zgjedhore (pluraliste) solli organizatat e para që punojnë drejt forcimit të saj. Në ato vende ku ajo ka filluar të artikullohet gjatë dhe pas tranzicionit, si p.sh. në Evropën Juglindore nga fillimi i viteve '90, shoqëria civile ka demonstruar forcën më të madhe në dy rrafshë:

- në kritikën e politikave qeveritare dhe planeve zhvillimore dhe
- në kundërshtimin e projekteve të caktuara zhvillimore.

Pikat më të dobëta të shoqërive civile mbeten këto:

- Analiza e mirëfilltë e çështjeve shkencore dhe teknike në kontekstin e ndikimeve negative të zhvillimit ekonomik në ekosistemin natyror.
- Zhvillimi i strategjive/politikave për intervenim të caktuar në ekosistem. Nëse shoqëria civile nuk do të jetë në gjendje që të intervenojë me ide dhe projekte konkrete në zgjedhjen e problemeve të cilave u qaset, atëherë ekziston reziku i diskreditimit dhe marginalizimit të saj.

Roli i shoqërive civile në vendet në zhvillim, siç është edhe Kosova, në mbështetjen e zhvillimeve globale ekonomike dhe mjedisore për momentin është mjaft marginal. Në demokracitë e reja, ku shoqëritë civile akoma nuk janë të forta, qeveritë janë shumë më tepër të influencuara nga grupet e forta të interesit, sidomos ato ekonomike, dhe kjo influencë ka gjasa të shtohet me rritjen e ekonomisë. Nuk është e rastit që negociatat që bëhen sot në Organizatën Botërore të Tregtisë çojnë shumë më tepër peshë se ato që bëhen për konzervimin global të mjedisit. Me ironi mund të konstatohet se nga të gjitha proceset globale që kanë filluar sot në botë, ato të "marginalizimit global" janë më të suksesshmet.

KONTEKSTI KOSOVAR: SFIDAT E SHOQËRISË CIVILE

Shoqëria Kosovare në përgjithësi ka përfituar mjaft nga globalizimi i politikës ndërkombëtare e cila definitivisht i dha fund dhunës dhe aparteidit të ushtruar nga regjimi serb për më shumë se një dekadë. Ajo e filloi tranzicionin me një vonesë të dukshme krahasuar me shtetet e tjera post-komuniste të regjionit, dhe në një ambient politik specifik, nën qeverisjen/bashkëqeverisjen e komunitetit ndërkombëtar nën ambrel-

lën e Kombeve të Bashkuara. Në shikim të parë duket se një administrim i tillë mund t'i japë kahje pozitive proceseve të ndryshme demokratike që janë duke u zhvilluar në Kosovë, por realiteti duket shumë më ndryshe. Një "mekanizëm global", siç është ai i UNMIK-ut, deri më tash nuk pati sukses në vendosjen e shtyllave kryesore të zhvillimit të shoqërisë kosovare, ngase i mungonte koncepti i qartë zhvillimor, dhe më vështirësi arrinte që të mobilizojë potencialin vendor në ndërtimin e vendit të tyre. Komuniteti ndërkombëtar në formën e "donatorëve të bashkuar" por edhe jo të koordinuar mirë në mes veti, ia ka arritur që të mbjellë shumë procese rreth konsolidimit të Kosovës, me sukses të dukshëm në rekonstruktimin e infrastrukturës së shkatërruar gjatë luftës, por me shumë më pak sukses në vendosjen e mekanizmave për mobilizimin dhe forcimin e shoqërisë civile kosovare, e cila, edhe sot dy vjet pas luftës, është akoma e brishtë.

Në këtë shoqëri relativisht të varfër është pritur që shoqëria civile të veprojë në këto drejtime:

- Të bëjë ndarjen dhe distribuimin e informatave që do të inspirojnë popullatën që të veprojë,
- Të angazhohet për hartimin e një politike nacionale që do të kontribuonte në vetëdijesimin e kosovarëve se ata janë subjekt dhe duhet qeverisin dhe ta ndihmojnë vetveten
- Të zhvillojë dhe demonstrojë konceptet participative të regjenerimit të resurseve natyrore mes popullatës së rezikuar

Autoritetet aktuale e kanë obligim që ta ndihmojnë shoqërinë civile të bëhet një shoqëri e qëndrueshme. Qytetarëve duhet të ju ofrohet e drejta të dijnë, të përfshihen dhe të veprojnë kundër asaj që ata e konsiderojnë si përdhunim të të drejtave dhe interesave të tyre. Në veçanti, duhet të stimulohet potenciali pozitiv i qytetarëve për të ndërtuar një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit, si dhe për pjesëmarrje në procesin dhe praktikën e marrjes së vendimeve.

Edhe përkundër faktit se nuk mund të flitet për ndonjë kërcënim me katastrofë mjedisore në Kosovë, duhet të thuhet se

konflikti i fundit shkatroi infrastrukturën egzistuese, e uli cilësinë e ambientit dhe se për momentin është vështirë që të parashihen efektet afatgjate të këtij degradimi.

Kosova e pasluftës karakterizohet me dy momente mjedisore të shkaktuara nga: (1) aktivitetet militare/civile të organizatave paqëmbajtëse, atyre humanitare dhe aktiviteteve të ndryshme për ndërtimin dhe revitalizimin e infrastrukturës kosovare, dhe (2) moseskuesi i UNMIK-ut të konsolidojë/themelojë një politikë mjedisore që do t'i themelonte me sukses institucionet e para kosovare që do të punonin në ndërtimin e një sistemi efikas të organizimit dhe menaxhimit të shërbimeve mjedisore, si në rafshin nacional ashtu edhe në atë lokal.

Momenti i parë ndikoi në keqësimin e indikatorëve themelorë të cilësisë së mjedisit (emitimet e ndotësve nga mjetet ushtarakë, zhurma e aeroplanëve, trafiku i stërngarkuar, presioni në infrastrukturë urbane, etj.). Sa i përket momentit të dytë, mund të thuhet se UNMIK-u për një vit e gjysëm të qeverisjes në Kosovë, nuk pati sukses në vendosjen e bazës për zhvillimin e shërbimeve ambientale, me çka u vazhdua agonia e krijuar nga pushtetet e mëparshme që udhëhoqën Kosovën, ku çështjeve mjedisore nuk u jepej një rëndësi e duhur gjatë projektimit të zhvillimit ekonomik e social. Duket se këtë vakum të krijuar nga mosefikasiteti i departmentit të UNMIK për mbrojtje të mjedisit nuk ka ditur ta shfrytëzojë sektori civil, pra organizatat jo qeveritare lokale dhe të jashtme për të vepruar me më shumë entuziazëm, dijeni dhe efikasitet në themelimin e infrastrukturës mjedisore që do të prekte problemet më të ekspozuara, me të cilat kjo shoqëri momentalisht ballafaqohet:

- Zhvillimi i politikës dhe i strategjisë për implementimin e një sistemi për mbrojtjen e mjedisit, në të gjitha nivelet
- Zhvillimi i legjislaturës mjedisore, me rregullativa dhe standarde ndërkombëtare
- Themelimin e bazës për krijimin e fondeve mjedisore
- Vendosja e infrastrukturës institucionale (Agjencia Mjedisore) në nivel kombëtar dhe lokal, që do të ishte kompetente për vendosjen dhe zhvillimin e shërbimeve

mjedisore, dhe për mbrojtjen e resurseve më të rëndësishme të tij (ajri, uji, toka, ushqimi, shëndeti, natyra, biodiversiteti, etj.)

- Ngritja e nivelit të ekspertizës së profesionistëve kosovarë që merren me problemet e mjedisit
- Zhvillimi i kapaciteteve të OJQ-ve mjedisore, për të vepruar në mënyrë më efikase dhe si partner i barabartë në hartimin e politikës mjedisore të Kosovës.

Për ndryshim prej shumë vendeve të tjera në rajon, sektori i tretë dhe UNMIK-u kanë shansë unike të veprojnë së bashku në konsolidimin e shërbimeve mjedisore. Në anën tjetër, OJQ-të aktuale duhet të marrin një rol shumë më aktiv në promovimin e problemeve mjedisore. Ato duhet ta rifokusojnë veprimtarinë e vet, dhe të transformohen prej organizatave që meren me zgjidhjen direkte të ndonjë problemi lokal të mjedisit, në "grupe të presionit" ndaj mospasurisë së organizatave qeveritare për të gjetur zgjidhje adekuate për problemet e grumbulluara të lokaliteteve ku ato përkasin. Poashtu, veprimtaria e tyre duhet të jetë më gjithëpërfshirëse: me inercion OJQ-të gjithmonë dëshirojnë t'i luftojnë pasojat, kanë qasje afatshkurtë, dhe shumë rrallë të qëndrueshme. Dëshira e shumë OJQ-vë të pastrojnë një lagje, shtrat lumi apo oborr shkolle është shumë legjitime, mirëpo nuk lënë gjurmë signifikante në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të mjedisit tonë; lufton pasojat, në ndërkohë që shkaktojnë e problemit mbesin të paprekur. Në anën tjetër, OJQ-të në përgjithësi kanë probleme kronike me financimin e veprimtarisë së tyre, që i lënë shumë anash mundësitë të intervenimit direkt në eliminimin e shkaktarëve të ndotjes, kur dihet se ndotësit kryesorë në Kosovë janë objektet e mëdha industriale që zhvillojnë aktivitetet e tyre mbi bazën e eksploatimit të mineraleve (linjiti, xehet sulfidike të plumbit dhe zinkut, xehe nikeli etj.). Ajo që pritet nga OJQ-të në këtë moment është të promovojnë aksione civile në mbështetje të nismave pozitive dhe luftimin e atyre që janë negative dhe degraduese për mjedisin kosovar. Ato duhet të ndihmojnë, apo të luftojnë sektorin qeveritar, por edhe organizatat ekonomike/industriale atëherë kur nuk veprojnë në ngritjen e cilësisë së mjedisit. Por jo vetëm këto

dy sektore kanë ndikim në ambientin kosovar. OJQ-të janë në pozitë të favorshme që të ndikojnë në të gjitha organizatat e tjera që nuk shihen si organizata që punojnë drejtëpërdrejt në promovimin e çështjeve mjedisore. Këto janë: partitë politike, me programet e tyre, shkollat me planprogramet mesimore, mediat dhe politika e tyre mjedisore, profesionistët e mjedisit, etj.

Sektori i tretë në Kosovë është shumëi ri dhe akoma i brishtë. Është arritur të kemi mjaft OJQ lokale në periudhën e pasluftës. Po ashtu akoma jetojmë në një ambient të përshtatshëm me shumë donatorë të interesuar të ndihmojnë këtë sektor. OJQ-të mjedisore kanë filluar punën, dhe mund të thuhet se akoma janë në kërkim të identitetit të tyre. Momenti i përshtatshëm për punë i ka bërë të jenë më shumë "gjahtarë të mirë" të projekteve që donatorët e shumtë, shpesh herë pa menduar tepër i përkrahin. Mirëpo akoma nuk është punuar sa duhet në profilimin e veprimtarisë së tyre si organizatë civile. Është lëshuar një shansë i mirë të veprohet si "grup presoni" ndaj partive politike gjatë zgjedhjeve lokale, për artikulum më të mirë të programeve të tyre mjedisore. Ky presion do të ndikonte në vetëdijësimin e qytetarëve për problemet mjedisore, të cilat në të ardhmën do të varen shumë nga efikasiteti i veprimit të OQ dhe OJQ.

Dhe në fund, në kohën kur po lindin shumë aleanca, politike në radhë të parë, është moment i fundit të lidhen aleanca mes partnerëve kryesorë që mbajnë në dorë fatin e mjedisit, jo vetëm kosovar, por edhe rajonal: sektorit qeveritar dhe joqeveritar; departamenteve qeveritare, që me politiken e tyre implikojnë drejtëpërdrejt cilësinë e mjedisit; biznesit dhe të qytetarëve. Mbase të gjitha këto grupe mund të kenë interesa të dyfishta, dhe të konfrontuara mes veti. Dëshira për të arritur një zhvillim të shpejtë mund të shndërrohet në barrë të cilësisë së mjedisit. Janë OJQ-të ato të cilat gjithmonë punojnë për ngritjen e cilësisë së mjedisit dhe e kanë vetëm një rol: t'i bëjnë këto aleanca të mundshme për të mirën tonë dhe të gjeneratave që vijnë, të cilave u kemi borxh t'ua lëmë një ambient të pastër dhe të shëndoshë.

PARTITË POLITIKE SI METAFORË E SHOQERISË CIVILE

(Partitë politike kosovare dhe shoqëria civile)

I. HYRJE

Dhjetëvjetëshi i fundit është padyshim një nga periudhat më të rënda të historisë së Kosovës. Periudha në fjalë është njëkohësisht edhe një ndër më interesantet dhe gjithsesi më intrigueset për kah zhvillimet dhe dinamika e saj.

Por njëkohësisht është kjo edhe më e stërmbushura me transformime, dinamikë dhe ndryshime kardinale për shoqërinë kosovare në përgjithësi. Si e këtillë kjo periudhë si një kaleidoskop ngërthen në vete evoluim që shoqëritë e avancuara perëndimore kanë kaluar për qindra vite. Në gjithë morinë e koncepteve që u prezentuan për t'u bërë realitet brenda një kohe të shkurtë, janë edhe ato të partive politike dhe të shoqërisë civile.¹

Më 1989 duke përjetuar shthurjen e sistemit komunist, që në këtë rast përcillej edhe me fillimin e ndrydhjes së institucioneve të Kosovës, dhe fillimit të fundit të kornizës aktuale shtetërore, për Kosovën e atëhershme trasoheshin shtigje drejt të panjohurës. Në sfondin e sistemit monist çfarë ekzistonte

1) Përkufizimi i partive politike duket të jetë relativisht i lehtë, në veçanti poqëse krahasohet me ato të 'shoqërisë civile'. Për qëllime të këtij artikulli me parti politike do të nënkuptojmë ato "organizata të orientuara drejt arritjes së kontrollit të ligjshëm të qeverisjes nëpërmjet procesit elektoral" (A. Giddens, "Sociologjia"), kurse me shoqëri civile i referohemi "hapësirës që gjendet dikund ndërmjet shtetit dhe familjes dhe që përbehet nga organizatat e ndara nga shteti, që gëzojnë autonomi në raport me shtetin, dhe të cilat janë themeluar vullnetarisht nga anëtarët e shoqërisë për mbrojtjen ose zgjerimin e interesave apo vlerave të tyre." (G. White, "Civil Society, Democratization and Development (I): Clearing the Analytical Ground").

atëbotë, 'alternativat' filluan të zënë vend. Jo rastësisht e tërë kjo rrymë e diskursit të ri politik identifikohet fillimisht mu me këtë emër, thjesht si 'Alternativa'. Ishte ky një forum heterogjen, që pandan me sfidimin e legjitimitetit të Shtetit - Parti, kishte edhe synimin e krijimit të një domeni të pavarur nga çfarëdo kontrolli, direktive dhe subordinimi partiak. Eshtë mu ky synim i domenit në fjalë që ofron një premtim të fuqishëm për një legjitimitet afatgjatë dhe aftësi të sfidimit të pushtetit pavarësisht se cili është ai, qoftë kur ishte në pyetje sundimi segregues i pakicës, ai aktual, apo pushteti i ardhshëm kosovar, kurdo që ky tëhuajsohet nga qytetarët dhe i kalon kufijtë e veprimit të tij.

Realiteti i deriathershëm në Kosovë shënonte ekzistimin e një partie, asaj komuniste, që përkah vetë përkufizimi dhe diskursi i saj pengonte çfarëdo konkurrence, pavarësisht se a manifestohej kjo në formë të partisë apo në ndonjë formë tjetër. Një gjë e këtillë bëhej kryesisht përmes eliminimit të mundësisë së formimit të partive tjera, ofrimit të një mekanizmi kuazi-përfaqësues, si dhe delegimit të vëzhguesit në institucionet e të gjitha formave. Në një milë të këtillë, s'ishte paradoksale e as bile i habitshëm fakti që 13% të të gjithë banorëve të moshës madhore të numëroheshin anëtarë të partisë.

Format tjera të organizmit, nëse jo nën kontroll të organeve partiake, ishin në rastet më të mira nën vëzhgimin "syçelë" të tyre. Prej organizatave edukative, atyre të rinisë, e deri tek ato sportive prania e 'delegatit' apo çfarë tjetër që ishte etiketa e misionarit të partisë në organizatën e tillë, ishte pasqyrim i "unitetit" të shoqërisë pa asfarë fraksionesh, asaj që e ka zbuluar partinë më të mirë dhe që rrjedhimisht nuk ka nevojë për të tjera.

Uniteti manifestohej përmes sjelljes brenda kornizës së vënë, pa besuar domosdo në kornizën në fjalë. Uniformiteti përbënte më shumë se një parullë, me njerëzit e shndërruar në prototip të pemëshitësit të Havelit, që vënte rregullisht në xhamat e dyqanit të tij pankartat, me një të vetmën arsye, jo pse patjetër besonte në atë çfarë thuhej në pankartë, por thjesht "se të gjithë të tjerët vepronin njësoj".

II. "BINJAKËT SIJAMEZ"

Por përkundër një tendence të këtillë për t'i pasur të gjitha nën kontroll, dhe përkundër polarizimit të shtetit në njërën anë dhe të shoqërisë në anën tjetër (apo ndoshta dikush do të mund të thoshte, aq me tepër për shkak të kësaj të fundit) sferat e mbledhjes, diskutimit të çështjeve e të qëndrimeve dhe të artikulimit të tyre nuk ishin krejtësisht të panjohura. Për dikënd, si vogëlsia ime që anon kah koncepti i të kuptuarit ekstenziv të "shoqërisë civile", kjo gjithsesi nënkupton edhe të gjitha format e organizimit prezente tek totalitarizmi në fjalë. Përfshirë këtu, por duke mos u kufizuar vetëm në organizatat ilegale, ato të punëtorëve, studentëve, etj., të gjitha i konsideroj si forma të manifestimit të shoqërisë civile, meqë janë shembull tipik i organizmit jashtë domenit të kontrollit të shtetit. Por meqë në anën tjetër, shoqëria civile e mirëfilltë nënkupton funksionimin e lirë brenda një kornize institucionale e ligjore do t'u referohem të njëjtave, kur kihet ndër mend kjo periudhë, duke shtuar edhe atributin 'virtuele', për shkak të mungesës së formalizimit dhe të legjitimitetit që e njehta gëzon përherë në demokraci.

Përpjekjet e njërezve për t'u mbledhur, për të folur, për të vepruar bashkarisht, duke imagjinuar se po të jetonin në shoqëri vërtetë të lirë, përkundër asaj se shoqëria reale ishte antonim i asaj që imagjinonin, ishte impuls më se i fuqishëm në krijimin e një alternative serioze politike, si dhe në stimulimin e besimit në këtë alternativë.

Është kjo lloj 'shoqërie civile virtuale' që gjithsesi se ishte e pranishme në këtë fazë të vakuumit institucional dhe ligjor. Në momentet e thyerjeve të mëdha gjatë dekadës së fundit organizimet si ato të minatorëve, studentëve, punëtorëve të arsimit, artisteve...manifestuan dhe ushtruan një ndër funksionet me gjenuine të shoqërisë civile si të tillë, respektivisht rezistencën dhe oponencën ndaj pushtetit për se. Ato sollën në skenë shoqërinë civile implicite, të tillë që herë-herë ka rezistuar edhe në kontekste jopolitike, apo ndoshta edhe antipolitike. Për më tepër, këto sollën në skenë edhe vetë partitë politike si të tilla. Nga një vistër formash të organizimit të

tillë shoqëror, që po e quaj 'shoqëri civile virtuale', mund të thuhet se edhe vetë partitë politike të krijuara në atë kohë, janë zhvilluar paralelisht me fillet e para të shoqërisë së mirëfilltë civile.

Aq më tepër, të gjitha këto, së bashku me moduset tjera të organizimit kosovar, akceluruan fundin e pashmangshëm të kreaturës ngulfatëse komuniste. Njëkohësisht me këtë, të gjitha janë angazhuar në përpjekjet e manifestimit të lirë, dhe të jetës së lirë, qoftë edhe në një kontekst krejtësisht represiv. Organizimi dhe mbajtja gjallë e arsimit, funksionimi i asocioneve sportive, funksionimi i mediave dhe qarkullimi i informatave, janë të gjitha forma të përpjekjes së krijimit të "zonave të lirisë", sikur jeta të bëhej në një shoqëri të lirë, duke qenë njëkohësisht edhe oponentë ndaj barrierave dhe kufizimeve reale dhe shtypëse. Oponentë kjo që paradoksalisht duket në të njëjtën kohë sa origjinale aq edhe e përbashkët me përvoja të tjerëve. Përdorimi në këtë kontekst i shoqërisë imagjinare përballë shtetit ekzistues nga Michnik dhe bashkëkombasit e tij të lëvizjes së Solidarnoshq në Poloni, zgjon gjithsesi asocime tejet të afërta me përvojat e rezistencës civile dhe politike në Kosovë.

III. "FËMIJËT E DEMOKRACISË"

Në njërin nga ambientet kryesore të atëhershme të asaj që e quaj "shoqëri civile virtuale", gjegjësisht në "Shoqatën e Shkrimtareve të Kosovës" në dhjetor të vitit 1989 shënohet themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, si parti e parë kosovare në rrethanat e multipartizmit nominal. Së shpejti kjo do të pasohet edhe nga të tjerë "fëmijë të demokracisë", siç u referohej Weber në një rast, krijimit të partive politike. Partia Parlamentare e Kosovës, do të pasojë pas disa muajsh, sikurse edhe Partia Shqiptare Demokristiane, Partia Social Demokratike e Kosoves etj) që par definitionem marrin çështjen e institucionalizimit të vullnetit të popullit, i cili do të shprehet më pas në referendumin e vitit 1991, si dhe në zgjedhjet e vitit 1992.

Duke marrur për barrë misionin e jetësimit të këtij vullneti,

sa madhor aq edhe të vështirë për ta shndërruar në realitet, me kohë për partitë çështjet tjera konkrete dhe të përditshme të jetësimit të këtij vullneti duket se behen sekundare dhe terciale.

Çështjet e krijimit të vazhdueshëm të 'zonave të lirisë' dhe i zgjerimit të tyre duket të jetë perceptuar si tejet triviale për të qenë pjesë të betejës politike, që të njëjtat udhëheqeshin në atë kohë. Kuptohet, se vendimi dhe kriteret për vendosje se çfarë është 'madhore' e 'kombëtare' e çfarë triviale binte në partitë vetë, meqë ishin partitë ato që kishin fjalën e fundit për këtë.

Dhe ishte ndër të tjera kjo sjellje e partive, parasëgjithash LDK-së, ndaj 'shoqërisë civile virtuale' që i hapi dyert kësaj të fundit për t'u faktorizuar dhe forcuar. Me këtë roli i saj u zgjerua vazhdimisht për të krijuar kështu për vete një vend dhe pozitë të pakontestueshme.

Është ky një lloj devolucioni faktik dhe i heshtur që nxiti një organizim gjithnjë e më të madh dhe më efektiv të institucioneve arsimore, edukative, shëndetësore, organizatave rinore etj. Të përkrahuara fillimisht në aspektin financiar, kurse më vonë pak a shumë të lëna vetvetës, të njëjtat u stërvitën në ballafaqimin me realitetin e hidhur, duke zhvilluar njëkohësisht një kapital tepër të rëndësishëm të manifestuar në formën e mëvetësisë së tyre. Këto forma të organizimit që me kalimin e kohës tregohen të afta të mbijetojnë edhe në bazë të burimeve alternative, duke forcuar në këtë mënyrë mëvetësinë e tyre në përgjithësi, njëkohësisht plotësojnë një parakusht tejet të rëndësishëm për të qenë "opononcë e mirëfilltë", autonome dhe konstruktive.

Mëvetësimi i këtyre të fundit sa vinte dhe shtohet, për të qenë një premtues i mirë për rolin që të njëjtat luanin, ose do të duhej të ishin në gjendje ta luanin, në raport me partitë, dhe në raport me pushtetin, cilido që të ishte ai.

Mëvetësia e tyre bëhet aq impresive sa që me kohë shndërron në forcë në vete, të aftë të luajnë rol të pavarur, pavarësisht nga vullneti i partive ose partisë, e madje-madje qoftë edhe në kundërshtim me këtë vullnet.

Është ky ai moment, kur sufiksi 'virtuele' i hiqet, për të mbetur e tillë çfarë edhe do të duhej të jetë, alias 'shoqëri civile'.

Binjakët siamez çuditerisht ndahen natyrshëm për të vazhduar jetën si dy krijesa në vete.

Është ky një lloj impulsi negativ emetuar nga ana e partive politike por që paradoksisht ka rezultuar me efekte pozitive për shoqërinë civile.

IV. IMPULSI NEGATIV ME EFEKTE POZITIVE

Instancat e stimulimit të organizimeve qytetare përmes injorimit të shqetësimeve të një pjese të popullsisë kanë qenë vazhdimisht të pranishme. Rast shkollor është shembulli i Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, ku përmes një injorimi me të cilin është përballur organizata në fjalë me 1997 është bërë fuqizimi i saj, shtimi i përkrahjes dhe ndikimit të saj brenda një kohe shumë të shkurtë.

Mund të thuhet se një lloj neglizhence nga ana e partive (partisë) solli gjer te format e vetëorganizimit dhe të improvizimit qytetarë, qoftë kur ishin në pyetje organizimi i grevave (BSPK etj.), protestave (UPS), mosshkuarja në shërbim ushtarak, ekzodi masovik në Perndim, inicimi dhe funksionimi i mediave, e deri te organizimi i rezistencës së mirëfilltë. Si e këtillë, sado që në esencë motivohej nga një qasje e papërgjegjshme, në kontekstin e stimulimit të organizimit alternativ mund të thuhet se ngurtësia partiake ka pasur një ndikim dhe efekt të kundërt dhe të dobishëm.

Më pak e kuptueshme mbetet vazhdimi me avazin e vjetër të partive (partisë) edhe në rrethana krejtësisht të reja. Ajo që pothuajse nuk vërehet fare deri atëherë, as në këtë ambient të ri dhe të frymimit më të lirë, dhe që ishte relativisht vështirë të konceptohet kur kemi parasysh vetë *raison d'etre* të partive politike, ishte mungesa e çfarëdo ndërmarrjeje praktike në nxitjen e grupeve të advokimit publik dhe të edukimit qytetar. Sadoqë akuzat dëgjohen jo rallë në drejtim të popullit të "pajekur politikisht", të painformuar, të manipuluar, a mosmirënjohës, nuk duket të ketë në anën e partive politike ndonjë synim të punës praktike përmes të cilës qytetarët arsimohen për t'u bërë pjesëmarës aktivë në politikën e shtetit demokratik. Poqëse dobia nga kjo për partitë politike do të

ishite mëse imediate, kjo vështire se mund të spjegohet ndryshe përveqse me ngathësinë e tyre për të ndërmarrë një gjë të këtillë. Kjo në anën tjetër duket se mund të llogaritet në radhën e atyre gjerave që relativizohet konsiderueshëm me një angazhim çfarë organizatat e ndryshme joqeveritare tani më kishin filluar të zbatojnë. Është ky një segment i skajshëm ku shoqëria civile mund të shërbejë si një substitut në miniaturë i partive politike, por mundësitë e saj në këtë drejtim nuk shtrihen më tutje.

Në vend të kësaj qasjeje të lartëpërmendur, partitë nganjëherë i rreken shtegut më të shkurtër, alias atij të sponsorimit të ndonjë organizate joqeveritare, e cila për këmbim agjiton për partinë e këtillë me fjalë dhe me punë. Kjo përveç tjerash ka për pasojë zbatimin e një qasjeje identike edhe nga ana e konkurrentit dhe një efekt të domino efektit në radhën e partive tjera.

V. IMPULSI POZITIV

Konsideroj se do të ishte e drejtë të thuhet se impulsi pozitiv dhënë shoqërisë civile nga ana e partive politike manifestohet në faktin e vet ekzistencës së partive. Me vendosjen e ambientit shumëpartiak nevoja, vlera dhe pesha e shoqërisë civile është bërë gjithnjë e më evidente. Përveq kësaj diferencat ndërmjet partive politike dhe shoqërisë civile kanë filluar të kristalizohen, duke synuar që gjithnjë e më tepër që të dyja të luajnë rolet që u përgjigjen karakterit të tyre, edhe përkundër një lidhjeje të fuqishme fillestare dhe përkundër asaj se nismat e fundit të të tetëdhjetave dhe fillimit të viteve nëntëdhjetë janë gërshetim perpleks i një vistre të tërë të forumeve formash të ndryshme. Qoftë për shkak të personaliteteve të involvuara në cilesi të ndryshme në forumet e ndryshme të para, apo qoftë për shkak synimeve pak a shumë të njëjta të të gjithëve, edhe partitë (partia) politike, edhe OJQ-të në nismë të tyre, si dhe grupet tjera të organizimit të atëherëshëm, kanë më shume se një emërues të përbashkët, e që atëkohë ishte kryesisht rezistenca ndaj tendencave që vinin nga Beogradi, fillimisht kundër autonomisë, dhe më vonë të

përcjella me shtypje brutale dhe sistematike të popullsisë shumicë të Kosovës.

Për më tepër, përshtypja për gërshetimin përforcohet, në përceptimin fillestarë të elitës në krye të kësaj lëvizjeje heterogjene (për kah shumësia organizative e saj), si një entitet. Simbolika e gërshetimit të filleve të partisë së parë nga vetë ambienti themeltarë i saj është më shumë se aq, duke qenë pak a shumë i njejtë brum prej të cilit është gatuar "buka" e partive politike dhe ajo e shoqërisë civile.

Fillet e organizmit në asociacionet që u bënë nuk mund të ishin jashtë preokupimeve thelbësore të kohës. Por njësoj do të ishte anakronike që asgjë në preokupime të mos ndryshohet, apo që tjera të mos shtohen, edhe përkundër ndryshimeve që pëson i gjithë konteksti i preokupimeve në fjalë. Në shembullin e njerës prej organizatave më reprezentative të dhjetëvjetëshit të fundit, Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut kjo vërehet qartazi. I themeluar me 1990, si pjesë e një lëvizjeje të tërë, ky shpejt arriti të zgjerohet praninë e tij në gjithë Kosovën, në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Trajektorja e imagjinuar në zhvillimin dhe evoluimin e Këshillit, kur kriter merret raporti ndaj partive politike, është më shumë se sinonim i metamorfozës së "shoqërisë civile virtuale" në atë të mirëfilltë. E filluar si organizatë me qëllim të evidentimit të shkeljes së të drejtave të njeriut që bëhej nga regjimi i pakicës, e njehta shndërrohet në vëzhgues në zgjedhjet komunale të tetorit 2000. Është ky momenti, kur duke kaluar në organizatë të mirëfilltë të shoqërisë civile, theksi në funksionimin e saj vëhet në kontekstin qytetarë, shumë më tepër se sa në atë politikë.

VI. PARTITË POLITIKE VS. SHOQËRISË CIVILE (APO/DHE ANASJELLTAS)

Interaksioni ndërmjet partive politike kosovare dhe shoqërisë civile është një çështje në vete. Përgjithësisht përshtypja fitohet se një hendek i tërë dhe goxha i thellë ekziston

ndërmjet këtyre dy shtyllave të shoqërisë demokratike. Në radhë të parë është e pranishme mungesa inherente e një komunikimi të rregullt e të shëndoshë ndërmjet tyre. Dorën në zemër kjo mund të thuhet, dhe gjithsesi vlenë edhe më tepër, edhe kur është në pyetje komunikimi ndërmjet vetë partive politike.

Dallimi në rastin e shoqërisë civile këtu qëndron megjithatë në faktin se përderisa të parat janë konkurrente në luftën politike për pushtet, në rastin e shoqërisë civile kjo nuk është njësoj. Thënë më saktë, kjo së paku nuk do të duhej të ishte ashtu. Megjithatë, përgjithësisht kjo më shumë mbetet në nivelin e një arsyetimi hipotetik, se sa të një shkaku të qëndrueshëm, kurse paaftësia e partive për të komunikuar përgjithësisht me qytetarët dhe grupet e tyre, rrjedhimisht manifestohet dukshëm edhe kur është në pyetje shoqëria civile. Aq më tepër kur në rastin e kësaj të fundit duket të ketë edhe një arsye shtesë për mungesën e një komunikimi e ndërveprimi dinamik të këtillë, e kjo është bindja në radhët e partive se kurrfarë përfitimi, e me këtë as arsyeje, nuk ekziston për një interaksion të tillë.

Fatkeqësisht edhe organizatat e shoqërisë civile janë treguar të paafta për të ushtruar ndikim në korrigjimin e këtij realiteti të (mos) komunikimit. Përpyekjet për krijimin e ndonjë forumi të përbashket, që do të bënte partitë politike të kenë një qasje më me konsideratë ndaj të parave janë, në instancat e rralla kur ndodhin, të pasuksesshme. Përpyekja e vonshme e të ashtuquajturit "Koalicioni i Gruas", që megjithëse në ide dhe synime dukej të jetë shumë premtuese, mbeti për momentin një shprehje e paaftësisë për të luajtur një rol më përmbajtësor si në raport me partitë politike ashtu edhe me qytetarët, dhe si e këtillë paraqet një ilustrim të mirë.

Qasja dominante izolacioniste në radhën e partive politike, perceptimi, me apo pa arsye, i shoqërisë civile si konkurrente në luftën e tyre për pushtet, gjithsesi janë pengesë serioze në vendosjen e një mbështetjeje reciproke të fuqishme.

VII. PËRFUNDIM

Kur shikohet në anën tjetër, prania e institucionalizuar e "shoqërisë civile" në organet udhëheqëse të Kosovës nën administrimin ndërkombëtar, shihet se ajo është gjithsesi më tepër se solide. Mund të vërehet gjithsesi se shoqëria civile ka siguruar një prani tejet përmbajtësore në pushtet.

Për dikend si vogëlsia ime, që shoqërinë civile e percepton nën prizmin e mosidentifikimit me pushtetin, madje edhe si oponencë ndaj tij, por që për dallim nga opozita politike nuk synon marrjen e pushtetit, kjo mund të paraqitet si relativisht problematike. Jo ndoshta aq në aspektin praktik dhe të avancimit permanent të tendencave të ndryshme demokratike, por gjithsesi në vënjen e një pikëpyetjeje të madhe ndaj epitetit fillestar. Poqëse "shoqëria civile" është e identifikuar me pushtetin, atëherë mund të argumentohet se ajo pushon të jetë më shoqëri civile, dhe shndërrohet në *contradictio in adjecto*.

Prania prej organeve më të larta si Këshilli Tranzitor i Kosovës, mandej udhëheqja e departamenteve etj. janë pa pikë dyshimi forma të manifestimit të pushtetit në disa nga organet më të larta të Kosovës. A vazhdon apo jo e njejtja të jetë shoqëri civile, është pyetje e vështirë që s'mund të ketë një përgjigje të prerë. Së paku deri atëherë kur edhe vetë partitë do të pushojnë të jenë si një trajtë e shoqërisë civile në raport me administratën ndërkombëtare.

Por për më tepër, kjo gjithsesi len të kuptojmë se shoqëria civile është shndërruar në forcë të atillë që të ketë një vend të përhershëm dhe do të thosha të pakontestueshëm në forumet e pushtetit. Kjo është manifestuar para se gjithash në praninë në delegacionin kosovare të Rambujesë të dy përfaqësuesve të pavarur, alias të shoqërisë civile. Me këtë është krijuar një usus që ka pasuar të respektohet në vazhdimësi deri më tani. Qoftë kur është fjala për përfaqësimin në organet më të larta, qoftë kur është në pyetje procesi i përpilimit të kushtetutës së Kosovës, etj., krahas përfaqësimit të strukturës etnike të Kosovës, kriteri i pashmangshëm është edhe prania e shoqërisë civile.

Përrjashtimi që për shoqëri normale do të konsiderohej të jetë eklatant megjithatë ka një *raison d'être* të fuqishme në ambientin ambivalent kosovarë. Duke qenë së bashku në një proces ku vendimmarrja është në duar të administratës ndërkombëtare, të gjithë segmentet e shoqërisë kosovare, qofshin ato partitë politike apo forma të shoqërisë civile, kanë më shumë elemente të kësaj të fundit se sa të të parës. Me transferin gradual dhe të pashmangshëm të pushtetit në duar të kosovarëve, diferencimi funksional dhe përmbajtësor ndërmjet këtyre dy sferave të jetës do të jetë më se i pashmangshëm.

Më shumë se kjo dilemë akademike, është me rëndësi kapaciteti i zhvilluar i shoqërisë civile që të bën të kuptosh se qoftë kur ishte në pyetje sundimi segregues i pakicës, ai aktual ndërkombëtarë, apo ai i ardhshëm që pritet të ushtrohet prej institucioneve të mëvetesishme kosovare, duket se do të konfrontohet pashmangshëm me shoqërinë që është në gjendje të vëhet përballë pushtetit autoritar dhe të papërgjegjshëm.

Përpjekja për të vënë në një rend kronologjik veprimet fillestare ndërmjet shoqërisë civile dhe partive politike, mund të jetë hiç më pak se në nivel të spekulimeve shterpë të dilemës për vezën dhe zogun. Megjithatë, është mu kjo dilemë për (mos)ekzistimin e prioritetit në gjenezë të njerës ndaj tjetrës, që më shtyen të besoj në domosdonë e ndërveprimit më të mirë të këtyre dy faktorëve në të ardhmën, në realizimin e synimeve të përbashkëta të ndërtimit të demokracisë, duke luajtur role të ndryshme, por domosdo mu ato që janë gjenuine për natyrën e tyre, në vend se t'i konkurrojnë njëra-tjetrës.

Metafora e dhënë në titull, me po të njejtin legjitimitet do të mund të vehej edhe anasjelltazi, duke vënë në pah në këtë mënyrë sa ndërlidhjen dhe gërshetimin fillestar të të dyjave, aq edhe diferencimin gjithnjë e më të madh, që me shpresë do të kristalizohet shumë më qartë edhe në funksione edhe në qelime, pas zgjedhjeve të përgjithshme.

Por është e padyshimtë se çfarëdo osilimi në njërën apo skajshmërinë tjetër do të mund të ishte hiç më pak se fatal. Partitë politike dhe shoqëria civile jo vetëm që nuk përjashtojnë njera - tjetrën, porse krijojnë një tërësi komplementare. Që të dyja në demokraci ndihmojnë njëra - tjetrën dhe cilado prej

tyre është e pafuqishme pa tjetren. Shembujt e shoqërive me parti autoritare kanë për pandan shembujt e vendeve me sferë të shoqërise civile solide por pa parti të fuqishme e demokratike. Si një njërin ashtu edhe në rastin tjetër efektet janë pothuajse identike.

Sfida shtrohet prandaj, jo në formën e njohjes së prioritetit të njëres apo tjetrës shtyllë, por në balancimin adekuat të tyre, me qëllim te pengimit dhe shmangjes së çfarëdo monopoli.

Mangësitë e njërës kurrë nuk mund të jenë arsye për ngazëllim të tjetrës, meqë kjo në instancë të fundit është kërcënim i vet themeleve të demokracisë, shtylla të së cilës janë edhe partitë politike edhe shoqëria civile.

TË RINJTË DHE SHOQËRIA NË TRANZICION

GJENDJA E PASLUFTËS

Fenomenet negative që janë pjesë përcjellëse e zhvillimit të një shoqërie, bëhen edhe më të theksuara në periudhën kur shoqëria ballafaqohet me ndryshime radikale ose kriza të mëdha. Ndryshimi më radikal nëpër të cilin mund të kalojë një shoqëri është gjithsesi lufta. Ajo sjellë jo vetëm ndryshimet në sistemet politike por gjithashtu ndikon edhe në humbjen e plotë ose të pjesërishtme të sistemit të vlerave shoqërore.

Edhe shoqëria kosovare e pasluftës përjeton pasojat e ndryshimeve dhe traumave të shkaktuara nga humbja e dhjetarë mijëra njerëzve dhe shkatërrimeve të mëdha materiale, si dhe nga krijimi i vakuumit që wshtw pasojë e shkatërrimit të institucioneve të mëparshme dhe mosekzistimit të institucioneve të reja shoqërore. Stabiliteti dhe siguria në shoqëri, funksionimi integral i shtetit, formimi i sistemit të sjelljeve, rregullimi i raporteve të përcaktuara me ligj, funksionimi i sistemit ekonomik dhe bankier, i institucioneve sociale dhe të ngjashme - momentet më të rëndësishme të formimit dhe ekzistimit të një shoqërie, - pjesërisht ose plotësisht bëhen dis-funksionale. Vakuumi normativ e sjellë shoqërinë deri te pozicionimi në mes të sistemit të shkatërruar të normave të mëparshme, dhe sistemeve të reja ende të paformuara, deri te çorientimi i plotë dhe abstenimi nga mundësia e bartjes së një pjese të interesave dhe të drejtave individuale në favor të interesave të përgjithshme, të përbashkëta shoqërore.

SHOQËRIA E PERIUDHËS TRANZITORE

Periodha e tranzicionit postkomunist në literaturë zakonisht paraqitet si një "histori e shkurtër" e ndarë në tri faza: 1) faza e shkatërrimit të sistemit socialist, 2) faza e kthesave tranzitore dhe 3) faza e konsolidimit të demokracisë.

Nëse kalimi i shoqërisë nga një sistem në tjetrin realizohet nëpërmjet konfliktit të armatosur, atëherë, disa prej pasojave të dalura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kriza e periudhës së luftës mbesin si dukuri përcjellëse në intervalin e gjatë kohor të kalimit të shoqërisë në formën e re shoqërore. Paralel me ekzistencën e këtyre fenomeneve, është e rëndësishme edhe prania e momenteve të reja sikur që janë:

- ndërrimi i plotë ose i pjesërishtëm i strukturës sociale
- disfunksionimi i institucioneve shtetërore
- lëvizshmëria sociale
- ndryshimet në sistemin e vlerave
- kriza e moralit
- kriminaliteti në rritje

Ajo që ka ndikuar më tepër në ndryshimet brenda shoqërisë kosovare janë gjithsesi lëvizjet sociale të cila zhvillohen në dy drejtime: horizontal dhe vertikal.

Drejtimi horizontal ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me procesin e migrimit që karakterizohet nga këto tri momente:

- 1) kthimi i refugjatëve dhe emigrantëve kosovarë nga shtetet në të cilat kanë qëndruar para dhe gjatë konfliktit të armatosur;
- 2) migrimet brenda Kosovës nga mjedisi rural në mjediset urbane dhe
- 3) migrimet e brendshme nga qytezat në qytetet më të mëdha të shpëtuara nga shkatërrimet (si p.sh. në Prishtinë, Prizreni, Ferizaj, Besianë).

Drejtimi vertikal i lëvizjeve sociale lidhet ngushtë me stratifikimin në shoqëri. Fjala është për humbjen ose ndërrimin e pozitave shoqërore të kategorive të caktuara të popullatës dhe individëve, sikur dhe paraqitja e kategorive dhe autoriteteve të reja të dalura nga periudha e krizës.

Ndryshimet në sistemin e vlerave të cilat për pasojë kanë

krizën e moralit shkaktojnë krizen e familjes (institucioni më i theksuar në shoqërinë kosovare), labilitetin e lidhjeve familjare, rritjen e egoizmit, pasojat e të cilave janë format e ndryshme të sjelljes deviante dhe paraqitjes së tyre në shoqëri.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME MBI POPULLATËN E RE KOSOVARE

Sipas të të dhënave të UNMIK-ut (Unated Nations Mission in Kosovo) që datojnë nga gushti i vitit 2000, të dhënave të IOM (International Organisation for Migrations) dhe Zyrës së Kosovës për Statistikë, numri i përgjithshëm i qytetarëve të Kosovës është në mes të 1,8 -2 milionë banorë. Nga ky numër 60%, ose 1,2 milionë e përbëjnë fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 25 vjeçare. Sipas burimeve të njëjta, gjysma prej tyre ose 500 - 600 mijë njerëz janë të moshë prej 15 deri 24 vjet, e cila është kategoria e popullatës e definuar nga UNMIK-u si "të rinjë". Koncentrimi më i madh i të rinjëve është në Prishtinë. Supozohet se numri i përgjithshëm i banorëve të tanishëm të Prishtinës është rreth 600 mijë. Nga ky numër 300-400 mijë janë njerëz të rinjë nën moshën 24 vjeçare. Duke pasur parasyshë se ende nuk është bërë regjistrimi i fëmijëve të moshës deri në 16 vjetë vlerësohet se ½ e numrit të lartpërmendur, pra rreth 150 mijë, janë fëmijë të moshës në mes të 10 dhe 18 vjetë.

Si pasojë direkte e gjendjes së konfliktit një pjesë e të rinjëve dhe fëmijëve përbëjnë të ashtuquajturën kategori të cënueshme (vulnerable) e që përfishin grupet e poshtëshënuara:

- Jetimët e luftës.- Sipas shënimeve me të cilat disponon zyra e UNICEF-it në Prishtinë, rreth 20000 fëmijë të moshës shkollore janë pa një prind, ndërsa pa të dy prindërit janë 1217 fëmijë për të cilët kujdesen kushërinjtë ose të afërmit e tyre.* Në periudhën Korrik 1999 -

*) Shënimet nga Nëntori 2000

Korrik 2000 janë shënuar 80 raste të adoptimit por duhet theksuar se asnjë rast nuk është nën përkujdesjen e institucioneve sociale.

- Të gjitha rastet në të cilat vendbanimi është ndërruar pa dëshirë, për shkak të kushteve jetësore (shtëpitë e shkatërruara pjesërisht ose tërësisht).
- Personat e rinj pa mjete themelore të ekzistencës, të cilët jetojnë nga format e ndryshme të ndihmave joformale (solidaritetit).
- Fëmijët dhe të rinjtë të pa përfshirë në aktivitetet dhe institucionet si shkolla, institucionet parashkollore, institucionet e kulturës, klubet e të rinjve etj.
- Të ashtuquajturat grupe "në hije" - kategoria e rrezikuar e fëmijëve dhe e të rinjve e cila ekziston jashtë fushës së shikimit të institucioneve dhe qendrave sociale.
- Personat e rinjë, familjet e të cilëve janë ende të ndara: një pjesë e familjes është kthyer në Kosovë kurse pjesa tjetër ende qëndron në një nga shtetet e Europës ose më largë.
- Adolescentët në kërkim të individualitetit dhe nën presion konstant të procesit të socializimit.
- Të rinjtë kosovarë të ardhur në Kosovë nga shtetet tjera pas përfundimit të luftës.
- Përfaqësueset e gjinisë femërore të moshës së re të cilat në vakuumin normativ bëhen grupi më i rrezikuar si pasojë e shkatërrimit të sistemit ligjor dhe sistemit të normave shoqërore (morale, religjioze) nën mbrojtjen e të cilave kanë jetuar më herët. Një numër i konsiderueshëm i vajzave të reja ka mbetur kryefamiljare dhe pa mbrojtjen e anës mashkullore të familjes.

TË RINJTË DHE NDRYSHIMET NË SHOQËRI

Pas periudhës shumëvjeçare të izolimit (social, kulturor, edukativo-arsimor), të rinjtë në Kosovë përsëri kanë mundësi të mësojnë dhe të krijojnë. Mirëpo, për realizimin e lirisë së porsafituar atyre i mungon përvoja e jetës në një shoqëri demokratike dhe progresive. Si pasojë e kësaj mund të

paraqitet dezorientimi në kanalizimin konstruktiv të potencialit të madh të energjisë, e cila është fuqi lëvizëse e çdo shoqërie.

Shumica e të rinjëve tenton drejt lirisë individuale, mënyrave dhe mundësive të paraqitjes së saj, por poashtu edhe drejt një shoqërie moderne. Mirëpo, ata deri tani nuk kanë qenë pjesëmarrës aktiv në asnjërën prej tyre. Informimi i tyre në lidhje me jetën kulturore arsimore, formave të ndryshme të organizimit aktiv të të rinjëve, rolin e tyre dhe mundësive në shoqëri është (relativisht) në nivel të ultë.

Poashtu, në tendencat e tyre që të organizojnë sa më mirë jetën e përbashkët në mjedisin e ri, të rinjtë ndeshen me vështirësi të shumtë. Disa prej tyre janë karakteristika të përbashkëta të të gjitha shoqërive të kaluara nëpër krizat e konflikteve të mëdha, derisa ekzistojnë edhe ato që janë specifike vetëm për shoqërinë kosovare.

Të rinjtë janë me të ndieshëm në ndryshimet e atyre elementeve thelbësore të jetës të cilat i determinojnë sjelljet e tyre sociale (familja, shkolla, puna dhe aktivitetet e lira).

Në Tetor 2000 zyrja e UNICEF-it në Prishtinë ka publikur rezultatet e analizës disa muajshe me titull "Të rinjtë në Kosovë" ("Youth in Kosovo"). Keto të dhëna tregojnë problemet kryesore me të cilat ballafaqohen njerëzit e rinjë në bashkësinë kosovare pas luftës. Hulumtimet dhe anketat e kryera në mesin e të rinjëve në Prishtinë flasin mbi një dozë relative të dëshprimi mbi mënyrën e re të jetës. Citatet më të shpeshtë janë "ky vend nuk ofron asgjë", "ky qytet është i papastër", "nuk mund të jetoj me njerëzit e ardhur këtu" dhe të ngjashme.

Koncentrimi i lartë i popullatës në Prishtinë dhe qytetet e tjera më të mëdha të Kosovës është problem i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë i goditë fëmijët dhe të rinjtë dhe me të cilin ata ballafaqohen nga dy aspekte:

- 1) përqarja në mes të të rinjëve të mjediseve urbane dhe atyre rurale dhe
- 2) dallimet në mes të popullatës së re e cila ka qëndruar në Kosovë në periudhën para luftës dhe gjatë konfliktit të armatosur, dhe atyre të cilët në atë kohë kanë qëndruar jashtë shtetit.

Të rinjtë nga mjediset rurale (prania e të cilëve në mjedisin urban është afër 40% të popullatës) janë më konservativ, të kufizuar në kyqje në ngjarjet shoqërore, shpesh më të varfër dhe gjithnjë në kërkim të shumicës së atyre vlerave, të cilat të rinjtë nga mjediset urbane i kanë shumë më të afërta. Pasojat e luftës (humbjet në familje, të afërme, shokëve, shtëpitë e rrënuara), mjedisi i ri (jo gjithmonë mikpritës), ndeshja me vlerat e reja shoqërore, në shumicën e rasteve plotësisht të ndryshme nga ato të afërta, e fut këtë kategori të njerëzve të rinjë në situatë të dezorientimit (total ose parcial). Alternativa e re e kyqjes aktive në ndryshimet shoqërore, pjesëmarrja në marrjen e vendimeve, shkalla e përgjegjësisë dhe të ngjashme, e formuar me krijimin e raporteve të reja shoqërore dhe praninë në mjedisin e ri më dinamik, në masë të madhe e fut këtë pjesë të rinisë në një gjendje konfliktuale dhe në kërkim të çfarëdo lloji të përkrahjes. Në këtë kuptim, kjo kategori e të rinjëve kërkon kujdes të posaçëm me qëllim të kalimit të saj (sa më pak të dhembshëm dhe pa pasoja) nëpër periudhën e tranzicionit.

Ndarja në mes të të rinjëve të cilët janë paraqitur si forma pasive ose aktive të rezistencës së regjimit serb në periudhën e krizës, dhe të atyre të cilët në atë kohë kanë qëndruar në një nga shtetet europiane, SHBA, Australi, Kanadë etj. është gjithashtu një nga problemet të rëndësishme të shoqërisë kosovare pas luftës. Për ata të rinjë, të cilët janë kthyer në vendlindje pas një periudhe të gjatë të kaluar jashtë Kosovës, është shumë vështirë të gjejnë diçka nga ajo që kanë pritur nga shoqëria e re. Ata janë të kufizuar në çdo hap në tentativat e tyre që të gjitha ato intencat pozitive të fituara nga kulturat e ndryshme ku kanë jetuar t'i bartin në mjedisin kosovar. Në anën tjetër, të rinjtë të cilët kanë qëndruar në Kosovë tërë kohën në tjetër mënyrë reagojnë në "optimizmin" e moshatarëve të vet, për të cilin ende nuk janë përgatitur psikikisht.

Ana më e errët e shoqërisë së lirë, me status politik ende të padefinuar, është dëshira e një pjese të njerëzve të rinjë që ta largohen nga vendi dhe të vazhdojnë jetën në ndonjë nga shtetet europiane ose SHBA. Mirëpo, për shumicën prej tyre, kjo është vetëm ëndërr, për realizimin e të cilës atyre u

mungojnë të hollat, dokumentacioni ose afërsia me kulturën në të cilën dëshirojnë të shpërngulen.

Ballafaqimi i dëshirave dhe mundësive, pasojat nga lufta ende të freskëta, vakumi juridik dhe normativ, kthimi i personave të cilët në shtetet e tjera kanë qenë të ekspozuar ose në mënyrë direkte të kyqyr në format e ndryshme të sjelljes deviante (droga, alkooli, prostitucioni), aktivitetet e krimit të organizuar në rritje e sipër, të gjitha këto janë elemente të cilat drejtpërdrejtë mund të ndikojnë në formimin e formave të ndryshme të sjelljeve deviante të fëmijët dhe të rinjtë të cilët janë ende persona të paformuar dhe nuk janë në gjendje që në mënyrë pozitive t'i tejkalojnë traumat dhe të futen në jetën normale.

GJENDJA FAKTIKE

Në Nëntor të vitit 2000, në Klinikën Neuropsikiatrike të Qendrës Klinike të Prishtinës, kanë qëndruar 40 persona të rinjë të moshës 15 - 24 vjet, të varur nga drogat e llojeve të ndryshme. Numri i atyre të cilët janë paraqitur vetëm për konsultime, por nuk kanë dëshiruar të hospitaliaohen ka qenë mbi 100, prej të cilëve 2 kanë vdekur. Në krahasim me gjendjen e paraluftës ky numër është shumë më i madh dhe tregon edhe më tutje tendencë të rritjes. Sipas mendimit të z. John Richardson, autorit të analizës "Të rinjtë në Kosovë", arsyeya kryesore është mënyra joefikase e ndalimit të hyrjes së krimit të organizuar në Kosovë, por përmendet edhe kthimi i të rinjëve nga shtetet perëndimore, pasojat e luftës, mosekzistimi i ligjeve mbi tregtinë me drogë, pozita gjeografike e Kosovës si një nga marshrutat kryesore të qarkullimit të drogës në mënyrë të papenguar. Sipas të dhënave të IOM-it, këto janë shkaqet kryesore edhe për 78 rastet e prostitucionit të regjistruara në këto hapësira. Fjala është për vajzat e reja të deportuara nga Rumania, Ukraina dhe Moldova, moshë mesatare e të cilave është 22,5 vjet. Supozohet se numri i tyre është shumë më i madh por këtij numri duhet t'i shtohet edhe numri i panjohur i prostitutave lokale, prania e të cilave ka qenë gati injoruese para luftës. Në disa OJQ, të cilat merren kryesisht me prob-

lemin e lidhur me pozitën dhe mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, ekzistojnë edhe informatat konkrete në lidhje me këtë formë të sjelljes deviante, ku përmenden edhe rastet e moshës më të re se 14 vjet.

Të dhënat e asaj periudhe nga Klinika Neuropsikiatrike në Prishtinë flasin edhe mbi një numër më të vogël të rinjëve të varur nga alkooli. Duhet theksuar se numri i vogël i rasteve të paraqitura të alkoolizmit të rinjtë është në disproporcion me situatën reale, sepse këta persona e refuzojnë ndihmën mjekësore, duke mos e pranuar gjendjen e tyre si sëmundje të varësisë deri në momentin kur indikatet janë të tilla që zgjidhje tjetër përveç hospitalizimit nuk ekziston.

Elementi negativ në këto rrethana është gjithashtu mosekzistimi i qendrave të rehabilitimit të cilat në mënyrë profesionale duhet ti ndihmojnë të rinjëve të varur nga llojet e ndryshme të narkotikëve dhe alkoolit. Në anën tjetër organizatat zyrtare shëndetësore deri tani nuk kanë organizuar asnjë formë të kampanjës globale me të cilën do të informonin të rinjtë mbi pasojat direkte dhe indirekte të cilat i sjell me vete kjo mënyrë e sjelljes.

FORMAT E NDRYSHME TË AKTIVITETEVE TË ORGANIZUARA DHE INICIATIVAVE TË TË RINJËVE

Ajo që më shumë se 10 vite i mungon të rinjëve në Kosovë dhe njëkohësisht paraqet preokupim kryesor të tyre është formimi i një sistemi të ri, modern arsimor. Pas periudhës së kaluar në sistemin paralel dhe pa pjesëmarrje në aktivitete institucionale, të rinjtë kosovarë tentojnë drejt një niveli kualitativ dhe kuantitativ më të lartë të arsimimit. Kjo nënkupton ndryshimet në kuadër, planet mësimore, aplikimi i metodave të reja interaktive të mësimi, të cilat do ta zhvillojnë mënyrën kritike të menduarit dhe do ta ngrisin nivelin e vetëdijësim-it tek të rinjtë. Mirëpo, derisa kjo realizohet ata gjejnë mënyrat e tjera të vetorganizimit. Një nga format dominante e aktiviteteve në të cilat të rinjtë kyqen në mënyrë më masive

janë klubet dhe organizatat e tyre. Hulumtimi në teren në periudhën Nëntor 1999 - Prill 2000 i organizuar nga UNESCO, UNICEF, UNDP dhe Die Zeit Shitfung, tregon se gati 20 mijë persona të rinjë janë anëtarë të ndonjë nga 280 klubeve ta ndryshem të të rinjëve. Nëse merret parasysh se të dhënat kanë të bëjnë me periudhën vetëm 4 muaj pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë, atëherë ky është indikator i rëndësishëm i nevojës së të rinjëve për shoqërim, shpenzim të energjisë në mënyrë pozitive dhe para së gjithash indikator i aftësisë së tyre për organizim dhe pjesëmarrje aktive në ngjarje.

Sot ekziston numri shumë më i madh i klubeve të rinjëve i profileve të ndryshme, por të rinjtë janë poashtu pjesëmarrësit aktiv edhe në projekte të organizuara nga ana e OJQ-ve dhe Departamentit të të rinjëve në kuadër të UNMIK-ut, të cilët në mënyrë direkte (edhe pse jomjaftueshme) merren me problemet më të rëndësishme të shoqërisë së periudhës kalimtare dhe me pjesëmarrjen e të rinjëve në zgjidhjen e tyre.

SI DERI TE SJELLJA E DËSHIRUAR?

Është theksuar në fillim se kushtet e pas-luftës, mosfunksionimi i institucioneve shtetërore dhe vakumi normativ ndikojnë në krijimin e klimës së përshtatshme për format e ndryshme të krimit dhe sjelljes deviante. Mirëpo, vetëm këto kushte të jashtme nuk mjaftojnë për realizimin e ndonjë prej formave negative të sjelljes. Për këtë duhet të ekzistojnë edhe kushtet e "brendshme", do të thotë prirja e personit të caktuar që të bie nën ndikime. Njerëzit e rinjë janë persona ende në kërkim të identitetit dhe vendit të tyre në shoqëri. Si të tillë ata janë kategori e veçantë e rrezikuar, e cila duhet të drejtohet pozitivisht dhe në këtë mënyrë mbrohet nga elementet përcjellës negativ të një shoqërie në zhvillim. Pozita e të rinjëve në shoqëri dhe orientimi i tyre i drejtë imponon pyetjen mbi raportin në mes të të rinjëve dhe shoqërisë civile.

Anarkia e formuar në periudhën e pasluftës me humbjen e institucioneve shtetërore tregon pamundësinë e mbijetesës së shoqërisë moderne pa formën shtetërore të udhëheqjes

(pushteti). Mirëpo, për të rinjtë, nocioni i pushtetit paraqet një nocion abstrakt me të cilën ata takohen në ndonjë nga fushat e jetës shoqërore (shkolla, shëndetësia, legjislatura), ku ai (pushteti) ka karakter autoritativ. Në mënyrë indirekte (pu)shteti mund të ndikojë në parandalimin e formave të ndryshme të sjelljeve deviate të të rinjtë nga dy aspekte:

- 1) me funksionimin e tij edukativo - arsimor (duke përgaditur fëmijët dhe të rinjtë për kyqjen aktive në aktivitetet e organizuara shoqërore),
- 2) me funksionimin legjislativ (efikasiteti i të cilit duhet të pamundësojë kontaktet me format e ndryshme të sjelljes josociale).

Mirëpo, për arritjen e rezultateve në drejtimin pozitiv të popullatës së re, (pu)shteti duhet të transformojë një numër të madh të funksioneve të veta në funksionet shoqërore. Sektorët e ndryshëm të jetës shoqërore, me kalimin në mbikqyrjen e grupeve të sferave të ndryshme të interesit (asociacionet e qytetarëve, shoqatat etj.) do të bëhen shumë më të afërta me të rinjtë. Problemet e të rinjve janë probleme të dalura nga jeta e tyre e përditshme, e vërtetë, pra me keto duhet merret nga pozicionet e njejta.

Në Kosovë momentalisht ekziston numri i konsiderueshëm i OJQ-ve lokale sikur dhe asociacioneve të cilat, në mes tjerash, merren edhe me fenomenet e ndryshme nga jeta e të rinjve. Disa prej tyre me problemin e të rinjve merren vetëm atëherë kur "problemi" bëhet problem real dhe i dukshëm në trajtat ekscesive. Por, esenca e raportit ndaj të rinjve duhet të jetë formimi i personit të plotë me nivelin e lartë të vetvetëdijes, si faktor pozitiv i një shoqërie progresive. Kjo mund të arrihet me aktivitetet e ndryshme: zhvillimin e mendimit kritik, angazhimin aktiv të të rinjve në sferat e ndryshme të jetës së përditshme, vetëdijësimin e tyre mbi pozitën dhe përgjegjësinë që e kanë në shoqëri, ndihmesa e të rinjve nga ana e moshatarëve të tyre, etj.

Numri i madh i klubeve të rinjve në Kosovë flet në favor të trendit pozitiv që të rinjtë kohën e lirë ta kalojnë në shoqërimin me kolegët dhe shokët e tyre. Për pjesën më pak "aktive" të popullatës së re kujdesen asociacionet dhe OJQ-të me kyqjen e të rinjve (posaqërisht atyre nga mjediset rurale)

në sekcione të ndryshme, në kuadër të të cilave mbahen ligjëratat dhe debatet me temat të cilat aktualisht tërheqin kërshëritë dhe interesimet e tyre. Pjesa progresive e të rinjve në shoqëri kosovare, në mënyrë individuale ose nëpërmjet të asocioneve, është pjesëmarrëse aktive në realizimin e programeve të ndihmës së dedikuar moshtarëve të tyre. Disa nga organizatat humanitare kanë filluar me kyqjen e njerëzve të rinj në programet e ndryshme ku punohet me të rinjtë të cilët kanë vepruar në kundërshtim me ligjin.

Nëse merret parasysh se ndikimi i moshatarëve në këtë periudhë të jetës është shumë i madh atëherë kjo mund të jetë një nga mënyrat më pozitive të ballafaqimit të të rinjve me problemet në të cilat hasin në procesin e socializimit.

Reformat e pritura në arsim kanë për qëllim futjen e metodave të reja të mësimin të cilat, në mënyrë më aktive do t'i inkuadrojnë të rinjtë në procesin e të mësuarit dhe në këtë mënyrë do ta krijojnë ndjenjën e vetpërgjegjësisë jo vetëm për veprimet e veta, por edhe për të gjitha ato që ndodhin në shoqërinë, anëtarë aktive të së cilës janë edhe ata.

Këto format e ndryshme të aktiviteteve të organizuara nga ana e asociacioneve të ndryshme, duhet të përkrahën në të ardhmen edhe nga ana e institucioneve shtetërore. Në këtë mënyrë mund të formohet baza për një shoqëri të re, ku do të dominojë "masa kritike" e vetedijes që do të pengojë dhe pamundësojë zhvillimin e dukurive dhe sjelljeve negative, të cilat rrezikojnë edhe vetë shoqërinë.

LITERATURA

- Demographic and Reproductive Health Survey Preliminary Results; UNFPA, IOM and Office of Statistics, August 2000.
- Final Report on Kosovo Youth Project; UNESCO, UNDP, UNICEF in conjunction with Die Zeit Stiftung, April 2000.
- The global Movement for Children; UNICEF, August 2000.
- Youth in Kosovo; UNICEF, UNMIK Department of Youth, October 2000.
- Shifra dhe fakte për arsimin e Kosovës; KEC, Prishtinë, 2000.
- Društveni razvoj i ekološka modernizacija (prilozi sociologiji tranzicije); Zagreb 1998.

BURIMET TJERA TË TË DHËNAVE:

- Klinika Neuropsikiatrike, Qendra Klinike - Prishtinë
- UNICEF, Prishtinë
- UNMIK, Departamenti i të rinjëve, Prishtinë
- KEC, Prishtinë
- OJQ QMGF, Prishtinë